

DHJETOR 2025

FËMIJËT DHE TË RINJTË NË SHQIPËRI

CENSUSI 2023

RAPORTI TEMATIK I THELLUAR



DHJETOR 2025

FËMIJËT DHE TË RINJT NË SHQIPËRI

CENSUSI 2023

RAPORTI TEMATIK I THELLUAR

FËMIJËT DHE TË RINJTË NË SHQIPËRI: CENSUSI 2023 – RAPORTI TEMATIK I THELLUAR

Drejtor publikimi:

Elsa Dhuli, PhD.

Autorë:

Bart de Bruijin

Frank Eelens

Për përgatitjen e raportit kontribuan:

INSTAT:

Elona Sevrani

Anisa Omuri

Eriona Dhamo

Indrit Mustafa

Edlira Subashi

Blerta Muja

Joana Kostaqi

UNICEF në Shqipëri:

Elda Denaj

© Copyright INSTAT 2025

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mënyre pa lejen paraprake me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë,

Kodi Postar 1017

Tel: + 355 4 2233358 / 2233356

Fax: +355 4 2222 411

e-mail: info@instat.gov.al

www.instat.gov.al



Dokumenti është hartuar me asistencën teknike të UNICEF në Shqipëri. Kjo ndërmarrje është realizuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.



Dr. Elsa DHULI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM, INSTAT

Është një kënaqësi e veçantë për mua të prezantoj Raportin Tematik të Censit 2023: “Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri”, një publikim që ofron portretin më të detajuar dhe më të përditësuar të jetës dhe rrethanave të fëmijëve, të rinjve dhe rinisë në vendin tonë.

Censi 2023 i Popullsisë dhe Banesave përbën një nga ndërmarrjet demografike më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë, duke na dhuruar një pasqyrë të rrallë dhe të thelluar mbi brezin e ri, mbi mënyrën se si ata jetojnë, si edhe faktorët që formësojnë mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

Ky raport shkon përtej shifrave. Ai i përgjigjet një nevoje kombëtare, në një kohë kur Shqipëria po përjeton një tranzicion thelbësor demografik, i karakterizuar nga fertiliteti në rënie, migrimi, urbanizimi dhe ndryshimet në strukturat familjare. Duke u përqendruar tek fëmijët dhe të rinjtë, ky publikim krijon një bazë të fortë të dhënash për masa strategjike, duke siguruar që asnjë fëmijë apo i ri të mos mbetet pas dhe që të gjitha politikat të reflektojnë nevojat dhe aspiratat e tyre.

Censi 2023 shënon një moment historik për INSTAT dhe për vendin tonë. Ai është rezultat i një përpjekjeje të jashtëzakonshme kombëtare, ku u bashkuan përkushtimi i mijëra punonjësve në terren dhe përdorimi i teknologjive inovative, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira statistikore. Ky kombinim ka mundësuar prodhimin e të dhënave të besueshme, të sakta dhe në kohë, që shërbejnë si një themel i fuqishëm për analiza dhe vendimmarrje të bazuar në fakte.

Dua të shpreh mirënjohjen më të thellë ndaj të gjitha familjeve dhe individëve që morën pjesë në Censin 2023, gadishmëria e tyre për të ndarë informacione të sakta ka bërë të mundur këtë raport dhe shumë analiza të ardhshme. Po ashtu, shpreh vlerësimin tim të sinqertë për stafin e përkushtuar të INSTAT, i cili, me profesionalizmin, integritetin dhe përpjekjet e palodhshme, siguroi përfundimin e suksesshëm të një nisme kaq komplekse dhe ambicioze.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për UNICEF-in në Shqipëri për mbështetjen e tyre të çmuar teknike dhe partneritetin e gjatë në zhvillimin e sistemeve kombëtare të të dhënave për fëmijët dhe të rinjtë. Ky bashkëpunim pasqyron besimin tonë të përbashkët se statistikatat e cilësisë së lartë nuk janë thjesht shifra, ato janë instrumente për të mbrojtur të drejtat, për të monitoruar progresin dhe për të udhëhequr politika që pasqyrojnë në mënyrë të vërtetë realitetin e përditshëm të popullsisë së re.

Gjetjet e këtij studimi ftojnë politikëbërësit, studiuesit, akademinë, aktorët e shoqërisë civile, partnerët dhe INSTAT të angazhohen dhe të bashkëpunojnë për të shndërruar të dhënat në ndryshim të qëndrueshëm, të dobishëm dhe të frytshëm për gjeneratën e ardhshme të Shqipërisë.



Murat SAHIN
PËRFAQËSUESI I UNICEF-IT NË SHQIPËRI

Është privilegj për UNICEF-in të qëndrojë krah INSTAT-it në prezantimin e Raportit Tematik të Censit 2023: “Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri”.

Ky raport ofron një panoramë reale dhe domethënëse mbi fëmijërinë dhe rininë në Shqipërinë e sotme. Ai pasqyron një shoqëri në tranzicion të shpejtë, ku numri i fëmijëve dhe të rinjve është në rënie, ndërkohë që popullsia po plaket. Në të njëjtën kohë, raporti nxjerr në hap përparime të rëndësishme në fusha të tilla si pjesëmarrja në shkollë dhe qasja në shërbime thelbësore për shumë fëmijë dhe të rinj në mbarë vendin.

Për UNICEF-in, të dhënat nuk janë qëllimi përfundimtar, por pikënisja për ndërmarrjen e masave të duhura. Këto gjetje do të ndihmojnë Qeverinë e Shqipërisë, autoritetet vendore, Kuvendin dhe shumë partnerë të tjerë të hartojnë politika më të forta dhe të shqyrtojnë përparimin drejt përmbushjes së angazhimit për të mos “mos lënë askënd pas”, veçanërisht ndërsa Shqipëria avancon drejt integritimit në Bashkimin Europian dhe aritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Duke shkuar përtej shifrave të thjeshta dhe duke analizuar se si faktorë të tillë si vendbanimi, kushtet e mirëqënies së familjes, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, mosha apo gjinia formësojnë mundësitë e tyre, raporti identifikon fëmijët dhe të rinjtë që kanë nevojë për mbështetjen dhe investimet më urgjente.

Ky publikim pasqyron forcën e partneritetit mes INSTAT-it, UNICEF-it dhe Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, realizuar përmes Programit të Përbashkët “Të mos lëmë askënd pas”, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Jemi thellësisht mirënjohës ndaj drejtuesve dhe stafit të INSTAT-it për përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre.

UNICEF mbetet plotësisht i përkushtuar të punojë me të gjithë partnerët për t’u siguruar që këto analiza të përkthehen në ligje më të mira, buxhete më të drejta dhe shërbime më cilësore në çdo komunitet. Qëllimi ynë i përbashkët është i thjeshtë, por i fuqishëm: që çdo fëmijë dhe çdo i ri në Shqipëri të ketë mundësi të mësojë, të mbrohet dhe të lulëzojë – duke ndërtuar kapitalin njerëzor që do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e tabelave	13
Lista e figurave	15
Shkurtime	19
Përmbledhje ekzekutive	21
1. Hyrje	25
1.1 Konteksti i përgjithshëm	25
1.2 Organizimi i raportit	26
1.3 Metodologjia	26
1.3.1 Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023	26
1.3.2 Metodologjia e hulumtimit për raportin	28
1.3.3 Kufizimet e hulumtimit	30
2. Një peizazh demografik në ndryshim	31
2.1 Ndryshimi i përgjithshëm demografik	31
2.2 Ndryshimet e popullsisë në moshë të re	34
2.2.1 Popullsi në moshë të re gjithnjë e më të vogla	34
2.2.2 Raportet gjinore tek popullsia në moshë të re	36
2.2.3 Popullsia në moshë të re në nivel nënkombëtar	37
3. Martesa dhe struktura e NjEF-së	45
3.1 Martesa	45
3.1.1 Moshë në martesën e parë	45
3.1.2 Indeksi i barazisë gjinore për martesën	48
3.1.3 Krahasimi ndërkombëtar	48
3.1.4 Martesa e fëmijëve	50
3.1.5 Zgjidhja e martesës	50
3.2 Struktura e NjEF-së	51
3.2.1 Lidhja me personin e references në NjEF	51
3.2.2 Madhësia e NjEF-së	52
3.2.3 Mungesa e prindërve	52
3.2.4 Lloji i NjEF-së	53

4. Shkrim-leximi dhe arsimit	55
4.1 Hyrje	55
4.2 Shkrim-leximi dhe analfabetizmiIntroduction	55
4.2.1 Hyrje	55
4.2.2 Shkrim-leximi dhe analfabetizmi tek popullsia në moshë të re	55
4.2.3 Vështirësi të përgjithshme mbi aftësitë shkrim-lexim	56
4.2.4 Shkrim-leximi në nivel qarku	60
4.3 Ndjekja e arsimit	63
4.3.1 Sistemi arsimor në Shqipëri	63
4.3.2 Shkalla e pjesëmarrjes në arsim sipas moshës	63
4.3.3 Faktorët që ndikojnë në ndjekjen e arsimit.	70
4.4 Arsimit i përfunduar	77
4.4.1 Individët pa asnjë nivel arsimor të përfunduar	77
4.4.2 Niveli arsimor i përfunduar.	79
5. Aftësia e Kufizuar	85
5.1 Hyrje	85
5.2 Karakteristikat e përgjithshme të popullsisë në moshë të re me aftësi të kufizuara.....	86
5.3 Kushtet e banimit të personave me aftësi të kufizuar	90
5.3.1 Përbërja familjare e personave me aftësi të kufizuara.	90
5.3.2 Statusi i mirëqënies	92
5.3.3 Pajisje dhe shërbime.	93
5.3.4 Aftësitë e shkrim-leximit dhe arsimit.	96
6. Niveli i jetesës së popullsisë në moshë të re	101
6.1 Statusi i mirëqënies së NjEF	101
6.2 Furnizimi me ujë.	103
6.3 Tualalet	104
6.4 Pajisjet e tualetit	104
6.5 Energjia elektrike dhe ngrohja	105

Referenca	107
Shtojca I Koncepte dhe përkufizime	111
Shtojca II Popullsia, sipas moshës (grupit) dhe sipas vitit të regjistrimit, gjinisë	113
Shtojca III Popullsia: tabela dhe shifra në nivel bashkie	114
III.a Popullsia e re, fëmijët, të rinjtë dhe rinia, sipas bashkisë dhe sipas gjinisë; raporti gjinor, sipas gjinisë	114
III.b Popullsia e re e moshës 0-29 vjeç si përqindje e popullsisë totale, sipas bashkisë	118
III.c Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç si përqindje e popullsisë totale, sipas bashkisë	119
III.d Raporti i varësisë së të rinjve, sipas bashkisë	120
III.e Raporti gjinor për popullsinë e re, fëmijët, të rinjtë dhe rinia, sipas bashkisë	122
III.f Shkalla e analfabetizmit tek fëmijët e moshës 10-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas bashkisë dhe sipas gjinisë	126
Shtojca IV Popullsia, sipas statusit martesor dhe sipas vitit të regjistrimit, gjinisë	129
Shtojca V Tabelat e aftësisë së kufizuar bazuar në kategori më të gjera të kufizimeve funksionale ...	131
Shtojca VI Tabelat sipas shkallës së vështirësisë	137

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1: Raportet e varësisë për vende të përzgjedhura (2023) (në %)	34
Tabela 2.2: Popullsia në moshë të re, sipas viti të censit (në mijëra).	34
Tabela 2.3 Popullsia në moshë të re sipas qarkut dhe gjinisë (në mijëra); përqindja e popullsinë në moshë të re gjithsej sipas qarqeve dhe gjinive (në %)	38
Tabela 3.1: Fëmijë, të rinj dhe rinia, sipas lidhjes me personin e referencës të NJEF dhe sipas gjinisë (në %)	51
Tabela 4.1 Popullsia në moshë të re, sipas statusit të shkrim-leximit, dhe sipas gjinisë (në mijëra); shkalla e shkrim-leximit dhe analfabetizmit, sipas gjinisë (në %)	56
Tabela 4.2: Indeksi i barazisë gjinore të analfabetizmit i të rinjve, sipas përkatësisë etnike (në %)	58
Tabela 4.3: Shkalla e pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve të moshës 6–17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë (në %)	67
Tabela 4.4: Fëmijët e moshës 0–5 vjeç, sipas moshës dhe statusit të pjesëmarrjes (në mijë); shkalla e pjesëmarrjes, sipas moshës (në %)	68
Tabela 4.5: Normat neto të pjesëmarrjes dhe raportet bruto të pjesëmarrjes, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë; indeksët e barazisë gjinore, sipas nivelit arsimor (në %)	70
Tabela 4.6: Statusi i pjesëmarrjes në arsimin parashkollor të fëmijëve të moshës 0-6 vjeç dhe lloji i arsimit parashkollor të ndjekur, sipas disa variablave të faktorëve dhe sipas gjinisë (në %)	77
Tabela 5.1: Popullsia dhe shkalla e prevalencës së aftësive të kufizuara te popullsia mbi 5 vjeç, fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë.	87
Tabela 5.2: Norma e prevalencës së aftësive të kufizuara te personat 5 vjeç e lart, fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas gjinisë dhe llojit të kufizimit funksional (në %)	89

LISTA E FIGURAVE

Figura 2.1:	Popullsia, sipas vitit të censit dhe sipas grupmoshave kryesore (në mijë)	31
Figura 2.2:	Popullsia sipas gjinisë, dhe sipas grupmoshave për tre censet (in %)	32
Figura 2.3:	Raporti i përgjithshëm, i varësisë së moshës së re dhe i varësisë së moshës së vjetër, sipas vitit të censit (në %)	33
Figura 2.4:	Popullsia në moshë të re sipas censeve	35
Figura 2.5:	Raporti gjinor i popullsisë në moshën 0-29 vjeç, sipas çdo viti të veçantë të moshës (2023) dhe raporti gjinor i zhvendosur i popullsisë të viteve 2001 dhe 2011 në moshën 0-29 vjeç, sipas çdo viti të veçantë të moshës (në %)	37
Figura 2.6:	Ndryshimi i popullsisë në moshë të re në moshën 0-29 vjeç midis Censeve 2011 dhe 2023.	39
Figura 2.7:	Raporti i varësisë së moshës së re, sipas qarqeve dhe viteve të censit (në %)	40
Figura 2.8:	Raporti gjinor i popullsisë në moshë të re dhe rinisë, sipas qarqeve (në %)	40
Figura 2.9:	Fëmijët në moshën 0-17 vjeç si përqindje e popullsisë gjithsej, sipas bashkive	42
Figura 2.10:	Të rinjtë në moshën 15-24 vjeç si përqindje e popullsisë gjithsej, sipas bashkive	43
Figura 3.1:	Përqindja e popullsisë gjithsej që nuk është martuar asnjëherë, sipas viteve të censit dhe gjinisë	46
Figura 3.2:	Përqindja e popullsisë në moshë të re, të martuar dhe të pamartuar, sipas moshës dhe gjinisë	46
Figura 3.3:	Mosha mesatare e martesës së parë (SMAM), sipas viteve të censit dhe gjinisë	47
Figura 3.4:	Indeksi i barazisë gjinore për përqindjen e të martuarve në popullsinë në moshë të re, sipas moshës	48
Figura 3.5:	Mosha mesatare në martesën e parë për burra dhe gra, në vende të përzgjedhura evropiane	49
Figura 3.6:	Madhësia mesatare e NjEF-së sipas Censeve	52
Figura 3.7:	Madhësia mesatare e NjEF-së sipas pranisë së fëmijëve, të rinjve dhe rinisë	52
Figura 3.8:	Përqindja e fëmijëve pa njërin ose të dy prindërit në NjEF, sipas moshës dhe sipas statusit të mungesës së prindërve	53
Figura 3.9:	Fëmijët, të rinjtë dhe rinia, sipas gjinisë dhe llojit të NjEF-së	54
Figura 4.1:	Shkalla e analfabetizmit të popullsisë 10-29 vjeç dhe rënia absolute e shkallës së analfabetizmit, sipas vitit të censit të popullsisë dhe banesave dhe sipas grupmoshës pesëvjeçare (në %)	56
Figura 4.2:	Shkalla e shkrim-leximit e popullsisë në moshë të re gjithsej të moshës 10-29 vjeç, sipas ndjekjes ndonjëherë të arsimit dhe sipas grupmoshave pesëvjeçare (në %)	57
Figura 4.3:	Shkalla e analfabetizmit të popullsisë së të rinjve, sipas përkatësisë etnike (në %)	57
Figura 4.4:	Shkallët e analfabetizmit të të rinjve, sipas statusit ekonomik të NjEF-së (në %)	58
Figura 4.5:	Rreziku i të qenit analfabet për të rinjtë e moshës 10-29 vjeç, në raport me kategoritë referuese, bazuar në regresionin logjistik (në %)	60
Figura 4.6:	Shkallët e analfabetizmit të popullsisë në moshë të re, sipas qarqeve (në %)	62
Figura 4.7:	Normat e analfabetizmit të fëmijëve të moshës 10-17 vjeç, sipas bashkive (në %)	63
Figura 4.8:	Shkalla e pjesëmarrjes në arsim sipas moshës së popullsisë në moshë të re, sipas grupmoshave (në %)	65
Figura 4.9:	Shkalla e pjesëmarrjes në arsim e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë (në %)	65

Figura 4.10:	Shkalla e pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve të moshës 6–17 vjeç, të rinjve dhe rinise, sipas qarkut (në %)	66
Figura 4.11:	Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin e organizuar një vit përpara hyrjes në arsimin bazë zyrtarë, sipas vendit ose rajonit (në %)69	
Figura 4.12:	Përqindja e nxënësve me moshë që nuk korrespondon me nivelin e arsimit që ndjekin	71
Figura 4.13:	Shkalla e jashtë shkollës, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë (në %)	71
Figura 4.14:	Përqindja e fëmijëve, të rinjve dhe të rinisë që ndjekin arsimin, sipas statusit të mirëqënies së NjEF-së.	72
Figura 4.15:	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–17 vjeç që nuk ndjekin arsimin, sipas nivelit arsimor të nënës dhe sipas gjinisë së fëmijës	73
Figura 4.16:	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–17 vjeç që nuk ndjekin arsimin, sipas mungesës së prindërve në NjEF dhe sipas gjinisë së fëmijës.	73
Figura 4.17:	Rreziku për të mos ndjekur arsimin për fëmijët dhe të rinjtë të moshës 6-22 vjeç në raport me kategoritë e referencës, bazuar në regresion logjistik (në %)	75
Figura 4.18:	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç që ndjekin çerdhe ose kopsht, sipas statusit të mirëqënies së NjEF-së dhe sipas gjinisë së fëmijës	78
Figura 4.19:	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç që ndjekin çerdhe ose kopsht, sipas nivelit arsimor të nënës dhe sipas gjinisë së fëmijës	78
Figura 4.20:	Përqindja e popullsisë mbi 15 vjeç, fëmijëve 10-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë pa asnjë nivel arsimor të përfunduar, sipas gjinisë.	79
Figura 4.21:	Përqindja e fëmijëve të moshës 10-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë pa asnjë nivel arsimor të përfunduar, sipas vitit të censit	79
Figura 4.22:	Përqindja e të rinjve pa asnjë nivel arsimor të përfunduar, sipas statusit të mirëqënies së NjEF-së dhe sipas gjinisë	80
Figura 4.23:	Përqindja e fëmijëve 10-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë që kanë përfunduar ndonjë nivel arsimor, sipas gjinisë dhe sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar	81
Figura 4.24:	Përqindja e individëve të moshës 20 vjeç e lart, sipas gjinisë dhe grupmoshës, sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar	82
Figura 4.25:	Përqindja e personave të moshës 20-24 vjeç që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, sipas gjinisë dhe sipas vitit kalendarik	82
Figura 4.26:	Normat e përfundimit për individët e moshës 20-24 vjeç, sipas nivelit të arsimit dhe sipas gjinisë (në %)	83
Figura 4.27:	Normat e përfundimit të arsimit për popullsinë e moshës 20-24 vjeç, sipas nivelit arsimor dhe sipas vitit kalendarik (në %).	84
Figura 4.28:	Përqindja e individëve të moshës 25–29 vjeç që kanë përfunduar të paktën një nivel arsimor, sipas nivelit të arsimit të përfunduar dhe sipas qarkut	84
Figura 5.1:	Norma të prevalencës së aftësisë së kufizuar për personat 5 vjeç e lart, fëmijët 5–17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas gjinisë (në %)	87
Figura 5.2:	Norma e prevalencës së aftësive të kufizuara te popullsia 5 vjeç e lart dhe fëmijët 5-17 vjeç, sipas qarqeve (në %)	89
Figura 5.3:	Indeksi i barazisë gjinore për aftësitë e kufizuara te popullsia 5 vjeç e lart dhe fëmijët 5-17 vjeç, sipas qarqeve (në %).	90
Figura 5.4:	Numri gjithsej, djem dhe vajza 5-17 vjeç me aftësi të kufizuar, sipas llojit të NjEF-së (në %)	91
Figura 5.5:	Fëmijët 5-17 vjeç, sipas llojit të NjEF-së dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %)	92
Figura 5.6:	Fëmijët 5-17 vjeç, sipas statusit të mirëqënies.	93

Figura 5.7:	Rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe statusit ekonomik (në %).	93
Figura 5.8:	Përqindja e popullsisë 5 vjeç e lart, fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë pa dush/vaskë brenda banesës, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar.	94
Figura 5.9:	Fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe llojit të furnizimit me ujë (në %).	95
Figura 5.10:	Fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe llojit të tualetit (në %).	95
Figura 5.11:	Shkalla e shkrim-leximit të fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %).	96
Figura 5.12:	Normat e pjesëmarrjes në shkollë të fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %).	97
Figura 5.13:	Raportet e barazisë gjinore për pjesëmarrjen në shkollë të fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %).	97
Figura 5.14:	Shkalla e ndjekjes së shkollës nga popullsia e moshës 6-29 vjeç, sipas statusit të aftësisë së kufizuar, gjinisë dhe moshës (në %).	98
Figura 5.15:	Të rinjtë 15-24 vjeç, sipas nivelit të arsimit që ndjekin dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %).	98
Figura 5.16:	Të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe arritjeve arsimore (në %).	99
Figura 5.17:	Rinia (15-29 vjeç), sipas statusit të aftësisë së kufizuar, gjinisë dhe nivelit arsimor (në %).	99
Figura 6.1:	Rreziku për qenë pjesë në kuintilin me mirëqënien më të ulët në krahasim me kategoritë e referencës, bazuar në regresionin logjistik (në %).	102
Figura 6.2:	Fëmijët e moshës 0-17 vjeç, sipas llojit të furnizimit me ujë dhe gjinisë (në %).	103
Figura 6.3:	Përqindja e fëmijëve sipas llojit të tualetit të përdorur dhe sipas gjinisë.	104
Figura 6.4:	Fëmijët e moshës 0-17 vjeç, sipas llojit të pajisjes për larje dhe gjinisë.	105
Figura 6.5:	Fëmijët e moshës 0-17 vjeç, sipas llojit të ngrohjes në banesë dhe gjinisë.	106

SHKURTIMET

APC	- Anketa pas Censit
BE	- Bashkimi Evropian
CAPi	- Intervistim individual i asistuar nga kompjuteri
COVID-19	- Virusi koronavirus 2019
DHS	- Studimi Demografik dhe Shëndetësor
GAR	- Norma bruto e ndjekjes
GIS	- Sistemi Gjeografik i Informacionit
GPI	- Indeksi i barazisë gjinore
INSTAT	- Instituti i Statistikave
KDF	- Konventa Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Fëmijës
NAR	- Norma neto e ndjekjes
OZHQ	- Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
SMAM	- Mosha mesatare për martesë e llogaritur me singulatë
SPSS	- Paketa Statistike për Shkencat Shoqërore
UNFPA	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNECE	- Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
UNESCO	- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
ZC	- Zona Censi
WG	- Grupi i Washingtonit
WHO	- Organizata Botërore e Shëndetësisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport trajton disa aspekte kyçe të situatës së popullsisë në moshë të re - nën moshën 30 vjeç - në Shqipëri, duke dalluar tre grupe të synuara: fëmijë (mosha 0-17 vjeç), të rinj (15-24 vjeç) dhe rini (15-29 vjeç). Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023 (në vijim, Censi 2023) ofroi bazën për analizën në këtë raport. Censi 2023 iu përmbajt standardeve ndërkombëtare dhe rregulloreve të Bashkimit Evropian (BE), dhe treguesit e cilësisë tregojnë se mund të konsiderohet me cilësi të mirë për një Cens tradicional me intervistim derë më derë. Raporti përdor, si statistika bazë përshkruese - të paraqitura përmes tabelave dhe grafikëve - ashtu edhe teknika statistikore më të avancuara: regresion logjistik. Ndërsa statistikatat bazë herë pas here mund të thjeshtëzojnë tepër ose të paraqesin në mënyrë të pamjaftueshme marrëdhëniet midis dy variablave, analiza e regresionit lejon shqyrtimin e shumë variablave njëkohësisht, duke ofruar një kuptim më të qartë se si faktorë, si vendndodhja, statusi i mirëqënies së njësisë ekonomike familjare (NjEF), përkatësia etnike, aftësitë e kufizuara, mosha dhe gjinia ndërveprojnë dhe ndikojnë në jetët e popullsisë në moshë të re.

Ndryshimi demografik

Shqipëria ka përjetuar transformime të rëndësishme demografike gjatë disa dekadave të fundit, ku rënia e popullsisë dhe plakja janë zhvillimet më të dukshme. Që nga viti 1989, Shqipëria ka pasur një rënie të konsiderueshme të popullsisë në moshë të re. Numri i personave nën 30 vjeç ka rënë nga afërsisht 2 milionë në 1989 në 800 mijë në vitin 2023. Fëmijët (0-17 vjeç) pësuan rënie nga gati 1,1 milion në 374 mijë; të rinjtë (15-24 vjeç) nga 623 mijë në 286 mijë; dhe rinia (15-29 vjeç) nga 921 mijë në 430 mijë. Për sa i përket përpjesës së popullsisë, fëmijët, dhe segmentet e të rinjve kanë rënë pothuajse vazhdimisht që nga viti 1979. Përqindja e fëmijëve ra nga 44,0 në 19,1 përqind, ajo e të rinjve nga 21,5 në 11,9 përqind dhe ajo e rinisë nga 28,9 në 17,9 përqind. Këto ndryshime demografike ndodhin në të gjithë vendin, por me dallime të dukshme në nivel qarqesh. Për shembull, rënia e pjesës së fëmijëve që nga Censi 2011 ishte më e madhja në Gjirokastrë dhe Fier (rënie prej afro 50 përqind) dhe më e vogla në Berat dhe Tiranë (rënie prej 30 dhe 19 përqind, përkatësisht). Raporti gjinor i popullsisë në moshë të re (0-29) në vitin 2023 ishte 103,3 meshkuj për 100 femra. Megjithatë, ekzistojnë dallime midis grupmoshave: një raport jashtëzakonisht i lartë prej 107,7 për fëmijët (që mund të jetë në përputhje me praktikën e përzgjedhjes së gjinisë së fëmijës), dhe vetëm 97,7 për të rinjtë dhe 99,3 për rininë, duke nxjerrë në pah emigrimin joproporcional të meshkujve.

Martesa dhe struktura e njësive ekonomike familjare

Modelet e martesave në Shqipëri kanë pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë dekadave të fundit. Përpjesa e individëve që nuk janë martuar asnjëherë ka rënë nga 53,5 përqind në vitin 1989 në 36,6 përqind në 2023, ndërsa përqindja e atyre që janë aktualisht të martuar është rritur nga 42,8 në 52,5 përqind. Meshkujt kanë më shumë gjasa të mbeten të pamar-tuar, dhe martesa e hershme mbetet e rrallë mes të rinjve ku vetëm 5,4 përqind e atyre të moshës 20 vjeç janë të martuar, ndërsa pothuajse 75 përqind e 25-vjeçarëve janë ende beqarë. Ekziston një hendek i qartë gjinor lidhur me kohën e martesës: në moshën 25 vjeç, 40 përqind e femrave janë të martuara, krahasuar me më pak se 10 përqind të meshkujve. Mosha mesatare në martesë është rritur midis viteve 2011 dhe 2023, me moshën mesatare të meshkujve në rritje nga 28 në 32,4 vjeç dhe të femrave nga 22 në 26,3 vjeç.

Strukturat e NjEF-ve reflektojnë ndryshimet sociale dhe demografike. Vetëm 5,2 përqind e individëve të moshës 15-24 vjeç janë personi i referencës në NjEF, me pak më shumë

femra sesa meshkuj që e mbajnë këtë rol. Megjithatë, midis atyre të moshës 15-29 vjeç, meshkujt janë më shpesh persona referimi në NjEF. Një shifër e konsiderueshme prej 12,7 përqind e femrave të reja identifikohen si nuse, duke treguar traditën e jetesës me NjEF-të e bashkëshortëve pas martesës. Madhësia mesatare e NjEF-së ka pësuar rënie me kalimin e kohës, dhe aktualisht është rreth 3,2 persona. NjEF-të që kanë fëmijë ose të rinj në përbërjen e tyre janë përgjithësisht më të mëdha se ato pa to. Nga mosha 11 deri në 17 vjeç, përqindja e fëmijëve që jetojnë pa babanë mbetet e pandryshuar, rreth 1 në 11 fëmijë. Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa nënën është pak mbi 1 përqind dhe arrin në 2 përqind në moshën 13 vjeç. Në moshën 17 vjeç, 5,5 përqind e fëmijëve nuk e kanë nënën të pranishme, një nivel më i lartë se në moshat më të reja, ndoshta sepse disa fëmijë në këtë moshë largohen nga shtëpia për të ndjekur shkollën. Më pak se 1 përqind e foshnjave nuk jetojnë me asnjërin nga prindërit; kjo përqindje rritet në 1 përqind në moshën 3 vjeç dhe arrin gradualisht në 2,8 përqind në moshën 15 vjeç. Shumica e fëmijëve (mbi 75 përqind) jetojnë në NjEF me përbërje tradicionale të bërthamave familjare, ndërsa rreth 21,5 përqind jetojnë në familje të zgjeruara, me të afërm të tjerë. Djemtë e rinj kanë më shumë gjasa të jetojnë në familje bërthamë, ndërsa vajzat e reja jetojnë më shpesh në familje të zgjeruara, duke reflektuar modelet e martesës dhe jetesës pas martesës.

Aftësitë e shkrimit dhe leximit

Shqipëria ka arritur një shkallë të lartë të shkollimit kombëtar prej 97,8 përqind midis personave mbi 10 vjeç, ndërsa grupmoshat më të reja tregojnë nivele edhe më të larta (mbi 99 përqind). Midis fëmijëve dhe të rinjve, analfabetizmi është i rrallë, por jo i papërfillshëm: rreth 1.600 fëmijë dhe 4.500 rini (15-29 vjeç) ende nuk janë në gjendje të lexojnë ose të shkruajnë. Mesatarja kombëtare fsheh pabarazi të konsiderueshme që prekin grupe të caktuara. Të dhënat e Censit 2023 tregojnë pabarazi bazuar në përkatësinë etnike, aftësitë e kufizuara dhe statusin socio-ekonomik. Të rinjtë nga komunitetet Egjiptiane dhe veçanërisht ato Rome përballen me rreziqet më të larta, me shkallën e analfabetizmit që arrin në 35 përqind midis të rinjve Romë - veçanërisht të larta midis vajzave dhe grave të komunitetit Romë. Duke kontrolluar efektin e faktorëve të tjerë tek personat e rinj në moshën 10-29 vjeç, Romët/Egjiptianët kanë gati 30 herë më shumë gjasa të jenë analfabetë krahasuar me bashkëmoshatarët me etnicitet shqiptar. Megjithatë, faktori më i rëndësishëm i rrezikut për të qenë analfabetë është aftësia e kufizuar. Të rinjtë me aftësi të kufizuara kanë pothuajse 100 herë më shumë gjasa të jenë analfabetë sesa ata pa aftësi të kufizuara. Mungesa e prindërve gjithashtu shihet si një disavantazh i qartë. Mungesa e nënës, në veçanti, shoqërohet me një rrezik shumë më të lartë analfabetizmi. Efekte të tjera të dukshme u gjetën lidhur me qarkun e banimit, gjininë dhe llojin e NjEF-së.

Pjesëmarrja në arsim

Shkalla e ndjekjes së arsimit sipas moshës tregon pjesëmarrje pothuajse universale gjatë arsimit bazë të detyrueshëm (arsimi fillor dhe i mesëm i ulët), me një rënie të lehtë prej rreth 1,3 përqind në klasat nga 1 tek 9. Pjesëmarrja bie më ndjeshëm në arsimin e mesëm të lartë, duke rënë nga 95,3 përqind në moshën 14 vjeç në 87,6 përqind në moshën 17 vjeç. Në moshat e arsimit të lartë (18-22 vjeç), pjesëmarrja vazhdon të bjerë, por ende tregon angazhim të dukshëm. Dallimet gjinore në pjesëmarrje janë minimale gjatë arsimit bazë, por zgjerohen në nivele më të larta. Femrat kanë shkallë më të lartë vazhdimësie dhe më të ulëta braktisjeje sesa meshkujt, veçanërisht në arsimin e lartë, ku shkalla e femrave që ndjekin shkollën është mbi 20 përqind më shumë se sa meshkujt. Sipas Censit 2023, një fëmijë 6-vjeçar pritet të përfundojë 14,2 vite shkollimi, me vajzat që priten të marrin një vit më shumë se djemtë. Kjo “pritsmëri e jetës shkollë” është përmirësuar nga Censit 2011 ku vlera ishte 13,8 vite.

Duke u fokusuar te të rinjtë jashtë shkollës, Censi 2023 zbulon se 3,5 përqind e fëmijëve të moshës 6-14 vjeç - afërsisht 8,3 mijë – nuk po ndjekin arsimin bazë të detyrueshëm, duke

prekur edhe pse në vlera të vogla, më shumë djemtë sesa vajzat. Shkalla e fëmijëve jashtë shkollës është më të lartë në nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe shumë më të lartë në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, ku 7,3 mijë fëmijë (kryesisht meshkuj) janë jashtë shkollës. Prapa këtyre shifrave faktorë të ndryshëm identifikohen si përcaktues të rrezikut për të qenë jashtë shkollës për personat e rinj 6-22 vjeç. Mospjesëmarrja në arsim ndikohet fuqishëm nga aftësitë e kufizuara dhe përkatësia etnike. Të rinjtë nga komuniteti Rom/Egjiptian dhe personat me aftësi të kufizuara kanë rrezik mospjesëmarrjeje në arsim rreth 6 herë më të lartë se personat me etnicitet shqiptar dhe personat pa aftësi të kufizuara. Moshë dhe statusi martesor janë parashikues edhe më të fortë të mos ndjekjes së arsimit. Të rinjtë në moshën e arsimit të mesëm të lartë kanë një rrezik 1,6 herë më të lartë për të mos ndjekur arsim krahasuar me fëmijët në moshën e arsimit fillor. Për të rinjtë në moshën e arsimit të lartë, ky rrezik është më shumë se 24 herë më i lartë. Rreziku shumë i lartë për personat e martuar ndonjëherë që të mos ndjekin arsim (më shumë se 12 herë më i lartë se personat që nuk janë martuar asnjëherë) nënvizon se për shumë njerëz, pavarësisht gjinisë, karriera arsimore dhe ajo martesore janë të papajtueshme. Faktorë shtesë rreziku për mospjesëmarrje janë statusi mirëqënies në NjEF dhe mungesa e një ose më shumë prindërve në NjEF.

Niveli më i lartë arsimor i arritur

Censi 2023 tregoi se shumica dërrmuese e personave të moshës 15 vjeç e lart kishin përfunduar të paktën një nivel arsimimi. Vetëm 0,6 përqind raportuan se nuk kishin arsim, me norma pak më të larta tek femrat. Krahasuar me Censin 2011, përqindja e fëmijëve, të rinjve dhe të rinisë që nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimi është shumë më e ulët, duke treguar përparim në pjesëmarrjen dhe përfundimin e arsimit. Në vitin 2011, përqindja e të rinjve të moshës 15-24 vjeç që nuk kishin përfunduar asnjë nivel ishte 7,8 përqind, kundrejt vetëm 1,6 përqind në vitin 2023. Për rininë, ndryshimi ishte disi më i vogël: 5,8 kundrejt 1,8 përqind. Sa i përket niveleve të përfunduara të arsimit, shumica e fëmijëve të moshës 10-17 vjeç kishin përfunduar vetëm arsimin fillor (58 përqind) ose arsimin e mesëm të ulët (40,3 përqind). Dallimet gjinore shfaqen tek rinia: 35,2 përqind e femrave të moshës 15-29 vjeç kishin përfunduar arsimin e lartë kundrejt 20,2 përqind të meshkujve. Ky hendek gjinor thellohet më tej tek grupmosha 25-29 vjeç, ku 57,6 përqind të femrave kanë përfunduar arsimin e lartë krahasuar me 34,6 përqind të meshkujve, duke nxjerrë në pah tendencën ndërkombëtare të rritjes së arsimimit mes femrave në moshë të re. Në nivel qarku, Tirana kryeson me përqindjen më të lartë të të rinjve (25-29 vjeç) që kanë kualifikime të larta (60,3 përqind), ndërsa Dibra mbetet pas me norma më të ulëta të arsimit të lartë dhe përqindje më të larta të individëve që kanë përfunduar vetëm arsimin e mesëm të ulët. Censi 2023 tregoi se Shqipëria ka bërë përparim në normat e përfundimit të arsimit, të cilat janë tregues për monitorimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4.1. Shkalla e përfundimit tek të rinjtë e moshës 20-24 vjeç janë përkatësisht 98,2, 96,9 dhe 86,9 përqind për arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.

Aftësia e kufizuar

Edhe pse censet kanë tendencë të nën-raportojnë aftësitë e kufizuara, ato japin të dhëna të rëndësishme për zhvillimin e politikave. Censi 2023 përfshiu një modul për aftësinë e kufizuar, duke përdorur Grupin e Shkurtër të Pyetjeve të Grupit të Washington-it, duke synuar njerëzit e moshës pesë vjeç e lart për të vlerësuar gjashtë fusha funksionale (në shikim, në dëgjim, në ecje, kujtesë, kujdesin e perdritshëm ndaj vetes dhe në komunikim). Analiza tregoi prevalencë të ulët të aftësisë së kufizuar tek fëmijët dhe të rinjtë (rreth 1 përqind), me norma më të larta tek grupmoshat më të mëdha dhe femrat, megjithëse meshkujt e rinj shfaqën prevalencë pak më të lartë se femrat. Aftësitë e kufizuara ishin më të zakonshme tek NjEF-të me vështirësi ekonomike dhe lidhen me aksesin e kufizuar në shërbime si ambientet e banjës dhe tualetet brenda banesës. Dallime në arsim ishin të dukshme: të rinjtë me aftësi të kufizuara kishin norma shumë më të ulëta të shkrim-leximit, pjesëmarrjes në shkollë dhe

arsimit të lartë sesa bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara, veçanërisht tek meshkujt. Censi 2023 zbuloi se shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetonin në NjEF bërthama ose NjEF të zgjeruara, me një përqindje të konsiderueshme në NjEF-të me një prind të vetëm. Barazia gjinore ndryshonte sipas grupmoshës, duke treguar se femrat kishin pjesëmarrje më të lartë në shkollë dhe arritje arsimore në përgjithësi.

Niveli i mirëqënies

Në këtë kapitull theksohet se 21,6 përqind e fëmijëve jetojnë në NjEF që i i përkasin kuintilit më të ulët të mirëqënies. Një regresion logjistik tregoi se rreziqet ndryshojnë ndjeshëm sipas qarkut, llojit të NjEF, statusit të aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike dhe pranisë prindërore. Fëmijët në Dibër kanë më tepër gjasa për t'u përfshirë në kuintilin më të ulët të mirëqënies, ndërsa ata me prindër që mungojnë (emigrantë) kanë më pak gjasa të jenë tek kjo kategori, ndoshta për shkak të remitancave. Aksesit në ujë të pastër, tualete dhe ambiente për larje është përgjithësisht i lartë, megjithatë në grupe të caktara këto shërbime mungojnë. Pothuajse të gjithë fëmijët kanë energji elektrike, por 60 përqind jetojnë në NjEF-e që ngrohen me dru, duke paraqitur rreziqe shëndetësore dhe mjedisore.

1. Hyrje

1.1 Konteksti i përgjithshëm

Fëmijët (0-17 vjeç), të rinjtë (15-24 vjeç) dhe rinia (15-29 vjeç) përbëjnë një segment jetik dhe dinamik të popullsisë së Shqipërisë. Nga një popullsi prej 2,4 milionë banorësh, 804 mijë janë në grupmoshën 0-29 vjeç, që përfaqëson një të tretën e popullsisë gjithsej. Ata mund të shihen si nxitës kyç të zhvillimit – kur janë të pajisur me aftësitë e duhura, përparimi i tyre përshpejton arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Shqipëria ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) më 11 dhjetor 1991 (Ligji nr. 7531) dhe më vonë miratoi dy Protokolle Opsionale për të forcuar mbrojtjen e fëmijëve nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe nga shfrytëzimi seksual. Këto angazhime kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e legjislacionit dhe politikave kombëtare. Në tetor 2023, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës publikoi Vërejtjet përfundimtare mbi raportin e përbashkët të pestë dhe të gjashtë të Shqipërisë, duke theksuar nevojën për veprime më të fuqishme nga ana e qeverisë shqiptare për të përmirësuar situatën e fëmijëve. Në veçanti, Komiteti kërkoi forcimin e sistemeve të të dhënave për të monitoruar më mirë zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë mbledhjen dhe analizën e të dhënave të besueshme dhe të disagreguara.

Agjenda Kombëtare e Shqipërisë për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 është në përputhje me KDF-në dhe pasqyron angazhimin e vendit ndaj standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Axhenda bazohet në katër parimet e përgjithshme të KDF-së: i) mosdiskriminimi, ii) interesat më të mira të fëmijës, iii) e drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, dhe iv) respektimi i pikëpamjeve të fëmijës (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2021). Një seri masash është përfshirë në kuadër të qëllimit të parë strategjik të Agjendës, duke përfshirë edhe përmirësimin e publikimit të të dhënave dhe analizave me fokus tek fëmijët.

Për më tepër, Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 në Shqipëri u zhvillua si përgjigje ndaj sfidave dhe mundësive me të cilat përballen të rinjtë në të gjithë vendin. Ajo synon të vendosë të rinjtë shqiptarë në zemër të zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar angazhimin e tyre kuptimplotë në formësimin e të ardhmes së tyre. Strategjia ka disa objektiva:

- Të promovojë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në shoqëri, duke u mundësuar të rinjve të flasin vetë dhe të ndikojnë në vendimmarrje.
- Të përmirësojë perspektivat e punësimit të të rinjve përmes zhvillimit të aftësive, këshillimit për karrierën dhe qasjes të barabartë në mundësitë e tregut të punës.
- Mbështetje ndaj mirëqenies fizike, mendore dhe sociale të të rinjve.
- Nxitjen e inovacionit dhe sigurimi i pjesëmarrjes në arsim cilësor, duke i mundësuar të rinjve të arrijnë potencialin e tyre të plotë.
- Të mundësohet siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të gjithë të rinjve, me vëmendje të veçantë ndaj atyre në rrezik ose në situata të cënueshme.
- Të krijojë politika ndërsektoriale për të rinjtë, të koordinuara, të bazuara në prova dhe të mbështetura nga fonde të mjaftueshme, si dhe të krijojë mekanizma të fortë monitorimi dhe vlerësimi në të gjitha nivelet (Qeveria e Shqipërisë, 2022).

Përtej të sipërpërmendura, qeveria shqiptare ka publikuar disa plane politikash në të cilat pozicioni i fëmijëve, të rinjve dhe rinisë luan një rol qendror. Për shembull, një nga qëllimet strategjike të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 ishte ‘sigurimi dhe ofrimi i një arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara’. Përveç qëllimit për arsimin, Plani Kombëtar i Veprimit thekson gjithashtu rëndësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe zhvil-

limin e masave të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2021).

Në përputhje me parimet e OZHQ-së për të mos lënë askënd pas, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 prezantoi disa masa për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve të pakicave etnike Rome dhe Egjiptiane. Pikat kryesore që lidhen me fëmijët në këtë Plan Veprimi ishin masat për të përmirësuar pjesëmarrjen në arsim, për të rritur sensibilizimin e regjistrimit të lindjeve, rritjen e mbulimit të vaksinimit dhe shërbimeve shëndetësore, parandalimin e martesave të hershme dhe braktisjes së shkollës për shkak të martesave të hershme, si dhe mbledhjen e të dhënave të ndara për gjendjen e fëmijëve romë/egjiptianë (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2021).

1.2 Organizimi i raportit

Ky raport shqyrton gjendjen aktuale të fëmijëve, të rinisë dhe të të rinjve në Shqipëri, bazuar në Censin 2023. Raporti është pjesë e një nisme më të gjerë për të publikuar analiza tematike bazuar në të dhënat e Censit 2023. Raporti nxjerr në pah gjendjen e fëmijëve dhe të rinjve në vitin 2023 nëpërmjet perspektivave të ndryshme. Në të gjithë raportin, termi “fëmijë” i referohet personave në grupmoshën 0-17 vjeç, “të rinj” atyre në grupmoshën 15-24 vjeç, ndërsa “rinia” përfshin grupmoshën 15-29 vjeç.

Ky kapitull hyrës përfshin një seksion mbi metodologjinë (seksioni 1.3). Ai përshkruan shkurtimisht Censin 2023 si burimin kryesor të informacionit për këtë raport, si dhe metodologjinë kërkimore të përdorur për analizën e raportit.

Pas kësaj hyrjeje, raporti ofron një përmbledhje të situatës demografike në Shqipëri, duke theksuar rënien e përgjithshme të popullsisë, veçanërisht tkurrjen e popullsisë në moshë të re dhe uljen e përqindjes së tyre krahasuar me grupmoshat më të mëdha. Kapitulli i tretë trajton martesat tek të rinjtë dhe strukturën e NjEF-ve të fëmijëve, të rinjve dhe rinisë. Vëmendje e veçantë i kushtohet moshës në martesën e parë, barazisë gjinore në martesë sipas moshës, martesës së fëmijëve dhe prishjes së martesave ndër të rinjtë. Në seksionin për strukturën NjEF, shqyrtohet marrëdhënia me kryefamiljarin, si edhe madhësia e NjEF-ve, mungesa e prindërve dhe lloji i NjEF-së.

Kapitulli katër i shqyrton aftësitë e shkrimit dhe leximit dhe arsimin. Ndër të tjera, analizohen personat që nuk ndjekin shkollën, ata pa asnjë nivel arsimor dhe niveli më i lartë arsimor i arritur. Kapitulli pesë trajton grupin vulnerabël të të rinjve me aftësi të kufizuara. Përveç prevalencës së aftësisë së kufizuar, kapitulli shqyrton karakteristikat e përgjithshme të popullsisë në moshë të re me aftësi të kufizuara. Po ashtu, kapitulli analizon nivelin e jetesës së kësaj popullsie. Në kapitullin përfundimtar shqyrtohet niveli i jetesës së popullatës në moshë të re përmes statusit të mireqënies të NjEF-së ku banojnë, si dhe përmes shërbimeve bazë që aksesojnë si: furnizimi me ujë, tualeti dhe dhomat e larjes, energjia elektrike dhe ngrohja në banesë.

1.3 Metodologjia

1.3.1 Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Konteksti i përgjithshëm

Censi 2023 shënoi censin e 12-të në historinë e Shqipërisë. I gjithë procesi i censit, përfshirë zhvillimin e metodologjisë, mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe shpërndarjen, u realizua nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), në përputhje me Ligjin Nr. 140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe Banesave” (Republika e Shqipërisë, 2020). I parashikuar fillimisht

për vitin 2020, censi u shty për shkak të pandemisë COVID-19 dhe vështirësive në sigurimin e materialeve të nevojshme. Puna në terren u zhvillua në periudhën shtator-nëntor 2023, ndërsa të dhënat i referohen momentit të censit: mesnata midis 17 dhe 18 shtatorit 2023. INSTAT publikoi rezultatet kryesore të censit në qershor 2024, shtatë muaj pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave (INSTAT, 2024)¹.

Metodologjia e Censit 2023

Censi 2023 ishte një cens tradicional në kuptimin e mbulimit të të gjithë territorit, duke shkuar në çdo banesë dhe NjEF dhe duke mbledhur informacion për të gjithë individët, brenda një periudhe kohore të paracaktuar. Zbatimi solli risi të rëndësishme, duke përfshirë përdorimin e tabletave për intervista personale të asistuar nga kompjuteri (CAPI) dhe harta dixhitale interaktive me vendndodhje gjeo-referencuese të ndërtesave dhe kufijve të zonave të censit (ZC).

Ashtu si në censin e mëparshëm (Censi 2011), Censi 2023 ndoqi parimin de-jure, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Ekonomik për Europën të Kombeve të Bashkuara (UNECE) për raundin 2020 të Censeve të Popullsisë dhe Banesave (UNECE, 2015). Kjo do të thotë që individët u numëruan në vendbanimin e tyre të zakonshëm, pavarësisht nëse ishin fizikisht aty në momentin e Censit 2023. Në hartimin e pyetësorit të censit, INSTAT përfshiu temat kryesore të rekomanduara nga UNECE, duke adresuar gjithashtu nevojat specifike për informacion të palëve të interesit në Shqipëri, siç janë qeveritë kombëtare dhe vendore, grupet minoritare dhe fetare, akademja dhe organizatat ndërkombëtare në vend. Për të mbrojtur informacionin personal, u zhvilluan procedura të dedikuara dhe sisteme të avancuara IT që garantuan konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave. Censi 2023 përfshiu pyetje mbi karakteristikat etno-kulturore, besimi fetar dhe gjuha, të cilat sipas ligjit, bazohen në parimin e vetë-identifikimit. Të anketuarit kishin të drejtën të zgjidhnin “Preferoj të mos përgjigjem” si përgjigje të vlefshme. Për të siguruar mbledhjen dhe ruajtjen e saktësisë së informacionit, u zbatuan procedura specifike (INSTAT, 2024).

Përveç stafit të përhershëm të INSTAT-it të zyrave qendrore dhe në nivel qarku, Censi 2023 mobilizoi mbi 6.800 staf të përkohshëm për zbatimin e numërimit në terren. Këtu përfshihen 5,240 anketues të ngarkuar me censin e informacionit mbi banesat, NjEF-t dhe individët në zonat e tyre të caktuara. Për të siguruar cilësinë dhe koordinimin e punës në terren, cens angazhoi gjithashtu 1,048 kontrollues, 170 mbikëqyrës dhe 280 staf mbështetës të teknologjisë së informacionit dhe Sistemit Gjeografik të Informacionit (GIS) ², të cilët ofruan asistencë teknike dhe mbikëqyrje gjatë gjithë procesit të mbledhjes së të dhënave.

Cilësia e Censit 2023

Cilësia e censit të popullsisë është një koncept shumëdimensional që përfshin faktorë të tillë si rëndësia, saktësia dhe besueshmëria, kohëzgjatja, krahasueshmëria, përdorimi i metodologjive dhe procedurave të shëndosha dhe barra e të anketuarve. Për vendet e BE-së, raportimi mbi këto dimensionale të cilësisë është i detyrueshëm dhe INSTAT ka adoptuar të njëjtën qasje për Censin 2023. Ndonëse asnjë cens nuk është pa të meta, Censi 2023 në përgjithësi konsiderohet të jetë me cilësi të mirë, veçanërisht duke marrë parasysh se u ndoq metoda tradicionale e numërimit derë më derë. Veçanërisht, përmirësime të rëndësishme u arritën në disa dimensionale të cilësisë krahasuar me censin e mëparshëm, sidomos përmes përdorimit të teknologjive inovative si CAPI dhe mjetet e mbledhjes së të dhënave bazuar në GIS. Raportimi nga projekti i Asistencës Teknike për Censin 2023 (de Bruijn, 2024) nxorri vlerësimin e mëposhtëm të cilësisë:

¹ Për shembull, opsionet e përgjigjeve për secilën prej këtyre pyetjeve u rrotulluan në mënyrë rastësishme në ekranin e tabletit për të minimizuar paragjykimin e përgjigjeve, dhe secila pyetje përfshinte mundësinë për të specifikuar çdo përgjigje tjetër përveç opsioneve të paracaktuara. Çdo përgjigje duhej të konfirmohej nga i anketuari në tablet; pasi të konfirmohej, përgjigjet kyçeshin dhe ruheshin veçmas, pa mundësi modifikimi të mëvonshëm.

² Sistemi Gjeografik i Informacionit

- Në aspekte kyçe, të tilla si temat, konceptet dhe përkufizimet, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave, procedurat e mbledhjes së të dhënave, deklarimi i lirë i karakteristikave etno-kulturore dhe përdorimi i klasifikimeve dhe kodimit të standardizuar, Censi 2023 iu përmbajt standardeve ndërkombëtare. Ai ishte plotësisht në përputhje me Rregulloren e BE-së për Censet e Popullsisë dhe Banesave (Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së, 2008), si dhe me rekomandimet e UNECE-së për Censet e Popullsisë dhe Banesave 2020 (UNECE, 2015).
- Risetë në përdorim e CAPI-t solli përmirësime të mëdha në Censin e vitit 2023. Kjo teknologji u ofroi anketuesve udhëzime të integruara dhe mjete mbështetëse gjatë intervistave, mundësoi kontrolle automatike të cilësisë dhe reduktoi ndjeshëm gabimet e kapërcimit të pyetjeve. Gjithashtu ndihmoi në shkurtimin e kohës së intervistave, minimizoi humbjen e të dhënave dhe lehtësoi monitorimin pothuajse në kohë reale të punës në terren. Si rezultat, përpjesa e të dhënave pa gabime të dukshme në nivel individ u rrit nga 58 përqind në censin e 2011, në 94 përqind në 2023.
- Përdorimi i aplikacioneve GIS dhe hartave dixhitale të ZC uli ndjeshëm gabimet si mungesat dhe dublikimet gjatë numërimit të NjEF-ve dhe banesave. Këto mjete gjithashtu i ndihmuan anketuesit të orientoheshin më lehtë drejt dhe brenda zonave të tyre të caktuara dhe mundësuan monitorimin e saktësisë gjeografike të procesit të Censit 2023.
- Shkalla e refuzimit në Censin 2023 ishte 0,6 përqind, krahasuar me 2,2 përqind në Censin e vitit 2011.
- Një Anketë Pas Cens (APC) e kryer menjëherë pas Censit 2023 vlerësoi një nën mbulim prej 3,1 përqind, një rezultat i mirë për një cens tradicional. Rezultatet e APC u përdorën për të përditësuar rezultatet e Censit 2023 me 'popullsinë reale' në momentin e Censit 2023.
- APC vlerësoi gjithashtu besueshmërinë e të dhënave kryesore të Censit. Për moshën, gjininë dhe statusin martesor, shkalla e përputhshmërisë, përqindja e rasteve kur APC dhe Censi regjistruan të njëjtën përgjigje për një karakteristikë të caktuar - u gjet përkatësisht 94,7, 99,8 dhe 98,7 përqind. Indeksi Whipple për saktësinë e moshës është 102, duke treguar raportim 'shumë të saktë' të moshës. Në mënyrë të ngjashme, Indeksi Myers Blended për Censin e vitit 2023 është 0,9, gjë që tregon gjithashtu raportim të mirë të moshës (llogaritjet e autorëve)³. Pasaktësitë e vogla në raportimin e moshës ka të ngjarë të jenë të përqendruara tek të anketuarit më të moshuar dhe nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në analizën e fëmijëve, të rinjve dhe rinisë të paraqitur në këtë raport.
- Koha e prodhimit midis momentit të referencës, (momentit të Censit 18 shtator 2023) dhe publikimit të të dhënave përfundimtare të Censit ishte 9,5 muaj. Periudha midis përfundimit të mbledhjes së të dhënave dhe publikimit ishte 7 muaj, duke treguar shpërndarje shumë të shpejtë për një cens tradicional.

1.3.2 Metodologjia e hulumtimit për raportin

Qasje e përgjithshme

Ky raport bazohet në të dhënat nga Censi 2023. Nëse nuk specifikohet ndryshe, të gjitha shifrat dhe gjetjet e paraqitura këtu janë nxjerrë nga Cens 2023. Përkufizimet e koncepteve kyçe të përdorura në këtë raport mund të gjenden në Shtojcën 1. Për një kuptim të mirë të përmbajtjes së raportit, është e rëndësishme të njihen grupimet demografike që janë objekt i analizës:

- Fëmijë: Popullsia e moshës 0-17 vjeç.
- Të rinjtë: Popullsia e moshës 15-24 vjeç.
- Popullsia në moshë të re: Popullsia e moshës 0-29 vjeç.
- Rinia: Popullsia e moshës 15-29 vjeç.

³ Indeksi Whipple është një tregues demografike për të matur tendencën e individëve për të raportuar në mënyrë të pasaktë moshën e tyre duke e rrumbullakosur në moshat që mbarojnë me 0 ose 5. Çdo vlerë për Indeks të Whipple nën 105 konsiderohet se përfaqëson raportim shumë të saktë të moshës. Indeksi Myers Blended pasqyron preferencat ose mospëlqimet për secilën nga dhjetë shifrat, nga 0 deri në 10. Një vlerë për indeksin - teorikisht midis 0 dhe 180 - nën 5 konsiderohet se përfaqëson raportim të mirë të moshës (UNDESA, 1956).

Duhet theksuar se informacioni mbi popullsitë në moshë të re përfshin të gjithë individët, qofshin ata që jetojnë në NjEF private apo në institucione⁴.

Qasja metodologjike për këtë analizë përbëhet nga disa faza:

1. Përcaktimi i fushës së raportit. Në konsultim me INSTAT dhe UNICEF Shqipëri, u përcaktuan temat që do të trajtoheshin në raport. U morën në konsideratë aspekte të ndryshme, duke përfshirë disponueshmërinë e moduleve specifike të të dhënave të Censit, mbivendosjen me raportet e tjera tematike të Censit 2023 (që do të publikohen) nga INSTAT dhe temat e prioritare për INSTAT dhe UNICEF Shqipëri.
2. Aktivitetet përgatitore, duke përfshirë:
 - a Shqyrtimi i literaturës mbi temat e rëndësishme për analizat dhe konsultimin e bazave të të dhënave ndërkombëtare për të krahasuar rezultatet e Censit 2023 me vendet e tjera.
 - b Specifikimi i variablave të derivuara të nevojshme për analizën.
 - c Specifikimi i tabelave të të dhënave hyrëse për analizën, bazuar në një shqyrtim të pyetësorit të Censit.
 - d Zhvillimi i skedarëve sintaksor SPSS për analizat e regresionit logjistik binar (shiko më poshtë) mbi bazën e një kampioni të të dhënave të censit.
 - e Prodhimi i tabelave të të dhënave hyrëse dhe zbatimi i regresioneve logjistikike.
3. Analiza e tabelave të të dhënave hyrëse dhe zbatimi i rezultateve të regresionit logjistik, si dhe përpilimi i raportit paraprak.
4. Rishikimi i jashtëm dhe përgatitja e raportit përfundimtar.

Ky raport nuk kufizohet vetëm në analizën e tabelave të thjeshta që shqyrtojnë marrëdhënien midis dy ose tre variablave. Në realitet, shumë marrëdhënie ndikohen nga disa faktorë njëkohësisht, dhe tabelat e thjeshta mund të fshehin marrëdhënien aktuale të variablave të përfshirë. Teknikat më të avancuara janë të rëndësishme sepse lejojnë një kuptim më të saktë dhe kuptimplotë të marrëdhënieve të të dhënave.

Regresioni logjistik

Në disa seksione të këtij raporti, përdoren regresione logjistike. Kjo është një teknikë statistikore që përfshin shumë variabla dhe përcakton ndikimin e faktorëve të ndryshëm mbi një rezultat specifik. Regresioni logjistik përdoret kur elementi që do të shqyrtohet (variabli në varësi) është dikotom, për shembull, nëse dikush është i shkolluar apo jo. Kjo metodë ndihmon të kuptohet se sa e mundshme është që dikush të ketë një karakteristikë të caktuar, në varësi të faktorëve të tillë si mosha, vendi i banimit, gjinia apo statusi i aftësisë së kufizuar. Për secilin faktor që shpjegon variablin e varur, zgjidhet një kategori si kategori referuese, e cila shërben si bazë për krahasim. Për shembull, në rastin e gjinisë, femrat krahasohen me meshkujt, ku meshkujt shërbejnë si kategori referimi.

Ajo që e bën këtë teknikë regresioni veçanërisht të dobishme është se ajo shqyrton të gjithë faktorët njëkohësisht. Kjo do të thotë se mund të matim ndikimin e secilit faktor veçmas, ndërkohë që kontrollojmë statistikisht për efektin e të gjithë faktorëve të tjerë në analizë. Për shembull, në analizën e regresionit, pohimi se statusi i aftësisë së kufizuar ka një lidhje të fortë negative me aftësinë e shkrimit dhe leximit qëndron, edhe pasi merren parasysh faktorë të tjerë ndikues si mosha, gjinia, etj. Duke qenë se analiza trajton të dhëna nga e gjithë popullsia – dhe jo nga një kampion – raporti nuk fokusohet te fakti nëse rezultatet janë statistikisht të rëndësishme në kuptimin e zakonshëm. Në vend të kësaj, vëmendja i kushtohet madhësisë së dallimeve midis grupeve, qofshin ato të mëdha apo të vogla.

Për të lehtësuar interpretimin e rezultateve, të gjitha vlerat paraqiten si ndryshime në përqind-

⁴ Në Cens, një NjEF përcaktohet si një grup personash që jetojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët. Kjo përfshin sigurimin e përbashkët të ushqimit për vaktet kryesore, strehimin dhe nevojat e tjera të domosdoshme për jetesë.

jeje nga grupi referues. Grafikët me rezultatet e analizës logjistike ilustronë mundësinë që grupet e tjera të kenë karakteristikën në krahasim me grupin referues. Pra, nëse një kategori tregon një rezultat prej 60 përqind, kjo do të thotë që grupi ka 60 përqind më shumë gjasa ta ketë karakteristikën (p.sh. analfabetizmin) sesa grupi referues. Një rezultat minus 25 përqind do të thotë se grupi ka 25 përqind më pak mundësi të ketë këtë rezultat sesa grupi referues.

Statusi i mirëqënies

Indeksi i pasurisë është një metodë e përdorur për të kuptuar se si ndryshojnë NjEF-et në aspektin e standardeve të jetesës. Ai ndihmon studiuesit dhe politikëbërësit të kuptojnë se si situatat ekonomike të NjEF-it lidhen me fusha të tilla si shëndetësia, arsimi dhe qasja në shërbimet bazë. Në shumë anketa dhe cense, indeksi i pasurisë ka treguar të jetë një nga mjetet më të fuqishme për të shpjeguar diferencimin në mirëqënien e individëve. Indeksi i pasurisë nuk fokusohet në të ardhurat, por shqyrton të mirat dhe shërbimet që NjEF-et kanë, të cilat pasqyrojnë statusin e tyre ekonomik. Kjo përfshin llojin e shtëpisë në të cilën ata jetojnë, llojin e tualetit ose furnizimit me ujë që ata përdorin, dhe nëse ata zotërojnë një sërë artikujsh të tillë si një makinë, televizor ose kondicioner.

Për këtë raport, metodologjia e Studimit Demografik dhe Shëndetësor (DHS) u përdor për të llogaritur indeksin e pasurisë (Rutstein, 2008). Për të ndërtuar indeksin, secili artikull i caktohet një peshë që pasqyron shkallën e korrelacionit të tij me mirëqënien e përgjithshme. Një metodë statistikore (komponentët kryesorë) rendit të gjithë informacionin për të përcaktuar se cilat artikuj janë më të zakonshëm tek NjEF-të në gjendje më të mirë dhe cilat janë ato të lidhura me NjEF-të me mirëqënien më të ulët. Çdo NjEF-je i caktohet më pas një pikë bazuar në atë që ka. Pasi të gjitha NjEF-ve t'i jepen pikët, ato renditen dhe grupohen, nga ato NjEF me mirëqënie më të ulët deri tek ato me mirëqënien më të lartë. NjEF-të më pas ndahen në pesë grupe me madhësi të barabartë – kuintile – nga ‘më i ulëti’ (për ata që kanë më pak mundësi), pastaj ‘i dyti më i ulëti’, ‘i mesëm’, ‘i dyti më i larti’ dhe ‘më i larti’ (për ata që kanë më shumë mundësi), ku secili përmban 20 përqind të popullsisë.

Ky variabël me pesë kategori është ‘statusi i mirëqënies së NjEF-së’ i përdorur në këtë raport. Duhet të theksohet se, ndryshe nga p.sh. linja e varfërisë, variabli i statusit të mirëqënies nuk ofron një matje të mirëqënies absolute ose të varfërisë; ai mat vetëm mirëqënien relative.

1.3.3 Kufizimet e hulumtimit

Analiza në këtë raport u kufizua nga disa pengesa praktike. Ndërsa të dhënat e Censit janë veçanërisht të vlefshme për të eksploruar situatën e nën-popullatave të vogla, siç janë minoritetet etnike, fëmijët që nuk ndjekin shkollën ose të rinjtë me aftësi të kufizuara, ato kanë kufizime në nivelin e detajeve që ofrojnë. Për më tepër, disa module të rëndësishme të Censit janë ende nën shqyrtim dhe nuk ishin të disponueshme për analizë, duke përfshirë të dhënat mbi pjesëmarrjen në tregun e punës, dhe migracionin. Këto tema janë veçanërisht të rëndësishme për të kuptuar të rinjtë/rininë, të cilët shpesh bëjnë tranzicione të rëndësishme në jetë, siç është kalimi nga arsimi në tregun e punës. Në rastin e Shqipërisë, kjo fazë e jetës përfshin gjithashtu vendime kritike rreth migracionit.


2. Një peizazh demografik në ndryshim

2.1 Ndryshimi i përgjithshëm demografik

Censet e popullsisë të dekadave të fundit kanë treguar një situatë të popullsisë në Shqipëri që ndryshon me shpejtësi. Rënia e lindshmërisë, rritja e jetëgjatësisë dhe ndryshimi i modeleve të migrimit jo vetëm që shndërrojnë madhësinë e popullsisë - nga rritje e shpejtë në rënie të shpejtë (Figura 2.1), por gjithashtu ndryshuan rrënjësisht përbërjen moshore të popullsisë. Intervali midis censeve të popullsisë 1979-1989 dëshmoi një rritje të popullsisë prej 590 mijë personash në pothuajse 3,2 milionë njerëz, duke shtuar mesatarisht 59 mijë persona në vit. Midis regjistrimeve të vitit 1989 dhe 2023, popullsia ra me 778 mijë persona në 2,4 milionë njerëz, një rënie mesatare prej 23 mijë personash në vit, por me një rënie gjithnjë e më të shpejtë me kalimin e kohës.

Grupmosha më e vjetër 65 vjeç e lart, e cila përfaqësonte 5,3 përqind të popullsisë në vitin 1979 (137 mijë persona), ishte pothuajse katërfishuar në 19,7 përqind (473 mijë persona) në vitin 2023. Pjesa e 'të moshuarve më të vjetër' - personave të moshës 85 vjeç e lart - u rrit edhe më shpejt, nga 0,4 përqind në vitin 1979 në 1,5 përqind në vitin 2023. Nga ana tjetër, pjesa e fëmijëve u ul me më shumë se gjysma në këtë periudhë, nga 37,0 përqind (958 mijë) në vitin 1979 në 15,6 përqind (374 mijë) në vitin 2023.


Figura 2.1: Popullsia, sipas vitit të censit dhe sipas grupmoshave kryesore (në mijë)




Efekti i dinamikave të popullsisë shqiptare pasqyrohet më së miri përmes piramidave të popullsisë në disa nga censet e përzgjedhura (1979, 2001 dhe 2023), të cilat tregojnë grupmoshat pesëvjeçare, sipas gjinisë (Figura 2.2). Kjo ilustron kalimin nga një piramidë popullore pothuajse klasike në vitin 1979, drejt një përbërjeje moshore ku bien në sy grupmoshat e vjetra dhe një rënie e vazhdueshme e grupmoshave të reja. Efektet e jetëgjatësisë së shtuar ("plakja në majë" e piramidës së popullsisë) dhe niveleve të lindshmërisë nën nivelin e zëvendësimit që prej fillimit të shekullit (Gjonca, Aassve, & Mencarini, 2008) ("plakja në bazë" e piramidës së popullsisë) vërehen në të gjitha vendet e BE-së, Shoqatës Europiane të Tregtisë së Lirë (EFTA) dhe ato kandidate për në BE (Eurostat, 2025). Në Shqipëri, këto efekte përforcohen nga nivelet e larta të emigracionit, i cili lidhet kryesisht me largimin e popullsisë në moshat riprodhuese (INSTAT, 2014).

Figura 2.2: Popullsia sipas gjinisë, dhe sipas grupmoshave për tre censet (in %)


a. Censi 1979



b. Censi 2001




c. Censi 2023



Raportet e varësisë sipas moshës japin tregues mbi nivelin e mbështetjes që ofrohet për personat më të rinj (mosha 0–14 vjeç) dhe ata më të moshuar (mosha 65 vjeç e lart) nga popullsia në grupmoshën ekonomisht aktive (mosha 15–64 vjeç) ose, në mënyrë të kundërt, tregojnë barrën relative ekonomike mbi këtë popullsi aktive. Deri në Censin 2011, raporti⁵ i përgjithshëm i varësisë tregoi një rënie të qëndrueshme (Figura 2.3), duke sinjalizuar baza mbështetëse gjithnjë e më të gjera për grupmoshat e reja dhe të moshuara, si në ekonomi në tërësi, ashtu edhe – veçanërisht për të rinjtë – në NjEF-të private. Periudha ndërmjet censeve të viteve 2011 dhe 2023 shënoi një pikë të rëndësishme demografike, pasi për herë të parë në historinë e Shqipërisë, popullsia e moshuar e kaloi në numër atë të re. Kjo pasqyrohet në përqindjet e varësisë së moshës së vjetër dhe të moshës së re që u kryqëzuan rreth vitit 2019. Rritja gjithnjë e më e shpejtë e popullsisë mbi 65 vjeç gjithashtu e kompensoi më shumë se sa duhet uljen e popullsisë nën moshën 15 vjeç, me pasojë që raporti i përgjithshëm i varësisë e përmbysi tendencën rënëse pas Censit 2011.

Figura 2.3: Raporti i përgjithshëm, i varësisë së moshës së re dhe i varësisë së moshës së vjetër, sipas vitit të censit (në %)



Një rritje e raportit të përgjithshëm të varësisë do të thotë se popullsia në grupmoshën ekonomisht aktive – e cila zakonisht prodhon më shumë sesa konsumon – zvogëlohet në mënyrë relative krahasuar me popullsinë më të re dhe më të moshuar, të cilët zakonisht konsumojnë më shumë sesa prodhojnë. Kjo tendencë, së bashku me proceset e ndërlikuara të një rënieje të raportit të varësisë së moshës së re dhe një rritjeje të raportit të varësisë së moshës së vjetër, nënkupton ndryshime të rëndësishme ekonomike dhe sociale. Rritja e popullsisë së moshuar, e lidhur me rritjen e raportit të varësisë së moshës së vjetër, sjell presion më të madh mbi sistemin e pensioneve dhe rritje të shpenzimeve për kujdesin shëndetësor dhe për sistemet e kujdesit afatgjatë, ndër të tjera. Në nivel familjar dhe individual, kjo nënkupton një barrë më të madhe për të rriturit, veçanërisht për gratë, për të kujdesur për anëtarët e moshuar të NjEF-së.

Tabela 2.1 tregon se raportet e varësisë në Shqipëri janë të afërta me mesataren evropiane. Veçanërisht, raporti i varësisë së moshës së re në vend është më i ulët sesa ai i fqinjëve të drejtpërdrejtë në Ballkanin Perëndimor – Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Në kontrast, raportet e varësisë së moshës së vjetër dhe raporti i përgjithshëm i varësisë janë më të larta sesa në këto vende.

⁵ Raporti total i varësisë llogaritet si numri i personave në grupmoshat ekonomisht joaktive (0-14 vjeç dhe 65 vjeç e më shumë) për 100 persona në grupmoshën ekonomisht aktive (15-64 vjeç). Raporti total i varësisë mund të ndahet në (a) raportin e varësisë së moshës së re (numri i personave 0-14 vjeç për 100 persona 15-64 vjeç) dhe (b) raportin e varësisë së moshës së vjetër (numri i personave 65 vjeç e më shumë për 100 persona 15-64 vjeç).

Tabela 2.1: Raportet e varësisë për vende të përzgjedhura (2023) (në %)

Shteti	Raportet e varësisë		
	Gjithsej	Të rinj	Të moshuar
Kosova	44.8	30.8	14.0
Maqedonia e Veriut	52.8	26.1	26.7
Bosnja dhe Hercegovina	53.5	20.3	33.2
Mali i Zi	53.7	28.0	25.7
Shqipëria	54.5	24.0	30.4
Evropa	55.3	24.1	31.2
Rumania	56.0	24.8	31.2
Greqia	57.3	20.6	36.7
Serbia	58.5	22.9	35.6
Bullgaria	61.0	22.8	38.2

Burimi për Bullgarinë, Greqinë, Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë: Eurostat, 2025

Burimi për Bosnjë dhe Hercegovinën, Evropën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë: UN World Population Prospects (Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, 2025).

Source for Bosnia and Herzegovina, Europe, Kosovo, North Macedonia, Serbia: UN World Population Prospects (United Nations Department of Economic and Social Affairs, 2025).

Raporti i përgjithshëm gjinor në Shqipëri tregoi një rënie të ndjeshme nga mbi 106 meshkuj për 100 femra në censet e viteve 1979 dhe 1989, në rreth 100 meshkuj për 100 femra në tre Censet e këtij shekulli. Censi 2023 dëshmoi raportin gjinor më të ulët deri më tani, me 98,2 meshkuj për 100 femra. Migracioni i ndarë sipas gjinisë, veçanërisht në grupmoshën e të rinjve të rritur 20–39 vjeç, është shkaku kryesor i rënies së raportit gjinor të përgjithshëm (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, 2020). Pavarësisht emigracionit të dominuar nga meshkujt dhe rënies së raportit gjinor në dekadat e fundit, vlera e Shqipërisë në vitin 2023 është më e lartë se ajo e çdo vendi të BE-së (Eurostat, 2024). Një pjesë e shpjegimit për raportin e lartë gjinor të përgjithshëm është raporti relativisht i lartë gjinor në lindje (107)⁶, i cili pasqyrohet në raportin gjinor të fëmijëve nën moshën pesë vjeç në Censin 2023, me 108,4 djem për 100 vajza⁷

2.2 Ndryshimet e popullsisë në moshë të re

2.2.1 Popullsia në moshë të re gjithnjë e më të vogla

Gjatë periudhës që nga Censi 1979, popullsia në moshë të re – subjekt i këtij raporti – është zvogëluar ndjeshëm. Pas arritjes së kulmit në Censin 1989 me gati 2,0 milionë persona, popullsia nën moshën 30 vjeç ra në 0,8 milionë në Censin 2023. Tabela 2.2 paraqet zhvillimin e numrit të tre grupeve të popullsisë në moshë të re – fëmijët, të rinjtë dhe rininë – ndërmjet censeve të viteve 1979 dhe 2023. Shtojca II ofron një ndarje më të detajuar sipas gjinisë, moshës dhe vitit të censit.

Tabela 2.2: Popullsia në moshë të re, sipas viti të censit (në mijëra)

Popullsia në moshë të re	1979	1989	2001	2011	2023
Fëmijë (0-17)	1,140.7	1,244.7	1,083.6	740.0	458.0
Të rinjtë (15-24)	556.5	623.2	527.4	512.4	286.1
Rinia (15-29)	749.5	920.9	740.4	704.3	430.3

⁶ Duke iu referuar vitit 2022 (INSTAT, 2024a).

⁷ Raportet gjinore të fëmijëve 1, 2 dhe 3 vjeç në censin e vitit 2023 (108.1, 106,2 dhe 108,1 djem për 100 vajza, përkatësisht) përputhen mirë me raportin gjinor të lindjeve të vitit 2022 të nxjerrë nga statistikave vitale (INSTAT, 2023).

Figura 2.4 tregon trendin e tre grupeve të popullsisë në moshë të re (Figura 2.4a) dhe përqindjen e tyre në popullsinë gjithsej (Figura 2.4b). Rritja relativisht e shpejtë e numrit të rinisë në dekadën para vitit 1989 (Figura 2.4a) pasqyron fertilitetin e lartë që mbizotëronte në periudhën pas luftës, ndërsa rënia e theksuar në dekadën pas vitit 1989 ndoshta tregon valën e madhe të emigracionit në vitet 1990, e cila lidhej veçanërisht me grupmoshën 20-29 vjeç, pjesë e popullsisë së rinisë. Pa ndikimin e migracionit, popullsia e rinisë – dhe pjesërisht edhe ajo e të rinjve – do të kishte shënuar rritje, duke qenë se fertiliteti ka qenë mbi nivelin e zëvendësimit gjatë gjithë periudhës para fillimit të shekullit (Gjonca, Aassve, & Mencarini, 2008).

Rënia e dytë e theksuar midis viteve 2011 dhe 2023 sugjeron se emigracioni është rritur përsëri në dekadën përpara Censit 2023. Trend-i në rënie i numrit të fëmijëve që nga viti 1989 tregon më qartë efektin e kombinuar të uljes së fertilitetit dhe emigracionit në grupmoshën riprodhuese. Emigracioni i përforcuar dhe fertiliteti i ulur janë faktorët kryesorë përgjegjës për rënien e popullsisë nga 2,8 milionë në Censin 2011 në 2,4 milionë në Censin 2023.

Zhvillimi i popullsisë në moshë të re nënkupton që numri i rinisë në Censin 2023 ishte vetëm 58,1 përqind i numrit të raportuar në Censin 2001. Këto përqindje ishin edhe më të vogla për numrin e të rinjve dhe fëmijëve: përkatësisht 54,3 dhe 42,3 përqind. Informacioni në dispozicion mbi numrin e fëmijëve dhe NjEF-ve në censet përkatëse nga 2001 deri në 2023 tregon gjithashtu se mesatarja e fëmijëve për NjEF është zvogëluar ndjeshëm. Ndërsa Censi 2001 raportoi mesatarisht 1,5 fëmijë për NjEF, në Censin 2011 ky numër u ul në 1,0 fëmijë për NjEF dhe në 0,6 fëmijë për NjEF në Censin 2023.

Figura 2.4: Popullsia në moshë të re sipas censeve

a. Në mijë





Figura 2.4: Popullsia në moshë të re sipas censeve

b. Në %



Tendencat në numrat absolutë të popullsisë në moshë të re pasqyrohen edhe në tendencat e përqindjes së tyre në popullsinë gjithsej (Figura 2.4b). Në përgjithësi, pothuajse gjatë gjithë periudhës së vëzhgimit vërehet një rënie e vazhdueshme për të tre grupet e popullsisë në moshë të re, me uljen më të theksuar të përqindjes së fëmijëve në popullatë. Përrjashtim bën stabilizimi – dhe madje një rritje e lehtë – i përqindjes së rinisë dhe të të rinjve në dekadën ndërmjet censeve të viteve 2001 dhe 2011. Kjo ndërprerje e trendit të përgjithshëm ndodh sepse brezat e lindur që u rritën dhe u bënë pjesë e rinisë dhe grupit të të rinjve - shihni rritjen e grupmoshës 5-19 vjeç në piramidën e popullsisë të vitit 2001 (Figura 2.2b) - ishin më të mëdhenj në numër krahasuar me brezat që dolën nga këto grupe, dhe emigracioni nga këto grupe nuk arriti të kompensojë plotësisht zëvendësimin nga brezat më të mëdhenj⁸. Në kombinim me zvogëlimin e shprehur të numrit të fëmijëve, rezultati ishte që përqindja e të rinjve dhe rinisë në totalin e popullsisë u stabilizua midis viteve 2001 dhe 2011 (Figura 2.4b), edhe pse numri i tyre absolut u ul (Figura 2.4a). Sex ratios in young populations


2.2.2 Raportet gjinore tek popullsia në moshë të re

Censi 2023 raportoi një raport gjinor prej 103,3 meshkuj për 100 femra në popullsinë në moshë të re (0-29 vjeç), një shifër që mund të pritet në kushte standarde pa dallime të mëdha gjinore në mortalitet, migracion, abort dhe nënraportim. Një raport gjinor biologjikisht normal në lindje varion nga 102 deri në 106 djem për 100 vajza (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2011) dhe pa faktorë të fortë specifikë gjinorë, ky nivel ruhet kryesisht deri në moshat adulte. Megjithatë, raportet gjinore sipas moshës brenda popullsisë në moshë të re në Shqipëri kanë ndryshime të ndjeshme. Për nën-grupe të veçanta, raportet gjinore të raportuara janë: 107,7 për fëmijët (mosha 0-17), 97,7 për të rinjtë (mosha 15-24) dhe 99,3 për rininë (mosha 15-29). Raporti gjinor prej 107,7 për fëmijët është relativisht i lartë në krahasim ndërkombëtar. Informacioni më i fundit mbi raportin gjinor në lindje nga statistikat vitale në Shqipëri është 107,4 djem për 100 vajza, që përputhet me shifrën e raportuar për të gjithë popullsinë e fëmijëve në Censin 2023. Në BE, raporti gjinor i popullsisë nën 15 vjeç në vitin 2023 ishte 105,4 djem për 100 vajza (Eurostat, 2025). Studimet e mëparshme kanë vënë në dukje se raporti i lartë gjinor në lindje në Shqipëri lidhet me preferencën për djemtë dhe përzgjedhjen gjinore prenatale (World Vision dhe UNFPA, 2012; INSTAT, 2014).

⁸ Shiko Figurën 2.2b (censusi 2001): grupmoshat relativisht të mëdha 5-9, 10-14 dhe 15-19 do të jenë pjesërisht ose plotësisht zhvendosur në grupmoshat e popullsisë së rinisë dhe të të rinjve në piramidat e popullsisë për periudhën midis regjistrimeve të viteve 2001 dhe 2011.

Dallimi midis raportit gjinor të fëmijëve (107,7) nga njëra anë dhe atyre të të rinjve (97,7) dhe rinisë (99,3) nga ana tjetër është i dukshëm. Siç tregohet në Figurën 2.5, kjo shkaktohet nga rënia e theksuar e raportit gjinor në moshat 15 deri në 29 vjeç (linja e gjelbër e errët në Figurën 2.5). Grafiku tregon gjithashtu raportet gjinore të popullsisë të regjistruar në censet e viteve 2001 dhe 2011, të cilët do të kishin arritur grupmoshën 15-29 në vitin 2023, duke supozuar mungesë mortaliteti dhe emigracioni, duke zhvendosur shifrat përkatësisht për 22 dhe 12 vjet. Duke qenë se mortaliteti në moshat 15 deri në 29 është shumë i ulët, diferenca midis shifrave të zhvendosura të viteve 2001 dhe 2011 dhe shifrave të vitit 2023 shpjegohet pothuajse ekskluzivisht nga migracioni specifik gjinor. Më konkretisht, kjo nënkupton se emigracioni neto i rinisë meshkuj ishte më i lartë sesa ai i rinisë femra.

Figura 2.5 Raporti gjinor i popullsisë në moshën 0-29 vjeç, sipas çdo viti të veçantë të moshës (2023) dhe raporti gjinor i zhvendosur i popullsisë të viteve 2001 dhe 2011 në moshën 0-29 vjeç, sipas çdo viti të veçantë të moshës (në %)



2.2.3 Popullsia në moshë të re në nivel nënkombëtar

Popullsia në moshë të re në nivel qarku

Për shkak të strukturave të ndryshme moshore, shpërndarja e popullsisë në moshë të re në moshën 0-29 vjeç në 12 qarqet e Shqipërisë ndryshon nga shpërndarja e popullsisë gjithsej. Megjithatë, Tirana vazhdon të dallojë si qarku me popullsinë në moshë të re më të madhe me shumë diferencë. Me 285,000 persona nën moshën 30 vjeç, ajo përbën 35,4 përqind të popullsinë në moshë të re gjithsej. Nga ana tjetër, Gjirokastra, për shkak të kombinimit të popullsisë më të vogël dhe strukturës më të vjetër moshore nga të gjitha qarqet, ka vetëm 14.000 persona të rinj, që përbëjnë vetëm 1,7 përqind të popullsinë në moshë të re kombëtare. Tabela 2.3 tregon për çdo qark numrin e përgjithshëm të popullsinë në moshë të re, përqindjen e tyre në popullsinë në moshë të re kombëtare, si dhe numrat e tre nën-popullsisë (fëmijë, të rinj dhe rini).

Tabela 2.3 Popullsia në moshë të re sipas qarkut dhe gjinisë (në mijëra); përqindja e popullsinë në moshë të re gjithsej sipas qarqeve dhe gjinive (në %)


Qarku	Popullsia në moshë të re (0-29)			Përqindja e popullsisë në moshë të re		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjithsej	804.3	408.7	395.6	100.0	100.0	100.0
Berat	41.5	20.9	20.6	5.2	5.1	5.2
Dibër	39.7	20.6	19.0	4.9	5.0	4.8
Durrës	80.4	41.3	39.1	10.0	10.1	9.9
Elbasan	75.4	39.2	36.2	9.4	9.6	9.2
Fier	67.1	35.5	31.6	8.3	8.7	8.0
Gjirokastrë	14.0	7.5	6.5	1.7	1.8	1.6
Korçë	50.5	26.8	23.7	6.3	6.5	6.0
Kukës	25.5	13.4	12.2	3.2	3.3	3.1
Lezhë	33.6	17.5	16.1	4.2	4.3	4.1
Shkodër	51.2	26.1	25.1	6.4	6.4	6.4
Tiranë	285.0	139.0	146.0	35.4	34.0	36.9
Vlorë	40.5	21.0	19.4	5.0	5.1	4.9

Qarku	Fëmijë (0-17)			Të rinj (15-24)			Rinia (15-29)		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjithsej	458.0	237.5	220.5	286.1	141.4	144.8	430.3	214.4	215.9
Berat	23.0	11.9	11.2	15.8	7.7	8.1	23.2	11.4	11.8
Dibër	22.8	11.9	10.9	14.2	7.1	7.1	21.0	10.8	10.1
Durrës	46.2	24.1	22.0	27.9	14.1	13.8	42.4	21.4	20.9
Elbasan	44.1	22.5	21.5	26.7	13.6	13.0	39.8	20.8	19.0
Fier	42.3	22.2	20.1	21.9	11.6	10.3	33.0	17.6	15.4
Gjirokastrë	8.7	4.5	4.2	4.7	2.6	2.1	7.1	3.9	3.1
Korçë	29.6	15.2	14.4	17.8	9.6	8.2	26.8	14.6	12.2
Kukës	15.8	8.4	7.4	8.8	4.5	4.4	12.5	6.5	6.1
Lezhë	19.9	10.4	9.5	11.5	5.9	5.6	17.3	9.0	8.3
Shkodër	29.2	15.1	14.1	18.6	9.2	9.4	27.6	13.9	13.8
Tiranë	152.8	79.0	73.7	103.9	48.1	55.8	158.3	73.3	85.0
Vlorë	23.8	12.2	11.6	14.2	7.4	6.9	21.3	11.2	10.2


Censi 2023 raportoi rënie të popullsisë në të gjitha qarqet, përveç Tiranës, e cila shënoi një rritje gjithsej prej 1,2 përqind krahasuar me Censin 2011. Të gjitha qarqet, përfshirë edhe Tiranën, raportuan ulje të numrit në grupmoshën e popullsinë në moshë të re (0-29 vjeç). Në numra absolutë, qarqet me popullsinë më të madhe – Tirana, Fieri dhe Elbasani – shënuan rëniet më të mëdha në popullsinë në moshë të re, secila me një humbje prej 65 mijë personash ose më shumë (Figura 2.6a). Nga ana tjetër, qarqet me popullsi të vogël, si Gjirokastra dhe Dibra, humbën gjithashtu më pak persona të rinj. Një pamje shumë më e ndryshme del nëse shikohet ndryshimi relativ i popullsisë në moshë të re sipas qarqeve (Figura 2.6b). Krahasuar me popullsinë gjithsej të vitit 2011, reduktimi më i vogël është vërejtur në bosh-tin Durrës-Tiranë. Në krahasim me qarqet e tjera, përqindja e uljes në Tiranë (19,1 përqind) është veçanërisht e vogël dhe afërsisht gjysma e shifrës kombëtare (37,3 përqind). Për më tepër, Berati pësoi një rënie të vogël të popullsisë në moshë të re jo vetëm në terma absolutë, por edhe në krahasim me popullsinë e tij të re në vitin 2011 (30,5 përqind).

Figura 2.6: Ndryshimi i popullsisë në moshë të re në moshën 0-29 vjeç midis Censeve 2011 dhe 2023

a. Në vlerë absolute (mijë)



b. Në %




Raporti i varësisë së moshës së re është një tregues tjetër i rëndësisë së pjesës së re të popullsisë, pasi shpreh numrin e personave nën moshën 15 vjeç si përqindje e popullsisë në grupmoshën 15-64 vjeç. Figura 2.7 tregon raportin e varësisë së moshës së re sipas qarqeve për censet e viteve 2023 dhe 2011. Sipas Censit 2023, ky raport varësie varion nga 31,8 në Kukës deri në 19,0 në Gjirokastrë. Vlera e lartë në qarkun Kukës është një përjashtim në spektrin e raportit të varësisë dhe lidhet me fertilitetin relativisht të lartë në këtë qark. Së bashku me Dibërën, Kukësi ka tradicionalisht fertilitetin më të lartë në Shqipëri. Për shembull, në vitin 2019 këto ishin dy qarqet e vetme me një normë të fertilitetit⁹ rreth nivelit të zëvendësimit prej 2,1 fëmijë për grua, krahasuar me nivelin kombëtar prej 1,37 fëmijë për grua (INSTAT, 2019).

Vlerat e raportit të varësisë së moshës së re në vitin 2023 janë vazhdimisht më të ulëta se ato të vitit 2011. Mesatarisht, raporti u ul me 6,3 pikë përqindjeje ose 20,9 përqind krahasuar me Censin 2011. Ulja në Tiranë është dukshëm më e vogël, si në terma absolutë (3,8 pikë përqindjeje) ashtu edhe në mënyrë relative (13,3 përqind).


⁹ Numri total i fëmijëve që do të lindte çdo grua nëse do të jetonte deri në fund të viteve të saj të lindjes dhe do të lindte fëmijë në përputhje me normat aktuale të fertilitetit sipas moshës.

Figura 2.7: Raporti i varësisë së moshës së re, sipas qarqeve dhe viteve të censit (në %)



Raporti gjinor i popullsisë në moshë të re në moshën 0-29 vjeç ndryshon ndjeshëm midis 12 qarqeve. Të gjitha qarqet, përveç Tiranës, kanë një shumicë të popullsisë në moshë të re meshkuj, me raporte gjinore që variojnë nga 101,4 meshkuj për 100 femra në Berat deri mbi 110 meshkuj për 100 femra në Kukës, Fier, Korçë dhe Gjirokastrë (Figura 2.8). Tirana zë një pozicion të veçantë me një shumicë të femrave në popullsinë në moshë të re dhe një raport të ulët gjinor prej 95,2 meshkuj për 100 femra. Raportet gjinore të përgjithshme të popullsisë në moshë të re ndikohen veçanërisht nga raportet gjinore të grupmoshës së rinisë (15-29 vjeç), të cilat tregojnë një variacion shumë të madh. Në nivel të lartë, Korça dhe Gjirokastra kanë raporte gjinore prej 120 ose më shumë të meshkujve për 100 femra në grupin e rinisë, ndërsa Tirana ka vetëm 86 meshkuj për 100 femra në të njëjtën grupmoshë. Ndonëse emigracioni mund të luajë një rol, është shumë e mundshme që migracioni të jetë një faktor i rëndësishëm në shpjegimin e raportit të ulët gjinor në Tiranë. Duke marrë parasysh përqendrimin e arsimit të lartë në kryeqytet dhe shkallën më të lartë të pjesëmarrjes së femrave në arsimin terciar (shih seksionin 4.2.2), mund të supozohet se shumë vajza të reja nga e gjithë Shqipëria zhvendosen në Tiranë për arsimin e tyre të mëtejshëm dhe punësimin e parë në tregun e punës.

Figura 2.8: Raporti gjinor i popullsisë në moshë të re dhe rinisë, sipas qarqeve (në %)



Popullsia në moshë të re në nivel bashkie

Madhësia e popullsisë në moshë të re ndryshon shumë në 61 bashkitë e Shqipërisë. Bashkia e Tiranës ka popullsinë më të madhe të re me 224,3 mijë persona nën moshën 30 vjeç, duke përbërë 27,9 përqind të totalit. Më pas vijnë Durrësi (52,9 mijë), Kamza (39,8 mijë), Elbasani (38,9 mijë) dhe Shkodra (34,4 mijë) me një distancë më të madhe. Nga ana tjetër, 14 bashki kanë një popullsi të re më pak se 2 mijë persona, prej të cilave gjashtë ndodhen në qarkun e Gjirokastrës. Në Shtojcën III janë të dhënat për numrin e popullsisë në moshë të re dhe nënpopullsive të saj për çdo bashki, të ndara sipas gjinisë.

Figura 2.9 tregon numrin e fëmijëve në moshën 0-17 si përqindje të popullsisë gjithsej në bashki. Përqindja e fëmijëve në popullsinë bashkiake shfaq një gamë të gjerë, nga 4,6 përqind në Finiq deri në 27,1 përqind në Has, që është më shumë se pesë herë më shumë. Përqindja e të rinjve në moshën 15-24 vjeç gjithashtu ndryshon shumë midis bashkive, por më pak se ajo e fëmijëve (Figura 2.10). Finiqi dhe Dropulli janë bashkitë me përqindjen më të vogël të të rinjve (4,7 përqind), krahasuar me Dimalin me 17,4 përqind, trefish më shumë. Raporti i varësisë së moshës së re, si dhe përqindjet e rinisë 15-29 dhe të popullsisë gjithsej të re 0-29 për çdo bashki janë dhënë në Shtojcën III.

Variacioni i raporteve gjinore midis qarqeve riprodhohet edhe në nivelin e bashkive, por është shumë më i theksuar. Diferencat midis bashkive janë veçanërisht të dukshme për popullsinë e të rinjve dhe rinisë. Në më shumë se gjysmën e bashkive, këto popullsi kanë më shumë se 10 përqind meshkuj më shumë se femrat (raportet gjinore mbi 110). Rreth një e treta e 61 bashkive raportuan një raport gjinor të rinisë mbi 120, deri në maksimumin 153,3 meshkuj për 100 femra. Për raportin gjinor të të rinjve, kjo përqindje është rreth një e gjashta. Ky mbi-zotërim i madh i meshkujve të rinj kompensohet vetëm në disa bashki me shumicë femrash. Rreth 18 bashki kanë më shumë të rinj femra (15-24 vjeç) dhe vetëm 14 bashki kanë më shumë rini femra (15-29 vjeç), me Tiranën, Dimalin dhe Hasin që kanë përfaqësimin më të lartë të femrave me raporte gjinore nën 85 meshkuj për 100 femra. Raporti gjinor gjithsej i popullsisë të re 0-29 varion nga 88,9 deri në 153,7 meshkuj për 100 femra. Në Shtojcën III gjendet një tabelë me raportet gjinore të popullsive të ndryshme të reja në çdo bashki.

Figura 2.9: Fëmijët në moshën 0-17 vjeç si përqindje e popullsisë gjithsej, sipas bashkive





Figura 2.10: Të rinjtë në moshën 15-24 vjeç si përqindje e popullsisë gjithsej, sipas bashkive



3. Martesa dhe struktura e NjEF-së

Fëmijëria dhe rinia përbëjnë etapa themelore të jetës që kanë ndikime të thella për tërë rrjedhën e jetës së individit. Gjatë këtyre etapave, fëmijët rriten duke hyrë në fazën e rinisë, moshë kur duhet të merren vendime mbi krijimin e familjes e cila ndikon në mënyrë të konsiderueshme në trajektoren e jetës. Kuptueshmëria e këtyre modeleve demografike është thelbësor për hartimin e politikave efektive në shëndetësi, arsim dhe mbrojtje sociale.

Koha dhe konteksti i vendimeve për martesën ndikohen nga një gamë faktorësh, duke përfshirë normat kulturore, rolet gjinore, statusin socio-ekonomik, si dhe qasjen në arsim. Hulumtimet kanë treguar se investimi në shëndetin, arsimin dhe fuqizimin e të rinjve – veçanërisht vajzave – mund të vonojë moshën e martesës, dhe të nxisë dinamika më të barabarta në familje (Bongaarts, Mensch, & Blanc, 2017).

3.1 Martesa

Përgjatë viteve, përqindja e popullsisë që nuk ka qenë asnjëherë e martuar është zvogëluar ndjeshëm (Figura 3.1). Ndërsa në vitin 1989, 53,5 përqind e popullsisë nuk ishte martuar asnjëherë, në vitin 2023 kjo përqindje ra në vetëm 36,6 përqind të të gjithë personave. Përqindja e individëve të pamartuar ishte më e lartë te meshkujt sesa te femrat. Në censin e vitit 2023, tek të gjitha grupmoshat, 41,2 përqind e meshkujve nuk ishin martuar asnjëherë, krahasuar me 32,2 përqind të femrave. Shumë nga këto ndryshime lidhen me ndryshimet në përbërjen e moshës të rinisë dhe të të rinjve dhe nuk lidhen domosdoshmërisht me ndryshime në dinamikën e martesës në vend. Në të njëjtën periudhë, përqindja e personave që janë aktualisht të martuar është rritur ndjeshëm. Në vitin 1987, 42,8 përqind e popullsisë ishte e martuar, ndërsa në vitin 2023 kjo shifër ishte më e lartë me mbi 10 pikë përqindjeje (54,9 përqind). Në këtë seksion do të shqyrtohen modellet e martesës tek të rinjtë (15-24 vjeç) dhe rinia (15-29 vjeç).

Figura 3.1 ofron një pasqyrë të përgjithshme të modelit të martesës sipas moshës dhe gjinisë tek popullsia në moshë të re në Shqipëri. Tabela për të gjithë popullatën paraqitet në Shtojcën IV. Grafiku tregon qartë se martesa nuk është shumë e zakonshme tek të rinjtë në Shqipëri. Në moshën 20 vjeç, vetëm 5,4 përqind e të rinjve janë të martuar; në moshën 25 vjeç, rreth tre të katërtat e të rinjve janë ende beqarë. Fakti që të rinjtë shtyjnë martesën duket qartë, pasi më shumë se gjysma e personave në moshën 30 vjeç nuk janë martuar ende. Grafiku tregon gjithashtu ndryshimin e qartë në modellet e martesës midis meshkujve dhe femrave. Në moshën 20 vjeç, 9,3 përqind e femrave janë tashmë të martuara, ndërsa për meshkujt kjo është vetëm 1,0 përqind. Afërsisht 40 përqind e femrave janë të martuara deri në moshën 25 vjeç, ndërsa më pak se 10 përqind e meshkujve janë të martuar deri atë moshë.

3.1.1 Moshë në martesën e parë

Për këtë raport, është përdorur vetëm informacioni nga censi për të llogaritur moshën mesatare në martesën e parë për popullsinë gjithsej. Që në vitin 1953, Hajnal zhvilloi një teknikë demografike për të llogaritur moshën mesatare të martesës së parë¹⁰, e njohur si moshë mesatare në të cilën personat martohen për herë të parë (Singulate Mean Age at Marriage - SMAM). Ky tregues llogaritet si gjatësia mesatare e jetës pa martesë për ata që më pas martohen para moshës 50 vjeç, dhe rrjedh nga përqindjet e individëve të pamartuar ndonjëherë në vite (singular) të veçanta të moshës ose në grup moshë pesëvjeçare të marra nga një cens ose anketë (Hajnal, 1953).

¹⁰ Moshë mesatare e martesës tregon gjatësinë mesatare të jetës beqare, e shprehur në vite, midis atyre femrave që martohen para moshës 50 vjeç.

Figura 3.1: Përqindja e popullsisë gjithsej që nuk është martuar asnjëherë, sipas viteve të censit dhe gjinisë





Figura 3.2: Përqindja e popullsisë në moshë të re, të martuar dhe të pamartuar, sipas moshës dhe gjinisë



Për çdo cens që nga viti 1989, SMAM është llogaritur për meshkujt, femrat dhe të dy gjinitë (INSTAT, 2014)

Mosha mesatare kur individët martohen për herë të parë (SMAM)

Formula për të llogaritur SMAM është:

$$SMAM = a + \frac{\sum_{x=a}^b P_x}{1 - P_b}$$

Ku:


- a = kufiri i poshtëm i grupmoshës (mosha 15)
- b = kufiri i sipërm i grupmoshës (mosha 50)
- P_x = përqindja e personave që nuk janë martuar në moshën x
- P_b = përqindja e personave që nuk janë martuar asnjëherë në kufirin më të lartë të moshës (shpesh supozohet se janë ata që nuk do të martohen asnjëherë)

$$\sum_{x=a}^b P_x$$

- Shuma përfaqëson sipërfaqen nën kurbën e përqindjeve të personave që nuk janë martuar.

Figura 3.3 tregon qartë se SMAM-i është rritur ndjeshëm. Ndërsa mosha në martesën e parë qëndroi relativisht e pandryshuar midis viteve 1989 dhe 2002, ajo është rritur me shpejtësi që prej asaj kohe. Për të dy gjinitë, SMAM-i u rrit nga 25 vjeç në vitin 1989 në 32 vjeç në vitin 2023, që përfaqëson një rritje prej 7 vjetësh. Mosha në martesën e parë është rritur shumë më shpejt për meshkujt sesa për femrat: nga 27 në 36 vjeç për meshkujt, krahasuar me një rritje nga 23 në 29 vjeç për femrat.

Figura 3.3: Mosha mesatare e martesës së parë (SMAM), sipas viteve të censit dhe gjinisë




Mosha mesatare në martesën e parë është mosha në të cilën 50 përqind e individëve në një popullsi janë martuar për herë të parë. Ajo u vlerësua duke përdorur interpolim linear për të përcaktuar se midis cilave dy moshave bie ky prag 50 përqind. Mosha mesatare në martesën e parë është llogaritur vetëm në Censin 2011 për meshkujt dhe femrat, por jo për popullsinë gjithsej. Në censet e mëparshme, kjo nuk është vlerësuar. Sipas Censit 2023, mosha mesatare në martesën

e parë ishte 29,4 vjeç për popullsinë gjithsej, 32,4 vjeç për meshkujt dhe 26,3 vjeç për femrat. Në vitin 2011, kjo moshë ishte 28 vjeç për meshkujt dhe 22 vjeç për femrat. Këto të dhëna konfirmojnë se moshja në martesën e parë është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Bazuar në censin e popullsisë, nuk është e mundur të përcaktohet saktësisht se çfarë ka shkaktuar këtë rritje. Ndoshta gjatë pandemisë COVID-19, njerëzit e shtynë martesën, ose ndoshta emigrimi në shkallë të gjerë ka ndikuar në momentin kur çiftet e reja kanë vendosur të martohen.

3.1.2 Indeksi i barazisë gjinore për martesën

Indeksi i barazisë gjinore (GPI) krahason një tregues të caktuar për femrat me të njëjtin tregues për meshkujt. Kur aplikohet për përqindjen e personave ndonjëherë të martuar, ai tregon nëse meshkujt dhe femrat martohen me të njëjtin ritëm në një moshë apo grupmoshë të caktuar. GPI-ja llogaritet për çdo moshë nga 15 deri në 29 vjeç si raporti i përqindjes së femrave ndonjëherë të martuara ndaj përqindjes së meshkujve ndonjëherë të martuar, i shprehur në përqindje. GPI-të sipas moshës paraqiten në Figurën 3.4. Për çdo moshë të vetme midis 15 dhe 29 vjeç, përqindja e vajzave ndonjëherë të martuara është të paktën dy herë më e lartë se ajo e bashkëmoshatarëve meshkuj. Midis moshave 18 dhe 22 vjeç, GPI-ja është jashtëzakonisht e lartë, me vlera më të larta se 700. Kjo do të thotë se në secilën nga këto moshë, përqindja e femrave që janë ndonjëherë të martuara është të paktën shtatë herë më e lartë se përqindja e meshkujve. Në moshën 29 vjeç, GPI-ja është më e ulët, por përqindja e femrave të martuara mbetet më shumë se dyfishi i asaj të meshkujve.

Figura 3.4: Indeksi i barazisë gjinore për përqindjen e të martuarve në popullsinë në moshë të re, sipas moshës



3.1.3 Krahasimi ndërkombëtar

Shqipëria nuk është e vetme në Evropë për sa i përket rritjes së shpejtë të moshës së martesës. Që nga viti 2000, shoqëritë evropiane kanë përjetuar një rritje të qëndrueshme dhe të përhapur të moshës në të cilën njerëzit martohen për herë të parë. Në shumicën e vendeve evropiane, moshja mesatare në martesën e parë ka arritur ose tejkaluar 30 vjeç për gratë dhe shpesh është nga 32 deri në 34 vjeç për burrat. Moshja e martesës së parë mbetet disi më e ulët në vendet e Ballkanit krahasuar me ato të Evropës Perëndimore dhe Veriore (Eurostat, 2025). Figura 3.5a dhe b paraqesin moshën në martesën e parë për burra dhe gra në Shqipëri dhe një sërë vendesh përreth. Janë përzgjedhur vetëm ato vende për të cilat ishin të disponueshme të dhëna për vitin 2023 në bazën e të dhënave statistikore të Eurostat-it, pasi ndryshimet ndodhin relativisht shpejt (Eurostat, 2023). Duhet theksuar se moshja mesatare e martesës në bazën e të dhënave të Eurostat-it bazohet në të dhëna administrative, ndërsa moshja mesatare për Shqipërinë bazohet në SMAM të llogaritur. Është e mundur që të ekzistojnë dallime të vogla midis këtyre dy metodave.

Figura 3.5: Mosha mesatare në martesën e parë për burra dhe gra, në vende të përzgjedhura evropiane^a

a| Burimi për shtete të tjera nga Shqipëria: Eurostat (Eurostat, 2025)

Figura 3.5 tregon situatën e veçantë të modeleve të martesës në Shqipëri, krahasuar me vende të përzgjedhura evropiane. Ndër të gjitha vendet e përfshira, meshkujt shqiptarë, mesatarisht, martohen në një nga moshat më të vona, pak më poshtë se Italia (36,5 vjeç). Në të gjithë Evropën, meshkujt suedezë martohen në moshën më të madhe, në 37,0 vjeç. Nga ana tjetër, gratë shqiptare martohen ndër më të rejat. Ndër të gjitha vendet e Evropës, gratë moldave martohen në moshën më të re, me një mesatare prej 25,1 vjeç (Eurostat, 2023). Nuk është e qartë se çfarë e shkakton këtë model të veçantë; ndoshta fakti që shumë djem të rinj shqiptarë kalojnë disa vite jashtë vendit mund të kontribuojë në këtë prije.

3.1.4 Martesa e fëmijëve

Martesa e fëmijëve dëmton përparimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 për barazinë gjinore dhe OZHQ 3 për shëndetin dhe mirëqenien. Ndërprerja e martesave të fëmijëve është pjesë e Objektivit 5.3: Zhdukja e praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e hershme të fëmijëve dhe ato me detyrim, dhe gjymtimi gjenital i femrave. Indikator standard për matjen e përhapjes së martesave të fëmijëve është përqindja e grave të moshës 20-24 vjeç që janë martuar për herë të parë ose janë në bashkëjetesë para moshës 18 vjeç, dhe përqindja e grave të moshës 20-24 që ishin martuar ose në bashkëjetesë para moshës 15 vjeç.

Në Shqipëri, mosha minimale ligjore për martesë është 18 vjeç për burrat dhe gratë, sipas Nenit 7 të Kodit Familjar (Ligji Nr. 9062, datë 8 maj 2003). Megjithatë, i njëjti nen lejon përjashtime: një gjykatë mund të lejojë martesën para moshës 18 vjeç nëse ekzistojnë “arsye të mjaftueshme”. Ligji nuk përcakton një kufi moshe më të ulët për këto përjashtime. Ekzistojnë dëshmi që martesat e fëmijëve ka qenë një problem social në Shqipëri. Një studim nga UNFPA dhe UNICEF në vitin 2017 tregoi se 16,9 përqind e martesave përfshinin vajza më të reja se 19 vjeç. Për djemtë, përqindja korresponduese ishte 0,5 përqind. Raporti thekson se përhapja reale është më e lartë, pasi këto përqindje nuk përfshijnë martesat e paregjistruara (UNICEF dhe UNFPA, 2018). Në Anketën Demografike dhe Shëndetësore (DHS) 2008-09, 9,4 përqind përqind e grave të moshës 20-49 ishin martuar para moshës 18, ndërsa tek burrat e së njëjtës grupmoshë përqindja ishte 0,8 përqind (INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF Macro, 2010). Në vitin 2017, në DHS-në e rradhës, përqindja e grave që ishin martuar para moshës 18 u rrit në 11,4 përqind, ndërsa për burrat u rrit në 1,5 përqind (INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF, 2018). DHS 2017-18 gjithashtu zbuloi se martesat e hershme ishin dukshëm më të larta tek kuintili i popullsisë me mirëqenie më të ulët: 14,5 përqind e grave 15-49 vjeç nga ky kuintil ishin martuar para moshës 18, krahasuar me 7,2 përqind në kuintilin me mirëqenien më të lartë.

Në Censin e vitit 2023 nuk u përfshinë pyetje për moshën në martesën e parë, si rrjedhojë nuk mund të llogaritet indikator i OZHQ mbi këtë cens. Një tregues i lidhur për martesën e fëmijëve, është përqindja e të rinjve 15-17 vjeç që janë të martuar. Në total, 0,8% e grupmoshës nën 18 vjeç janë të martuar (1,3% vajza dhe 0,3% djem).

3.1.5 Zgjidhja e martesës

Zgjidhja e martesës mund të ndodhë për shkak të ndarjes, divorcit ose humbjes së bashkëshortit/bashkëshortes (vjehtësisë). Dallimi kryesor midis divorcit dhe ndarjes është se divorci është shpërbërja ligjore e martesës, zakonisht e iniciuar nga një gjykatë ose autoritet kompetent, ndërsa ndarja ndodh kur çifti vendos të jetojnë të ndarë, por mbeten ligjërisht të martuar.

Duke marrë parasysh moshën e vonë të martesës në Shqipëri, është e qartë që numri i divorcëve, ndarjeve dhe të vëhëve mes popullsisë së rinisë është relativisht i vogël. Në total, nga 430 mijë rini, në moshën 15-29 vjeç, 69 mijë janë aktualisht të martuar, por vetëm 1,8 mijë janë të divorcuara ose të ndarë, dhe 875 janë të ve. Kjo do të thotë se 16,1 përqind janë të martuar, ndërsa vetëm 0,4 përqind janë të divorcuara ose të ndarë, dhe 0,2 përqind janë të ve. Një pjesë më e madhe e grave sesa burrave janë të martuara (24,8 kundrejt 7,4 përqind) ose të divorcuara (0,7 kundrejt 0,2 përqind). Edhe më pak rini janë të ve (875). Pak më shumë gra të reja sesa burra në moshën 15-29 vjeç janë të ve, përkatësisht 480 gra kundrejt 395 burrave.

3.2 Struktura e NjEF-së

3.2.1 Lidhja me personin e references në NjEF

Në censin e popullsisë, personi referencë është përcaktuar si ‘anëtar i NjEF-së që zakonisht merr vendimet kryesore brenda NjEF-së dhe që njihet si i tillë nga të gjithë anëtarët e tjerë

të NjEF-së' (INSTAT, 2024). Tabela 3.1 tregon përqindjen e fëmijëve, të rinjve dhe rinisë sipas gjinisë dhe marrëdhënien e tyre me personin e referencës në NjEF. Siç pritej, personat referencë në NjEF janë zakonisht individët më të moshuar dhe rrallë gjenden në grupmoshat më të reja të popullsisë. Në grupmoshën 15-24 vjeç, 5,2 përqind e të gjithë individëve janë identifikuar si personi i referencës në NjEF-në e tyre. Është interesante që një përqindje më e lartë e grave (5,7 përqind) sesa burrave (4,7 përqind) janë persona reference në këtë grupmoshë. Në këtë grupmoshë, 55,0 përqind e të gjithë personave referencë janë gra. Ndërsa në grupmoshën 15-29 vjeç, përqindja e burrave (8,6 përqind) është më e lartë se ajo e grave, dhe përqindja e grave si persona referencë u ul në 45,8 përqind. Megjithatë, duhet pasur parasysh se në cens, numri i personave referencë nën moshën 20 vjeç ishte më pak se një mijë.

Tabela 3.1: Fëmijë, të rinj dhe rinia, sipas lidhjes me personin e referencës të NjEF dhe sipas gjinisë (në %)


Lidhja me personin e referencës	Fëmijë 0-17			Të rinjtë 15-24			Rinia 15-29		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Personi i referencës	0.2	0.1	0.2	5.2	4.7	5.7	7.9	8.6	7.2
Bashkëshort ose bashkëshorte	0.0	0.0	0.0	1.6	0.1	3.1	5.0	0.3	9.7
Partner/e në bashkjetesë	0.0	0.0	0.0	0.6	0.1	1.1	1.1	0.3	2.0
Djalë/vajzë	72.2	72.5	72.0	73.3	80.3	66.3	66.3	78.1	54.5
Nip/mbesë (fëmija e djalit/vajzës)	23.7	23.6	23.8	7.8	8.3	7.3	5.8	6.3	5.2
Babai/nëna	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.2	0.1	0.0	0.2
Vëlla/motër	0.4	0.4	0.4	2.2	2.0	2.5	2.2	2.0	2.3
Nipi/mbesa (fëmija i vëllait/motrës)	0.7	0.7	0.7	0.3	0.4	0.3	0.3	0.3	0.2
Kunat/kunatë	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.2	0.2	0.1	0.3
Gjysh/gjyshe	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Dhëndër/nuse	0.1	0.0	0.1	3.6	0.0	7.1	6.4	0.1	12.7
Vjehërr	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Xhaxhi/halla/daja/tezja	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I afërm tjetër	0.2	0.2	0.2	0.4	0.2	0.5	0.3	0.2	0.5
Pa lidhje gjaku	2.4	2.4	2.4	4.7	3.8	5.7	4.5	3.6	5.3

Situata familjare e grave të reja duket qartë në përqindjen e personave që kanë deklaruar “djali ose vajza” si marrëdhënie me personin e referencës të NjEF-s. Tek fëmijët, 72,2 përqind deklarojnë se janë djali ose vajza e personit të referencës, ndërsa 23,7 përqind thonë se janë nipi ose mbesa e personit të referencës. Ndërsa përqindja e djemve/vajzave është thuajse e njëjtë midis djemve dhe vajzave në grupmoshën e fëmijëve (72,5 përqind kundrejt 72,0 përqind), ajo ulet tek femrat në grupmoshën 15-29 vjeç, në 54,5 përqind. Ndërsa te burrat përqindja rritet në 78,1 përqind për individët e rinj. Kjo rritje mund të shpjegohet me faktin që përqindja e kategorisë nip/mbesë bie nga 23,6 përqind në 6,3 përqind, për shkak të vdekjes së gjyshërve më të moshuarve në NjEF. Po ashtu, fakti që 12,7 përqind e rinisë femërore deklarojnë se janë nuse të personit të referencës tregon se shumë gra të reja pas martesës shkojnë dhe jetojnë me prindërit e bashkëshortit.

3.2.2 Madhësia e NjEF-së


Gjatë viteve, madhësia mesatare e NjEF-së në Shqipëri është zvogëluar ndjeshëm (Figura 3.6). Midis viteve 2011 dhe 2023, madhësia mesatare e NjEF-së ra në 3,2 persona për NjEF. Në vitin 1979, madhësia mesatare e NjEF-së ishte ende 5,6 persona.

Figura 3.6: Madhësia mesatare e NjEF-së sipas Censeve



Ka një ndryshim të qartë në madhësinë e NjEF-ve midis atyre që kanë popullsi në moshë të re (0-29 vjeç) dhe atyre që nuk kanë (Figura 3.7). NjEF-të me fëmijë të moshës 0 deri 17 vjeç kanë mesatarisht pothuajse dyfishin e madhësisë krahasuar me NjEF-të pa fëmijë: 4,6 persona në mesatare për NjEF-të me fëmijë, kundrejt 2,4 për NjEF-të pa fëmijë. Gjithashtu, NjEF-të me persona të rinj (15-24 vjeç) dhe në rini (15-29 vjeç) zakonisht janë më të mëdha mesatarisht se ato pa persona të rinj. Ky trend është i kuptueshëm, pasi zakonisht kur personat e rinj largohen nga familja, formohen dy NjEF më të vogla, në krahasim me NjEF-në bazë nga e cila u formuan.

Figura 3.7: Madhësia mesatare e NjEF-së sipas pranisë së fëmijëve, të rinjve dhe rinisë



3.2.3 Mungesa e prindërve


Mungesa e njërës ose të dy prindërve ka një ndikim të thellë në kushtet e jetesës së fëmijëve dhe të të rinjve në Shqipëri. Ndërsa migrimi i prindërve mund të sjellë përfitime financiare, ai shpesh ka pasoja negative emocionale, psikologjike dhe zhvillimore për fëmijët që mbeten në Shqipëri. Një studim i Giannelli dhe Mangiavacchi tregoi ndikimin që ka përjetimi nga fëmija i migrimit të mëparshëm të prindërve në braktisjen e shkollës (Giannelli & Mangiavacchi, 2010). Në seksionet mbi ndjekjen e shkollës (4.3) dhe shkrim-leximin (4.2) të këtij raporti, trajtohet gjithashtu edhe ndikimi i mungesës së prindërve.

Censi mundëson llogaritjen e numrit të fëmijëve që jetojnë pa njërin ose të dy prindërit. Nuk është bërë dallim midis fëmijëve që ishin pa prindër për shkak të migrimit apo për shkak të

shpërbërjes së martesës së prindërve të tyre. Në censin e vitit 2023, 37,7 mijë fëmijë, në grupmoshën 0–17 vjeç, jetonin me nënën, por pa babanë në NjEF¹¹. 8 mijë fëmijë jetonin me babanë, ndërkohë që nëna nuk ishte pjesë e NjEF-së, dhe 1,6 mijë fëmijë jetonin në NjEF ku mungonin të dy prindërit.

Figura 3.8 paraqet një model tipik të mungesës së prindërve sipas moshës. Gjatë dhjetë viteve të para të jetës, përqindja e fëmijëve me baba që mungon rritet gradualisht nga rreth 5 përqind në rreth 10 përqind. Nga moshë 11 deri në 17 vjeç, përqindja e fëmijëve me baba që mungon mbetet e njëjtë, rreth një në 11. Përqindja e fëmijëve me nënën që mungon është pak më shumë se 1 përqind dhe rritet në 2 përqind deri në moshën 13 vjeç. Në moshën 17 vjeç, 5,5 përqind e të gjithë fëmijëve nuk e kanë nënën të pranishme. Kjo përqindje mund të jetë më e lartë se në moshat më të vogla, pasi në këtë moshë disa fëmijë mund të jenë larguar nga shtëpia për të ndjekur shkollën. Më pak se 1 përqind e foshnjave nuk i kanë të dy prindërit në NjEF. Në moshën tre vjeçare, kjo përqindje bëhet 1 përqind dhe rritet në mënyrë të qëndrueshme deri në 2,8 përqind në moshën 15 vjeçare.

Figura 3.8: Përqindja e fëmijëve pa njërin ose të dy prindërit në NjEF, sipas moshës dhe sipas statusit të mungesës së prindërve




3.2.4 Lloji i NjEF-së

Pak më shumë se tre të katërtat e të gjithë fëmijëve jetojnë në NjEF bërthamë, ndërsa 21,5 përqind jetojnë në NjEF të zgjeruara (Figura 3.9a). Një NjEF bërthamë i referohet një njësie familjare të përbërë nga një çift – i martuar ose në bashkëjetesë – me ose pa fëmijët e tyre në ngarkim, të gjithë duke jetuar në të njëjtën banesë. Në kontrast, një “NjEF e zgjeruar” i referohet një NjEF-je që përfshin më shumë se sa NjEF-ja bërthamë. Kjo përfshin të afërm shtesë si gjyshër, xhaxhallarë, teze, hallë, kushërinj apo të afërm të tjerë, të cilët jetojnë së bashku dhe ndajnë një buxhet të përbashkët. Në total, 358 mijë fëmijë në Shqipëri jetojnë në NjEF bërthamë, ndërsa 98 mijë jetojnë në NjEF të zgjeruara. Vlen të theksohet se përqindjet për djemtë dhe vajzat 0–17 vjeç janë pothuajse të njëjta për të dy llojet e NjEF-ve.

¹¹ Të dhënat përfshijnë fëmijët në NjEF private dhe institucione.

Figura 3.9: Fëmijët, të rinjtë dhe rinia, sipas gjinisë dhe llojit të NjEF-së



Një përqindje disi më e lartë e të rinjve sesa e fëmijëve jeton në NjEF bërthamë (Figura 3.9b). Megjithatë, krahasuar me fëmijët, ndryshimi midis gjinive është më i theksuar. Një përqindje shumë më e lartë e meshkujve sesa e femrave jeton në NjEF bërthamë, ndërsa më shumë femra jetojnë në NjEF të zgjeruara. Nëse gratë që jetojnë në një NjEF bërthamë martohen dhe fillojnë të jetojnë me prindërit e bashkëshortit, familja e tyre kalon nga bërthamë në të zgjeruar. Për shkak të diferencës në moshë gjatë martesës midis meshkujve dhe femrave, meshkujt mund të bien jashtë grupmoshës 15–29 vjeç, gjë që mund të shpjegojë pse më pak meshkuj jetojnë në NjEF të zgjeruara krahasuar me femrat. Nevojitet më shumë kërkim për të përcaktuar pse një përqindje më e lartë e vajzave të reja jeton në NjEF të zgjeruara krahasuar me djemtë e rinj. Figura 3.9c paraqet një prirje të ngjashme për rininë e moshës 15–29 vjeç. Në këtë grupmoshë, 16,5 përqind e meshkujve jetojnë në NjEF të zgjeruara, krahasuar me 27,1 përqind të femrave.

4. Shkrim-leximi dhe arsimi

4.1 Hyrje

Shkrim-leximi dhe arsimimi janë të njohura universalisht si shtyllat themelore për zhvillimin personal, përparimin ekonomik dhe kohezionin shoqëror. Kombet e Bashkuara kanë theksuar vazhdimisht rëndësinë kritike të arsimit në agjendat globale të zhvillimit, veçanërisht përmes OZHQ 4, që synon të “sigurojë arsim gjithëpërfshirës, cilësor dhe të barabartë dhe të promovojë mundësitë për të mësuar gjatë gjithë jetës për të gjithë” deri në vitin 2030. Shkrim-leximi dhe arsimimi nuk janë vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por gjithashtu një faktor i fuqishëm për të mundësuar rezultate më të gjera edukative. Pa shkrim-lexim dhe edukim, në kuptimin më të gjerë, individët janë të kufizuar ndjeshëm në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në jetën qytetare dhe për të pasur akses në mundësi punësimi. Për shembull, në Bashkimin Evropian, shkalla e punësimit në vitin 2024 për personat e moshës 20-64 vjeç që kishin përfunduar arsimin e lartë ishte 86.5 përqind, shumë më e lartë se për ata që kishin përfunduar vetëm arsimin fillor ose të mesëm të ulët (58.7 përqind). Një studim i publikuar në The Lancet Public Health ofron dëshmi për lidhjen mes arsimit dhe jetëgjatësisë, duke ilustruar se si arritjet arsimore veprojnë si përcaktues social të shëndetit (Balaj & et al., 2024). Për të rriturit e moshës 18-49 vjeç, u gjet një ulje mesatare prej 2.9 përqind e rrezikut të vdekshmërisë për çdo vit shtesë arsimimi.

4.2 Shkrim-leximi dhe analfabetizmiIntroduction

4.2.1 Hyrje

Në Censin e 2023 në Shqipëri, shkalla e shkrim-leximit bazohet në vetëdeklarimin e aftësisë për të lexuar dhe shkruar një fjali të shkurtër rreth jetës së përditshme. Shkalla e aftësisë për shkrim-lexim sipas moshës përlllogaritet si numri i personave që dinë të lexojnë dhe të shkruajnë në një grupmoshë, si përqindje e popullsisë gjithsej të asaj grupmoshe. Përkundrazi, shkalla e analfabetizmit përlllogaritet në të njëjtën mënyrë: si numri i personave analfabetë në një grupmoshë, në raport me popullsinë gjithsej të atij grupi. Të dyja treguesit pasqyrojnë rezultatet e sistemit të arsimit fillor (dhe çdo programi të shkrim-leximit) në një vend, si dhe potencialin e popullsisë për zhvillim intelektual dhe për kontribut në zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturor të shoqërisë.

Shkalla e shkrim-leximit në Shqipëri është e lartë. Censi i vitit 2023 tregoi një nivel pothuajse universal të aftësive për shkrim-lexim (97.8 përqind) për të gjithë popullsinë 10 vjeç e lart. Vetëm tek grupmoshat më të vjetra, mbi 75 vjeç, shkalla e shkrim-leximit bie nën 95 përqind. Kjo mund të pasqyrojë më pak mundësi arsimimi në të kaluarën, por ndoshta më shumë humbjen e shikimit apo aftësive mendore në moshat e vjetra. Dallimet gjinore janë minimale, përveç përsëri tek grupmoshat më të vjetra. Ndërkohë që popullsia gjithsej nën moshën 70 vjeç nuk tregon dallime në shkrim-lexim, shkalla e shkrim-leximit për gratë 70 vjeç e lart është 6,1 pikë përqindje më e ulët se ajo e bashkëmoshatarëve meshkuj. Meqenëse shkalla e shkrim-leximit tek të rinjtë në Shqipëri është mbi 99 përqind, statistikatat mbi shkrim-leximin kanë pak fuqi dalluese. Për këtë arsye, ky raport fokusohet në diferencimin e analfabetizmit dhe në identifikimin e xhepave të popullsisë me shkallë të lartë analfabetizmi.

4.2.2 Shkrim-leximi dhe analfabetizmi tek popullsia në moshë të re

Tabela 4.1 paraqet statusin e aftësive të shkrim-leximit si dhe shkallët e shkrim-leximit dhe anal-

fabetizmit për tre grupmoshat e popullsisë në moshë të re, sipas gjinisë. Në të gjitha grupet, shkrim-leximi është pothuajse universal. Shkalla e shkrim-leximit për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç¹² është një nga treguesit për të monitoruar arritjen e OZHQ 4, Nënobjektivi 4.6: Deri në vitin 2030, “të sigurohet që të gjithë të rinjtë dhe një pjesë e konsiderueshme e të rriturve, si burra ashtu edhe gra, të kenë arritur aftësi për lexim, shkrim dhe llogaritje (treguesi 4.6.2)”. Ky tregues pasqyron rezultatet e arsimit fillor gjatë rreth 10 viteve të fundit. Sipas Censit të vitit 2023, ky tregues qëndron në 99,1 përqind, me 98,9 përqind për meshkujt dhe 99,2 përqind për femrat.


Tabela 4.1 Popullsia në moshë të re, sipas statusit të shkrim-leximit, dhe sipas gjinisë (në mijëra); shkalla e shkrim-leximit dhe analfabetizmit, sipas gjinisë (në %)

Statusi dhe shkalla e alfabetizmit	Fëmijë të moshës 10-17			Të rinj të moshës 15-24			Rini e moshës 15-29		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
a. Numër (në mijë)									
Gjithsej	220.7	114.1	106.6	286.1	141.4	144.8	430.3	214.4	215.9
Dinë shkrim e lexim	219.1	113.2	105.8	283.4	139.8	143.6	425.8	211.9	213.9
Analfabetë	1.6	0.9	0.7	2.7	1.5	1.1	4.5	2.6	2.0
b. Shkalla e alfabetizmit dhe analfabetizmit									
Shkalla e alfabetizmit	99.3	99.2	99.3	99.1	98.9	99.2	98.9	98.8	99.1
Shkalla e analfabetizmit	0.7	0.8	0.7	0.9	1.1	0.8	1.1	1.2	0.9

Pavarësisht nivelit pothuajse universal të shkrim-leximit në popullatën e re në Shqipëri, rreth 1,6 mijë fëmijë të moshës 10–17 vjeç, 2,7 mijë të rinj (15-24 vjeç) dhe 4,5 mijë rini (15-29 vjeç) janë raportuar si të paafte për të lexuar dhe shkruar. Kjo nënkupton norma të përgjithshme analfabetizmi prej 0,7 përqind, 0,9 përqind dhe 1,1 përqind për grupet përkatëse të popullsisë në moshë të re. Këto shifra tregojnë se ka disa nënpopullata me akses të kufizuar në mundësitë arsimore. Megjithatë, çdo popullatë përfshin një numër të vogël personash që nuk janë në gjendje të lexojnë dhe shkruajnë për shkak të kufizimeve fizike ose mendore. Vlen të theksohet se norma e analfabetizmit për meshkujt është vazhdimisht disi më e lartë sesa për femrat, ndonëse ky hendek gjinor tek fëmijët është i vogël. Një shpjegim për nivelet më të larta të analfabetizmit tek meshkujt e rinj mund të jetë prevalenca më e lartë e aftësive të kufizuara në këtë grup krahasuar me femrat e reja (shih seksionin 5.2).

Figura 4.1 tregon se që nga Censi i vitit 2011, analfabetizmi është në rënie për të gjitha grupmoshat e popullsisë në moshë të re. Ulja është progresivisht më e vogël nga grupmoshat më të madhe drejt asaj më të re, si në terma absolutë ashtu edhe relativë. Ndërsa rënia relative për grupmoshën 10–14 vjeç ishte vetëm 1,8 përqind, për grupmoshën 25–29 vjeç ishte 18,7 përqind.

Figura 4.1: Shkalla e analfabetizmit të popullsisë 10-29 vjeç dhe rënia absolute e shkallës së analfabetizmit, sipas vitit të censit të popullsisë dhe banesave dhe sipas grupmoshës pesëvjeçare (në %)




¹² Vini re se emërtimi i zakonshëm i këtij treguesi është “norma e shkrim-leximit të rinisë”. Megjithatë, pasi në këtë raport grupmosha 15-24 emërohet si “të rinj” dhe termi “rënia” i referohet grupmoshës 15-29, treguesi quhet norma e shkrim-leximit të të rinjve në vend të normës së shkrim-leximit të rinisë.

4.2.3 Vështrim i përgjithshëm mbi aftësitë shkrim-lexim


Figura 4.2 tregon lidhjen e fortë midis ndjekjes së shkollës dhe aftësive të shkrim-leximit. Ndërsa aftësitë e shkrim-leximi tek të rinjve (10-29 vjeç) që kanë ndjekur ndonjëherë arsimin është i plotë, vetëm një pakicë e grupit të personave që nuk kanë ndjekur asnjëherë arsimin (8,4 mijë persona të moshës 10 deri në 29 vjeç) është në gjendje të lexojë dhe të shkruajë. Në përgjithësi, nuk ka asnjë dallim gjinor në shkallën e aftësive të shkrim-leximit të të rinjve pa arsim.

Figura 4.2: Shkalla e shkrim-leximit e popullsisë në moshë të re gjithsej të moshës 10-29 vjeç, sipas ndjekjes ndonjëherë të arsimit dhe sipas grupmoshave pesëvjeçare (në %)



Përkatësia etnike duket të jetë një faktor i fortë dallues. Siç tregon Figura 4.3, analfabetizmi është më i lartë në popullatën e të rinjve egjiptianë dhe veçanërisht i lartë në popullatën rome. Më shumë se një në katër fëmijë romë (27,8 përqind) dhe rreth një në tre të rinj në popullsinë rome - përkatësisht 33,0 përqind për grupmoshën 14-24 vjeç dhe 35,4 përqind për grupmoshën 15-29 vjeç - nuk janë në gjendje të lexojnë dhe të shkruajnë. Megjithatë rënia e nivelit të analfabetizmit sugjeron se situata po përmirësohet, hendeuku me popullsinë jo-rome në Shqipëri është i konsiderueshëm. Popullsia në moshë të re, me përkatësi etnike shqiptare ka, në mënyrë të theksuar, shkallën më të ulët të analfabetizmit. Megjithatë dallimet në Figurën 4.3 nuk duken mjaft të qarta, niveli i analfabetizmit në mesin e grupeve të tjera etnike dhe popullatës, për të cilën nuk ka informacion për përkatësinë etnike, është rreth 60 përqind më e lartë se ajo e grupit etnik shqiptarë.

Figura 4.3: Shkalla e analfabetizmit të popullsisë së të rinjve, sipas përkatësisë etnike (në %)



Popullsia Rome dallohet për sa i përket hendeikut gjinor në analfabetizëm. Tabela 4.2 paraqet treguesin e barazisë gjinore në analfabetizëm (GPI) – i llogaritur si shkalla e analfabetizmit te

femrat, në përqindje, ndaj asaj të meshkujve. Në grupmoshën e fëmijëve, të gjitha pakicat etnike kanë një tregues të barazisë gjinore në analfabetizëm (GPI) mbi 100, çka tregon se vajzat kanë nivele më të larta të analfabetizmit se djemtë. Situata më e pafavorshme vërehet tek vajzat rome, të cilat kanë një shkallë analfabetizmi 33,3 përqind më të lartë se djemtë. Edhe në grupin “Etnicitet tjetër”, vajzat paraqiten me nivele dukshëm më të larta të analfabetizmit (24,8 përqind). Nga ana tjetër, në popullsinë me përkatësi etnike shqiptare, niveli i analfabetizmit të vajzat, është ndjeshëm më i ulët se ai të djemtë (78,3 përqind). Vlerat përkatëse të treguesit të barazisë gjinore në analfabetizëm për grupet etnike në mesin e të rinjve dhe rinisë janë më të paqëndrueshme. Megjithatë, analfabetizmi të femrat është në mënyrë të qëndrueshme më i lartë në popullsinë rome dhe më i ulët në atë me përkatësi etnike shqiptare.

Tabela 4.2: Indeksi i barazisë gjinore të analfabetizmit i të rinjve, sipas përkatësisë etnike (në %)

Përkatësia etnike	Fëmijët	Të rinjtë	Rinia
	mosha 10-17	mosha 15-24	mosha 15-29
Gjithsej	86.2	72.8	75.6
Shqiptare	78.3	67.3	70.3
Egjiptiane	103.2	107.3	82.4
Rome	133.3	135.6	145.7
Përkatësi etno-kulturore tjetër	124.8	69.4	71.8
Preferoj të mos përgjigjem/Nuk disponohet	67.7	57.1	66.0

Statusi i mirëqënies së NjEF-ve është një tjetër tregues që lidhet ngushtësisht dhe në mënyrë të ndërlikuar me shkallën e aftësive për shkrim-lexim. NjEF-të me nivel më të ulët të mirëqënies kanë më pak mundësi të investojnë në arsimin e fëmijëve të tyre, përfshirë pagesat për shkollën, mësimet shtesë, librat dhe materialet mësimore, apo transportin drejt shkollës, çka çon në nivele më të ulëta të aftësive për shkrim-lexim.

Me ndërtimin e variablit të indeksit të mirëqënies (shih seksionin 1.4), të dhënat e Censit mundësojnë analizën e marrëdhënies midis statusit të mirëqënies së NjEF-së dhe nivelit të aftësive për shkrim-lexim. Në rastin e fëmijëve, mirëqënia e NjEF-së është pothuajse faktori shkaktar, ndërsa shkrim-leximi përfaqëson rezultatin. Veçanërisht për të rinjtë e moshës së re, lidhja shkak-pasojë mund të funksionojë në të dy drejtimet. Figura 4.4 tregon qartë, siç pritej, se kuintilet e NjEF-ve me mirëqënie më të larta dhe të dytat më të larta kanë shkallë shumë të ulëta analfabetizmi për të tre popullsitë në moshë të re. Është paksa befasuese që normat më të larta të analfabetizmit gjenden në kuintilin e dytë më të ulët dhe të mesëm të mirëqënies, ndërsa shkalla e analfabetizmit në kuintilin më të ulët të mirëqënies është rreth mesatares kombëtare.

Figura 4.4: Shkallët e analfabetizmit të të rinjve, sipas statusit ekonomik të NjEF-së (në %)





Figura 4.5 vizualizon rezultatet e një analize regresioni logjistik që identifikon se cilët faktorë

rrisin ose ulin gjasat e një personi për të qenë analfabet ¹³. Grafiku shfaq disa variabla shpjegues - të tilla si “gjinia” - së bashku me kategoritë e tyre (p.sh., “mashkull” dhe “femër”) që përdoren për të shpjeguar rrezikun e të qenit analfabet. Për çdo variabël, një kategori shërben si grup referencë (e theksuar me gri). Të gjitha kategoritë e tjera tregojnë, me një vlerë dhe një shirit horizontal, rrezikun që një person i asaj kategorie të jetë analfabet, në raport me kategorinë referuese. Nëse shiriti zgjatet djathtas dhe është blu i çelur, tregon një rrezik më të lartë analfabetizmi sesa grupi referues. Nëse shtrihet majtas dhe është blu më e errët, tregon një rrezik më të ulët. Kështu, figura tregon se femrat kanë një rrezik 15 përqind më të ulët për të qenë analfabete krahasuar me meshkujt. Në një analizë regresioni, ky efekt pasqyron ndikimin e pavarur të të qenit femër, pasi të merren në konsideratë (ose të kontrollohen) të gjithë faktorët e tjerë të përfshirë në analizë. Disa shirita tregohen me rozë. Kjo sinjalizon se rreziku i shoqëruar është aq i madh sa shfaqja e tij në madhësinë e plotë do ta shtrembëronte grafikun, duke e bërë të vështirë dallimin e vlerave të tjera. Këto rreziqe ekstreme janë ende të marra parasysh, por të të shkurtuara / të prera për të mbajtur grafikun të lexueshëm.

¹³ Sfondet teknike të regresioneve logjistike jepen në seksionin 1.4.2.

Figura 4.5: Rreziku i të qenit analfabet për të rinjtë e moshës 10-29 vjeç, në raport me kategoritë referuese, bazuar në regresionin logjistik (në %)



Përfundimet kryesore të Figurës 4.5 janë se të jetuarit me aftësi të kufizuara¹⁴ dhe përkatësia etnike Rome/Egjiptiane janë, në mënyrë të theksuar, parashikuesit më të fortë të analfabetizmit. Të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen me një rrezik jashtëzakonisht më të lartë: ata

¹⁴ Personat me aftësi të kufizuara përkufizohen si ata që kanë shumë vështirësi ose nuk mund të bëjnë asgjë në të paktën një nga gjashtë fushat funksionale të përfshira në regjistrim: të parit, të dëgjuarit, të ecurit ose të ngjitjes së shkallëve, të kujtuarit ose përqendrimi dhe të kujdesit për veten.

janë pothuajse 100 herë më të predispozuar të jenë analfabetë në krahasim me ata pa aftësi të kufizuara. Duhet theksuar se, ndër të rinjtë, si analfabetizmi ashtu edhe aftësia e kufizuar janë “ngjarje të rralla”, dhe ndryshime të vogla në përhapjen e tyre mund të prodhojnë rezultate të ndryshme. Megjithatë, analiza e regresionit tregon se ndikimi i aftësisë së kufizuar është shumë i fortë dhe ndjeshëm më i madh sesa sugjerojnë tabelat e thjeshta përmbledhëse, të cilat nuk kontrollojnë për variabla të tjerë. Edhe të rinjtë Romë/Egjiptianë kanë një rrezik të lartë: ata janë pothuajse 30 herë më të predispozuar të jenë analfabetë krahasuar me të rinjtë me përkatësi etnike shqiptare.

Edhe pse ndikimet e faktorëve të tjerë mund të duken të parëndësishëm në krahasim me ato të etnisë dhe aftësisë së kufizuar, disa prej tyre paraqesin pengesa serioze për të mësuar shkrim-leximin. Dallimet në nivel qarku janë të dukshme: individët që jetojnë në qarqe si Gjirrokastër, Fieri dhe Shkodra përballen me rrezik ndjeshëm më të lartë për të qenë analfabetë krahasuar me ata në Berat. Mungesa e prindërve rezulton një disavantazh i qartë: mungesa e nënës, në veçanti, shoqërohet me një rrezik 71 përqind më të lartë për analfabetizëm sesa në familjet ku të dy prindërit janë të pranishëm. Edhe mosha ndikon: të rinjtë më të mëdhenj (17–29 vjeç) janë më të predispozuar të jenë analfabetë sesa fëmijët 10–16 vjeç, ndoshta si pasojë e përmirësimeve historike në aksesin dhe cilësinë e arsimit.


Efekte relativisht të vogla janë vërejtur për gjininë dhe tipin e familjes. Megjithatë, pasi kontrollohen variabla të tjerë, vajzat dhe gratë e reja janë 15 përqind më pak të rrezikuara për të qenë analfabete sesa djemtë dhe burrat e rinj, dhe ata që jetojnë në familje të zgjeruara janë pak më të rrezikuara (12 përqind) sesa ata në familje bërthamë. Në kundërshtim me pritshmëritë, pasuria më e lartë e familjes nuk e redukton në mënyrë të qëndrueshme rrezikun e analfabetizmit për moshat 10–29 vjeç. Në fakt, vetëm të rinjtë nga NjEF-e në nivelin e dytë më të lartë të mirëqënies dhe, veçanërisht, ato në atë më të lartë tregojnë një rrezik dukshëm më të ulët sesa ata nga NjEF-të me mirëqënie më të ulët.

4.2.4 Shkrim-leximi në nivel qarku


Modeli në nivel qarku i shkrim-leximit dhe analfabetizmit është kryesisht i qëndrueshëm për të treja popullsitë në moshë të re. Figura 4.6a-c tregon se Fieri, Gjirrokastër dhe Dibra janë vazhdimisht qarqet me shkallët më të larta të analfabetizmit, ndërsa Tirana dhe Vlora janë vazhdimisht midis qarqeve me shkallët më të ulëta të analfabetizmit. Siç tregohet në shifrat në nivel kombëtar, analfabetizmi tek fëmijët është dukshëm më i ulët se ai tek të rinjtë. Modeli i analfabetizmit të fëmijëve ndryshon gjithashtu nga ai i të moshuarve në atë që ndryshimi midis qarqeve është shumë më i vogël. Ndërsa shkalla më e lartë e analfabetizmit tek fëmijët (Fier, 1.1 përqind) është 2,0 herë më e lartë se ajo më e ulëta (Vlorë, 0,6 përqind), shkallët më të larta të analfabetizmit tek të rinjtë dhe rinia (të dyja në Gjirrokastër) janë 2,8 herë më të larta se shkallët më të ulëta (të dyja në Tiranë). Ky është një tregues se qarqet ku arsimi mbeti mbrapa në të kaluarën janë duke kapur hapin e qarqeve më të zhvilluara në vend.

Figura 4.6: Shkallët e analfabetizmit të popullsisë në moshë të re, sipas qarqeve (në %)


a. Fëmijë të moshës 10-17 vjeç



b. Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç




c. Rinia e moshës 15-29 vjeç



Në nivel bashkie, ndryshimi në analfabetizëm është më i madh. Figura 4.7 tregon shkallën e analfabetizmit të fëmijëve të moshës 10-17 vjeç sipas bashkisë. Shumica e bashkive kanë norma që përqendrohen rreth mesatares kombëtare të vendit (0,7 përqind). Megjithatë, ka disa përjashtime të dukshme, me shkallë analfabetizmi që tejkalojnë 2 përqind. Kjo mund të shpjegohet me popullsinë shumë të vogël në disa zona, në të cilat një person tjetër i vetëm i regjistruar si analfabet ka një ndikim të rëndësishëm në shkallën e analfabetizmit. Tabela III.f në Shtojcën III paraqet shkallët e analfabetizmit për të tre grupet e popullsisë në moshë të re sipas bashkisë.

Figura 4.7: Normat e analfabetizmit të fëmijëve të moshës 10–17 vjeç, sipas bashkive (në %)



4.3 Ndjekja e arsimit

4.3.1 Sistemi arsimor në Shqipëri

Sistemi arsimor në Shqipëri është i ndarë në katër nivele. Një përshkrim – disi i thjeshtuar – i sistemit arsimor është si më poshtë:


- *Parashkollor*. Ky nivel arsimor jo i detyrueshëm përfshin:
 - Çerdhe për fëmijë të moshës 0-3 vjeç
 - Kopshti për fëmijë të moshës 3-6 vjeç.
- *Arsimi bazë*. Ky nivel nëntëvjeçar i arsimit të detyrueshëm, me klasat 1-9 për fëmijët e moshës 6 deri në 14 vjeç, përbëhet nga dy cikle:
 - Arsimi fillor (klasat 1-5, mosha 6-10), i cili përqendrohet në shkrim-lëximin themelor, llogaritjen dhe njohuritë bazë.
 - Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9, mosha 11-14), që zgjeron njohuritë e mëparshme dhe prezanton lëndë më të specializuara.
- *Arsimi i mesëm i lartë*. Ky është një nivel trevjeçar i arsimit jo të detyrueshëm, me klasat 10-12 për fëmijët e moshës 15-17 vjeç¹⁵.
- *Arsimi i lartë*. Këtu përfshihen programe në nivelin bachelor, master dhe doktoraturë.

4.3.2 Shkalla e pjesëmarrjes në arsim sipas moshës

Shkalla e pjesëmarrjes në arsim sipas moshës është llogaritur si përqindja e personave në një grupmoshe të caktuar që kanë ndjekur arsim në momentin e Censit në vitin 2023. Figura 4.8 paraqet shkallën e pjesëmarrjes në arsim sipas moshës (duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në kopësht dhe çerdhe), për gjithë popullsinë në moshë të re në moshë 0-29 vjeç. Moshat që lidhen me nivelet e arsimit shënohen me ngjyra të ndryshme: blu shumë e errët për moshën para-shkollore, blu e errët për moshën e arsimit bazë, blu mesatare për moshën e arsimit të mesëm të lartë dhe blu e çelur për moshën e arsimit të lartë dhe më tej. Shkalla e pjesëmarrjes rritet shpejt për fëmijët nga mosha 0 deri në 3 vjeç, në moshën kur fëmijët mund të fillojnë kopështin. Gjatë gjithë periudhës së arsimit bazë, normat e pjesëmarrjes janë të larta dhe të qëndrueshme, përveç disa luhatjeve të vogla. Megjithatë, një prirje lineare¹⁶ në rënie sugjeron se gjatë një periudhe nëntëvjeçare, rreth 1,3 përqind e fëmijëve largohen nga arsimi. Zvogëlimi i pjesëmarrjes në arsim është më i theksuar në grupmoshën e arsimit të mesëm të lartë. Shkalla e pjesëmarrjes bie nga 95,3 përqind në moshën 14 vjeç (që korrespondon me klasën e fundit detyruese të arsimit bazë) në 87,6 përqind në moshën 17 vjeç (që korrespondon me klasën e fundit jo detyruese të arsimit të mesëm të lartë). Gjatë moshave që lidhen me arsimin e lartë (18-22 vjeç) dhe më tej, treguesi i pjesëmarrjes bie me shpejtësi. Nivelet e ulëta, por të konsiderueshme të pjesëmarrjes pas moshës 22 vjeç tregojnë për persona që fillojnë studimet universitare vonë ose përsëri, apo për ata që dëshirojnë të përfundojnë një arsim të lartë apo edhe të mesëm të papërfunduar, për shembull duke u regjistruar në programe online ose me kohë të pjesshme.

¹⁵ Arsimi i mesëm i lartë ka kurrikula paralele për: (a) arsimin e përgjithshëm (gjimnazin), që përgatit nxënësit për universitet; (b) arsimin dhe formimin profesional, që përgatit nxënësit me aftësi specifike për tregun e punës; dhe (c) arsimin e mesëm të "orientuar" (shkolla artistike, shkolla sportive, shkolla të gjuhëve të huaja, etj.). Disa kurrikula zgjasin katër vite.

¹⁶ Vija e trendit nuk është paraqitur. Ekuacioni i vijës së trendit është: $y = -0.1446x + 97.245$

Figura 4.8: Shkalla e pjesëmarrjes në arsim sipas moshës së popullsisë në moshë të re, sipas grupmoshave (në %) ^a

^a Duke përfshirë pjesëmarrjen në çerdhe dhe kopshte

Dallimet gjinore në shkallën e pjesëmarrjes në arsim janë të dukshme në Figurën 4.8. Gjatë moshave që lidhen me arsimin para-shkollor dhe arsimin bazë, këto dallime janë pothuajse të padukshme, por fillojnë të dallohen gjatë moshave që korrespondojnë me arsimin e mesëm të lartë. Figura sugjeron se një normë më e ulët vazhdimi nga arsimi bazë në arsimin e mesëm të lartë dhe/ose një shkallë më e lartë braktisjeje ndër djemtë shpjegojnë këtë divergjenca. Megjithatë, hendeuku gjinor zgjerohet veçanërisht në moshën që lidhet me fillimin e arsimit të lartë (mosha 18 vjeç) dhe edhe më shumë gjatë viteve pasuese të arsimit të lartë, kur më shumë gra se burra vazhdojnë arsimin e tyre. Pas moshës së arsimit të lartë, hendeuku gjinor mbyllet përsëri.

Shkalla e pjesëmarrjes në arsim për fëmijët 6-17 vjeç është 95,1 përqind, duke shfaqur një diferencë shumë të vogël prej 0,7 pikë përqindjeje midis djemve dhe vajzave (Figura 4.9). Nga ana tjetër, hendeuku gjinor midis të rinjve dhe rinisë është më i theksuar. Diferencat absolute prej 10,7 dhe 7,8 pikë përqindjeje, përkatësisht, tregojnë se në të dyja këto grupe, femrat kanë shkallë pjesëmarrjeje më shumë se 20 përqind më të larta se meshkujt.

Figura 4.9: Shkalla e pjesëmarrjes në arsim e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë (në %)




Figura 4.10 dhe Tabela 4.3 paraqesin normat e përgjithshme të pjesëmarrjes në arsim në nivel qarku për tre grupet e reja të popullsisë të dalluara në këtë raport. Ato tregojnë ndryshime të konsiderueshme në nivel qarku, veçanërisht për grupmoshat e të rinjve dhe rinisë. Kështu, shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve të moshës 6-17 vjeç në qarkun me normën më të ulët (Dibër) është pothuajse 9 përqind më e ulët se ajo e qarkut me normën më të lartë (Tiranë). Dibra është gjithashtu qarku me normat më të ulëta të pjesëmarrjes për të rinjtë dhe rininë, me norma rreth 34 përqind më të ulëta se qarku me normën më të lartë për këto

grupmosha (Gjirokastrë). Vlen të theksohet se ndryshimet në normat e pjesëmarrjes në arsim midis qarqeve janë shumë më të mëdha për femrat sesa për meshkujt. Nga Tabela 4.3, përcaktohet se qarku me normën më të ulët është 7,3 përqind më e ulët se ajo me normën më të lartë për djemtë dhe 10,5 përqind më e ulët për vajzat. Për të rinjtë, ndryshimet midis normave më të ulëta dhe më të larta të qarqeve janë 32,1 përqind për meshkujt dhe 39,3 përqind për femrat; për rininë, ato janë përkatësisht 30,2 përqind dhe 38,2 përqind.

Figura 4.10: Shkalla e pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve të moshës 6–17 vjeç, të rinjve dhe rinise, sipas qarkut (në %)




Tabela 4.3: Shkalla e pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve të moshës 6–17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë (në %)

Qarku	Fëmijë 6-17			Të rinj 15-24			Rini 15-29		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Shqipëria	95.1	94.8	95.4	42.4	41.2	43.9	25.6	25.7	25.6
Berat	95.4	95.1	95.7	40.4	39.8	41.0	25.9	26.1	25.6
Dibër	87.3	88.6	86.0	31.7	30.8	32.8	20.3	20.2	20.5
Durrës	95.1	94.6	95.5	41.9	41.2	42.8	25.2	25.6	24.7
Elbasan	94.9	94.4	95.3	43.0	39.9	47.0	26.8	25.0	29.0
Fier	95.3	95.1	95.5	46.6	45.1	48.6	29.5	29.0	30.1
Gjirokastrë	95.7	95.4	96.0	49.0	45.4	54.0	30.7	28.9	33.2
Korçë	95.0	94.8	95.2	44.6	41.6	48.6	27.5	26.1	29.4
Kukës	93.1	93.0	93.3	39.0	37.4	41.0	25.8	25.2	26.6
Lezhë	94.6	94.2	95.0	39.4	37.0	42.4	24.7	23.8	25.8
Shkodër	94.7	94.3	95.1	40.4	39.6	41.4	25.6	25.6	25.5
Tiranë	95.7	95.5	96.0	42.5	42.8	42.2	23.8	25.4	22.3
Vlorë	95.3	95.2	95.4	48.1	45.0	52.0	29.6	28.4	31.0

Shkalla e pjesëmarrjes në arsim, në Vlorë dhe Gjirokastrë, janë vazhdimisht ndër më të lartat, ndërsa ato në Dibër, Lezhë dhe Kukës, zakonisht renditen ndër më të ulëtat. Vlen të theksohet se shkalla e pjesëmarrjes për popullsitë në moshë të re, në Tiranë, tregojnë një ndryshim të madh në krahasim me qarqet e tjera. Ndërsa fëmijët e moshës 6–17 vjeç, në Tiranë, kanë normën më të lartë të pjesëmarrjes në arsim nga të gjitha qarqet, norma e të rinjve në Tiranë është vetëm pak mbi mesataren kombëtare, dhe norma e pjesëmarrjes së rinisë në Tiranë (23,8 përqind) është madje ndër më të ulëtat për këtë grupmoshë ndër qarqet. Duke pasur parasysh praninë e institucioneve kryesore të arsimit të lartë në Tiranë, kjo është paksa surprizuese. Një shpjegim për këtë mund të jetë në shpërndarjen e mundësive të punësimit nëpër qarqe, ku Tirana ofron më shumë mundësi. Në qarqet me më pak mundësi punësimi, njerëzit mund të jenë të prirur të ndjekin më tepër nivele arsimit ose të zhvendosen në Tiranë për të gjetur punë. Të dyja këto strategji kanë efektin e uljes së shkallës së pjesëmarrjes në arsim në Tiranë, krahasuar me qarqet e tjera.

Pritshmëria e viteve të shkollimit

Shkalla e pjesëmarrjes në arsim mund të përdoret për të llogaritur jetëgjatësinë e jetës shkollore (viteve të shkollimit), që është numri i viteve të arsimit zyrtar, që një person, i një moshe të caktuar, mund të presë të marrë në të ardhmen, duke supozuar se probabiliteti i pjesëmarrjes së tij / saj në arsim në çdo moshë të veçantë është i barabartë me normat aktuale të pjesëmarrjes për atë moshë¹⁷. Të dhënat e censit të vitit 2023 tregojnë se një fëmijë gjashtëvjeçar që fillon arsimin bazë (fillor) mund të presë të marrë mesatarisht 14,2 vjet arsim formal¹⁸. Një vajzë gjashtëvjeçare mund të presë të marrë një vit më shumë arsim sesa një djalë i të njëjtës moshë, respektivisht 14,7 vjet kundrejt 13,7 vjet. Këto shifra tregojnë një përmirësim krahasuar me situatën e regjistruar në censin e vitit 2011, kur pritshmëria e jetës shkollore për fëmijët gjashtëvjeçarë ishte 13,8 vjet, ndërsa për djemtë dhe vajzat ishte

¹⁷ Më së miri, pritshmëria e jetës shkollore llogaritet bazuar në normat e regjistrimit në shkollë dhe jo vetëm në normat e pjesëmarrjes, por këto të dhëna nuk janë të disponueshme në cens. Këtu, pritshmëria e jetës shkollore është llogaritur si shuma e normave të pjesëmarrjes në arsim sipas grupmoshave, duke filluar nga arsimi fillor deri te arsimi i tretë.

¹⁸ Vini re se numri i pritshëm i viteve të arsimit të marrë nuk është domosdoshmërisht i njëjtë me numrin e pritshëm të klasave të përfunduara, për shkak të përsëritjes së klasave.

13,7 dhe 14,0 vjet, përkatësisht (INSTAT, 2015). Një fëmijë në moshën 15 vjeç, që lidhet me fillimin e arsimit të mesëm të lartë, mund të presë të marrë mesatarisht 5,5 vjet arsim, krahasuar me 5,2 vjet në vitin 2011 (ibid.). Në moshën që lidhet me fillimin e arsimit terciar (18 vjeç), një person mund të presë të marrë mesatarisht 2,8 vjet arsim. Në secilën prej këtyre moshave, hendeuku gjinor në pritshmërinë e jetës shkollore është një vit në favor të vajzave.

Arsimi parashkollor

Arsimi parashkollor është i rëndësishëm, pasi krijon bazën për mësimin, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës gjatë gjithë jetës. Ndërveprimi me fëmijë të tjerë dhe të rritur në këtë fazë të jetës zhvillon aftësitë njohëse, sociale, emocionale dhe fizike, dhe ofron ekspozim në mjedise më të pasura gjuhësore që rritin fjalorin. Hulumtimet në mbarë botën kanë treguar se fëmijët që ndjekin të paktën një vit arsimi parashkollor janë më të prirur të zhvillojnë aftësitë kyçe që u nevojiten për të pasur sukses në shkollë dhe kanë më pak gjasa të përsërisin klasat ose të braktisin shkollën.

Tabela 4.4 paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin ose nuk ndjekin arsimin parashkollor, qoftë në çerdhe apo kopshte 19. OZHQ 4.2.2 – shkalla e pjesëmarrjes në programe të organizuara mësimore (një vit para moshës zyrtare të hyrjes në arsimin bazë), sipas gjinisë – është pjesë e OZHQ 4, konkretisht nën Objektivin 4.2: Deri në vitin 2030, siguri që të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë të kenë akses të zhvillimi cilësor në fëmijërinë e hershme, të kujdesit dhe arsimit parashkollor, në mënyrë që të jenë gati për arsimin bazë. Ky tregues përcaktohet si përqindja e fëmijëve në grupmoshën përkatëse që marrin pjesë në një ose më shumë programe mësimore, duke përfshirë edhe ato që ofrojnë një kombinim të arsimit dhe kujdesit. Për Shqipërinë, ky tregues i referohet përqindjes së fëmijëve pesëvjeçarë që kanë ndjekur kopshtin. Me 21,3 mijë fëmijë që ndjekin kopshtin nga gjithsej 24,0 mijë pesëvjeçarë, treguesi qëndron në 88,8 përqind²⁰. Kjo është pak më poshtë mesatares së BE-së dhe Evropës në vitin 2023, por mbi vendet e rajonit për të cilat ka të dhëna (shih Figurën 4.11). Për djemtë dhe vajzat, përqindja është përkatësisht 89,1 dhe 88,4 përqind.


Tabela 4.4: Fëmijët e moshës 0–5 vjeç, sipas moshës dhe statusit të pjesëmarrjes (në mijë); shkalla e pjesëmarrjes, sipas moshës (në %)

Mosha	Ndjekin			Nuk ndjekin	Shkalla e ndjekjes
	Gjithsej	Çerdhe	Kopsht		
Gjithsej	160.7	32.8	49.5	78.5	51.2
0	21.1	2.1	0.0	19.1	9.8
1	21.5	6.4	0.0	15.1	29.8
2	23.2	10.6	0.0	12.6	45.8
3	23.3	13.7	5.2	4.5	80.8
4	22.7	0.0	20.5	2.2	90.2
5	24.0	0.0	21.3	2.7	88.8

¹⁹ Vini re se numri i pritshëm i viteve të arsimit të marrë nuk është domosdoshmërisht i njëjtë me numrin e pritshëm të klasave të përfunduara, për shkak të përsëritjes së klasave.

²⁰ NAR (Norma Neto e Pjesëmarrjes) llogaritet si raporti midis numrit të nxënësve që i përkasin moshës zyrtare për një nivel të caktuar arsimit dhe që ndjekin atë nivel arsimor, me numrin total të popullsisë së atij grupmoshe, i shprehur në përqindje.

Figura 4.11: Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin e organizuar një vit përpara hyrjes në arsimin bazë zyrtarë, sipas vendit ose rajonit (në %)^a



^a Burimet e të dhënave: BE, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut – baza e të dhënave Eurostat (Eurostat, 2025); Evropa dhe Bosnje-Hercegovina – Kombet e Bashkuara (UNDESA, 2025a).

Norma neto e pjesëmarrjes dhe raporti bruto i pjesëmarrjes

Norma neto e pjesëmarrjes dhe raporti bruto i pjesëmarrjes janë tregues kyç për planifikimin arsimor dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit arsimor në një vend. Ato ofrojnë njohuri plotësuese mbi pjesëmarrjen në arsim dhe mundësojnë krahasime të standardizuara ndërkombëtare, duke ndihmuar njëkohësisht në identifikimin e sfidave dhe orientimin e politikave të synuara për mundësi gjithëpërfshirëse dhe efektive të arsimit. Norma neto e pjesëmarrjes (NAR) është përqindja e fëmijëve ose të rinjve që i përkasin grupmoshës zyrtare për një nivel të caktuar arsimit dhe që realisht ndjekin shkollën në atë nivel ²¹. Një NAR e lartë – afër 100 përqind – tregon një përputhje efektive midis moshës dhe klasës, duke sugjeruar se fëmijët fillojnë dhe përparojnë në arsim në kohën e duhur. Raporti bruto i pjesëmarrjes (GAR) mat pjesëmarrjen gjithsej në një nivel të caktuar arsimit, pavarësisht moshës, dhe shprehet si përqindje e popullsisë në moshën zyrtare për atë nivel ²². Krahasuar me NAR, GAR pasqyron kërkesën më të gjerë ndaj sistemit arsimor. Ai përdoret për të matur pjesëmarrjen e përgjithshme në një nivel të caktuar arsimor, pa marrë parasysh mospërputhjet e moshës, dhe tregon kapacitetin e sistemit për të regjistruar nxënës të një grupmoshe të caktuar. Gjithashtu, është i rëndësishëm veçanërisht për të identifikuar nevojat për infrastrukturë dhe staf, pasi reflekton kërkesën gjithsej ndaj sistemit arsimor.

Tabela 4.5 paraqet normat neto të pjesëmarrjes për nivelet e ndryshme të arsimit. Diferenca midis normës së shënuar dhe 100 përqind tregon përqindjen e personave që nuk janë fare në sistemin arsimor ose ndjekin një nivel më të ulët ose më të lartë nga sa pritet, për shkak të përsëritjes së klasave, fillimit të hershëm ose të vonuar në shkollë. Për shembull, NAR gjithsej për arsimin e mesëm të ulët prej 87,6 përqind sugjeron se 12,4 përqind e fëmijëve të moshës 11–14 vjeç (mosha e arsimit të mesëm të ulët) nuk ndjekin nivelin arsimor që i korrespondon moshës së tyre. Ata janë ose duke e ndjekur arsimin fillor ose të mesëm të lartë, ose janë plotësisht jashtë shkolle (duke qenë se e kishin braktisur ose nuk e kishin filluar asnjëherë shkollën). Siç pritet, NAR bie me çdo nivel arsimor, me arsimin e lartë që përfshin afërsisht gjysmën e personave në moshën përkatëse për arsimin terciar (18–22 vjeç) ²³.

²¹ NAR (Norma Neto e Pjesëmarrjes) llogaritet si raporti midis numrit të nxënësve që i përkasin moshës zyrtare për një nivel të caktuar arsimit dhe që ndjekin atë nivel arsimor, me numrin total të popullsisë së atij grupmoshe, i shprehur në përqindje.

²² GAR (Raporti Bruto i Pjesëmarrjes) llogaritet si raporti midis numrit të përgjithshëm të personave që ndjekin një nivel të caktuar arsimit, pavarësisht moshës, me popullsinë që i përket grupmoshës zyrtare për atë nivel arsimit, i shprehur në përqindje.

²³ NER (Norma Neto e Regjistrimit) për arsimin e lartë është një tregues më pak i përshtatshëm për shkak të ndryshimeve në kohëzgjatjen e programeve në këtë nivel arsimor.

Në arsimin bazë – që përfshin arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët – NAR-të për djemtë dhe vajzat janë të ngjashme, që pasqyrohet edhe në Indeks të Barazisë Gjinore (GPI) afër 100 përqind. GPI për arsimin e mesëm të lartë është pak mbi 100 përqind (102,5 përqind), duke treguar se relativisht më shumë vajza sesa djem të moshës 15–17 vjeç ndjekin shkollën e mesme të lartë. Pabarazia gjinore thellohet më tej në nivelin e arsimit të lartë, ku pothuajse 70 përqind më shumë femra sesa meshkuj të moshës së përshtatshme ndjekin arsimin.

Tabela 4.5: Normat neto të pjesëmarrjes dhe raportet bruto të pjesëmarrjes, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë; indeksët e barazisë gjinore, sipas nivelit arsimor (në %)

Indikatori i ndjekjes së arsimit, Niveli arsimor	Gjinia			GPI
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	
Raporti neto i ndjekjes së arsimit				
Arsimi bazë	89.1	89.0	89.1	100.2
Arsimi fillor	90.3	90.4	90.2	99.8
Arsimi 9 vjeçar	87.6	87.4	87.9	100.7
Arsimi i mesëm	82.3	81.3	83.4	102.5
Arsimi i lartë	47.6	34.9	59.4	169.9
Raporti bruto i ndjekjes së arsimit				
Arsimi bazë	97.1	97.7	96.5	98.8
Arsimi fillor	95.7	96.4	95.0	98.5
Arsimi 9 vjeçar	98.7	99.1	98.3	99.2
Arsimi i mesëm	102.4	104.9	99.8	95.1
Arsimi i lartë	62.6	48.5	75.7	156.1


Shumica e raporteve bruto të pjesëmarrjes (GAR) të paraqitura në Tabelën 4.5 janë nën 100 përqind. Një GAR nën 100 përqind nënkupton se një pjesë e popullsisë në moshë shkollore për një nivel të caktuar arsimor nuk ndjek shkollën, pavarësisht nëse ata janë në moshën e duhur për atë nivel apo jo. Raporti relativisht i ulët për arsimin fillor (95,7 përqind) shpjegohet pjesërisht nga një numër i konsiderueshëm gjashtëvjeçarësh që ende ndjekin kopsh-tin. Raportet bruto të pjesëmarrjes për arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin bazë në tërësi janë më afër 100 përqind, duke treguar një shkallë të lartë pjesëmarrjeje dhe kapacitetin e sistemit arsimor për të përfshirë popullsinë në moshë shkollore për këto nivele. Nga ana tjetër, raporti prej 102,5 përqind për arsimin e mesëm të lartë tregon se një pjesë e nxënësve ose po përsërisin klasat, ose kanë hyrë vonë apo herët në këtë nivel arsimor. GAR për arsimin terciar mund të përdoret si zëvendësim për treguesin e OZHQ 4.3.2 që bazohet në censet, për të matur progresin drejt Objektivit 4.3: Deri në vitin 2030, siguri i aksesit të barabartë për të gjitha gratë dhe burrat në arsim të përbalueshëm cilësor, teknik, profesional dhe të lartë, përfshirë universitetin. Shifra nga Censi 2023 prej 62,6 përqind tregon një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me atë të Censit 2011 (52 përqind) (INSTAT, 2015).

Indekset e barazisë gjinore (GPI) për shumicën e NAR dhe GAR janë afër 100, duke treguar modele të ngjashme pjesëmarrjeje për meshkujt dhe femrat. Përfundimisht bëjnë GPI-të për arsimin terciar, të cilat tregojnë një pjesëmarrje dukshëm më të lartë të grave në këtë nivel arsimi – një faktor ky që qëndron në themel të nivelit më të lartë të arritjeve arsimore për gratë në arsimin e lartë, siç raportohet në seksionin 4.3.2.

Një GAR i lartë nuk nënkupton që të gjithë pjesëmarrësit janë brenda grupmoshës zyrtare. Në veçanti, një kombinim i një GAR-i të lartë me një NAR të ulët sugjeron se një numër i konsiderueshëm nxënësish po përsërisin klasat ose po hyjnë në nivele arsimore më herët apo më vonë nga sa duhet. Figura 4.12 paraqet përqindjen e nxënësve, mosha e të cilëve nuk përputhet me nivelin e arsimit që ndjekin. Shumica dërmuese e tyre janë më të mëdhenj në moshë sesa mosha zyrtare për atë nivel arsimor. Përqindja e personave që nuk ndjek nivelin arsimor të përshtatshëm për moshën përkatëse rritet me nivelin e arsimit: afërsisht një në

20 në arsimin fillor, një në 10 në të mesmin e ulët, një në 5 në të mesmin e lartë dhe një në 4 në arsimin terciar. Figura gjithashtu tregon se vajzat dhe gratë ndjekin më shpesh sistemin arsimor në përputhje me moshën zyrtare shkollë, në krahasim me djemtë dhe burrat.

Figura 4.12: Përqindja e nxënësve me moshë që nuk korrespondon me nivelin e arsimit që ndjekin




Fëmijët që nuk ndjekin arsimin

OZHQ 4, treguesi 4.1.4 për shkallën e pjesëmarrjes jashtë shkollës mat përparimin drejt Objektivit 4.1: Deri në vitin 2030, siguri që të gjitha vajzat dhe djemtë ta përfundojnë arsimin bazë tërësisht pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, i cili çon në rezultate të përshtatshme dhe efektive të të nxënësve. Ky tregues evidenton përqindjen e fëmijëve në moshë arsimore që janë plotësisht jashtë sistemit arsimor, edhe pse mund të kenë ndjekur arsimin më parë. Në këtë raport, norma e fëmijëve jashtë shkollës i referohet përqindjes së fëmijëve brenda grup-moshës zyrtare për një nivel të caktuar arsimor, të cilët nuk kishin ndjekur arsimin në asnjë nivel në kohën e Cens-it.

Siç tregohet në Figurën 4.13, 3,5 përqind e fëmijëve në moshë shkollë për arsimin bazë (6-14 vjeç) nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm. Kjo përfaqëson 8,3 mijë fëmijë, nga të cilët 4,4 mijë janë djem dhe 3,9 mijë vajza. Brenda arsimit bazë, normat e fëmijëve jashtë shkolle në arsimin e mesëm të ulët janë pak më të larta sesa në arsimin fillor. Normat jashtë shkolle në arsimin e mesëm të lartë janë më shumë se dyfish më të larta dhe më të larta për djemtë sesa për vajzat. Në total, 7,3 mijë fëmijë në moshë shkollë për arsimin e mesëm të lartë janë jashtë shkollës, prej të cilëve 4,2 mijë janë djem dhe 3,1 mijë janë vajza.

Figura 4.13: Shkalla e jashtë shkollës, sipas nivelit arsimor dhe gjinisë (në %)




Vetëm një përqindje shumë e vogël e të rinjve nga gjithë popullsia nuk ka ndjekur asnjëherë arsimin. Për fëmijët, të rinjtë dhe rininë, këto përqindje janë përkatësisht 1,3 përqind, 1,4 përqind dhe 1,6 përqind. Kjo përfaqëson 4,1 mijë, 4,1 mijë dhe 7,0 mijë persona. Përqindjet në rritje për grupmoshat më të mëdha tregojnë se nivelet e pjesëmarrjes në arsimin formal janë përmirësuar me kalimin e kohës. Në të gjitha grupmoshat, përqindja e meshkujve që nuk kanë ndjekur asnjëherë arsimin është më e lartë se ajo e femrave.

4.3.3 Faktorët që ndikojnë në ndjekjen e arsimit

Pjesëmarrja në arsim e të rinjve të moshës gjashtë vjeç e lart

Disa faktorë të lidhur me rrethanat shoqërore dhe ekonomike ndikojnë në pjesëmarrjen e popullsisë në moshë të re në arsim në Shqipëri. Gjendja ekonomike e NjEF-së është në lidhje pozitive me shkallën e ndjekjes së arsimit për të gjitha grupmoshat e reja. Për fëmijët e moshës 6–17 vjeç, që i përkasin grupmoshës zyrtare për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, ndikimi i mirëqënies është i vogël. Ndikimi më i madh vihet re tek të rinjtë 15–24 vjeç, që përfshihen kryesisht në grupmoshën zyrtare të arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit të lartë. 68,8 përqind e të rinjve nga NjEF-të me mirëqënien më të lartë ndjekin arsimin, krahasuar me 52,3 përqind nga NjEF-të me mirëqënien më të ulët – një diferencë prej 16,5 pikë përqindjeje. Është interesante që nuk ka thujasë asnjë ndryshim në ndjekjen e arsimit midis meshkujve dhe femrave nga NjEF-të e kuintilit më të lartë, por ndryshimi gjinor thellohet te NjEF-të me mirëqënien më të ulët. Ku, 58,5 përqind e vajzave të reja nga NjEF-të me mirëqënien më të ulët ndjekin arsimin, ndërsa kjo përqindje bie në 46,4 përqind për djemtë e rinj të së njëjtës kategori. Ka të ngjarë që ndikimi kryesor i mirëqënies së NjEF-së lidhet me ndjekjen më të gjatë të arsimit, veçanërisht në nivelin universitar, që është më i aksesueshëm për të rinjtë nga NjEF-të me mirëqënien më të lartë. Ky efekt është disi më i vogël te të rinjtë në grupmoshën 25–29 vjeç, të cilët kryesisht e kanë përfunduar arsimin dhe janë futur në tregun e punës.

Figura 4.14: Përqindja e fëmijëve, të rinjve dhe të rinisë që ndjekin arsimin, sipas statusit të mirëqënies së NjEF-së




Studimet mbi performancën arsimore ndërbreznore tregojnë në mënyrë të qëndrueshme se niveli arsimor i nënës ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të fëmijëve të saj (Utsinger, 2020). Ky efekt vepron përmes disa rrugëve të ndërlidhura, si burime më të shumta për të mbështetur arsimin, shëndet më i mirë i fëmijës dhe shtyrja e martesës. Rezultatet e Censit 2023 mbështesin fuqishëm efektin pozitiv të arsimit të nënës: Figura 4.15 tregon se me çdo nivel më të lartë të arsimit të përfunduar nga nëna, përqindja e fëmijëve që nuk ndjekin shkollën ulët²⁴. Mospjesëmarrja në arsim e fëmijëve është 10 herë më e lartë për nënat që nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor,

²⁴ Kjo analizë i referohet vetëm fëmijëve të cilëve nëna është pjesë e NjEF-së

krahasuar me ato që kanë përfunduar një nivel të arsimit të lartë. Për shumicën e niveleve të arsimit të nënës, efekti në ndjekjen e shkollës nga vajzat dhe djemtë është i ngjashëm. Përfundim bën rasti i nënave që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor: këtu, përqindja e djemve që nuk ndjekin arsimin (14,5 përqind) është dukshëm më e lartë se ajo e vajzave (11,4 përqind).

Figura 4.15: Përqindja e fëmijëve të moshës 6–17 vjeç që nuk ndjekin arsimin, sipas nivelit arsimor të nënës dhe sipas gjinisë së fëmijës



Studimet e mëparshme mbi migracionin në Shqipëri kanë gjetur prova për një ndikim negativ të mungesës së prindërve në ndjekjen e shkollës nga fëmijët (Giannelli & Mangiavacchi, 2010). Të dhënat e Censit 2023 e mbështesin këtë gjetje, duke theksuar veçanërisht shkallë më të ulët pjesëmarrjeje nëse nëna mungon. Figura 4.16 tregon se mungesa e babait në NjEF duket se ka një ndikim të vogël, por domethënës, negativ në ndjekjen e arsimit nga fëmijët. Megjithatë, figura sugjeron një ndikim shumë më të madh nga mungesa e nënës: fëmijët që jetojnë në NjEF ku nëna mungon kanë dy herë më shumë gjasa të jenë jashtë sistemit arsimor, krahasuar me ata që jetojnë me të dy prindërit (9,6 përqind kundrejt 4,5 përqind). Fëmijët që kanë të dy prindërit mungesë janë tre herë më të rrezikuar të mos ndjekin shkollën (14,0 përqind). Mund të ndodhë që vajzat më të rritura të marrin rolin e kujdestareve për motrat e vëllezërit më të vegjël, duke u pamundësuar vetes vazhdimin e shkollimit. Nevojitet kërkim më i thelluar për të kuptuar pse mungesa e të dy prindërve ndikon veçanërisht tek vajzat.

Figura 4.16: Përqindja e fëmijëve të moshës 6–17 vjeç që nuk ndjekin arsimin, sipas mungesës së prindërve në NjEF dhe sipas gjinisë së fëmijës




Figura 4.17 paraqet rezultatet e një analize regresioni logjistik, e cila identifikon faktorët që rrisin ose ulin gjasat që një person të mos ndjekë arsimin ²⁵. Analiza ishte e kufizuar për moshat që përfshihen në arsimin fillor deri në arsimin e lartë (moshat 6–22 vjeç). Grupmoshat në analizë janë përzgjedhur që të përkojnë me nivelet përkatëse të arsimit.

Grafiku tregon se mospjesëmarrja në arsim – njësoj si në rastin e analfabetizmit (shih Figurën 4.5) – ndikohet fuqimisht nga aftësia e kufizuar dhe përkatësia etnike. Të rinjtë nga komunitetet Rom dhe Egjiptian, si dhe personat me aftësi të kufizuara, kanë rreth 6 herë më shumë gjasa të mos ndjekin shkollën, krahasuar me bashkëmoshatarët me etni shqiptare dhe personat pa aftësi të kufizuara.

Mosha dhe statusi martesor janë edhe më të fuqishëm si parashikues të mospjesëmarrjes në arsim. Grupmoshat tregojnë qartë ndërprerjen e arsimit pas ciklit të detyrueshëm të arsimit të mesëm të ulët dhe, në një shkallë edhe më të lartë, në moshën për arsimin e lartë. Të rinjtë në moshë për arsimin e mesëm të lartë kanë 1,6 herë më shumë gjasa të mos ndjekin shkollën sesa fëmijët në moshë për arsimin fillor. Për të rinjtë në moshën për arsimin e lartë, kjo gjasë është mbi 24 herë më e lartë. Rreziku shumë i lartë i personave të martuar ndonjëherë ²⁶ për të mos ndjekur shkollën (mbi 12 herë më i lartë sesa te ata që nuk janë martuar asnjëherë) thekson se për shumë njerëz, pavarësisht gjinisë, martesë dhe arsimit janë shpesh të papërputhshëm. Martesa mund të tregojë një ndryshim në prioritetet e jetës – nga investimi afatgjatë në arsim, drejt përgjegjësisë të kujdesit familjar ose menaxhimit të shtëpisë. Gjithashtu, martesë mund të sjellë nevojë më të madhe për të ardhura, gjë që mund të ulë kohën ose motivimin për të vazhduar arsimin. Megjithatë, marrëdhënia mes martesës dhe arsimit është komplekse, dhe shkak mund të veprojë në të dy drejtimet (Kalmijn, 2013; Ahn & Winters, 2025; Becker, 1981). Pra, martesë mund të përbëjë pengesë për vijimin e arsimit, por nga ana tjetër, arsimit i zgjat mund të çojë në vonesë të martesës.


Një model i qartë dhe i qëndrueshëm vërehet sipas grupeve të mirëqënies familjare: rreziku për të mos ndjekur arsimin bie ndjeshëm me rritjen e mirëqënies. Individët nga kuintili më i lartë i mirëqënies kanë 1,4 herë më pak gjasa të jenë jashtë shkollës, krahasuar me grupin e referencës nga kuintili më i ulët. Kjo sugjeron se statusi i ulët mirëqënies mbetet një pengesë kryesore për pjesëmarrjen në arsim. Vajzat dhe të rejtat kanë 1,1 herë më pak gjasa të mos jenë në shkollë sesa djemtë dhe të rinjtë, duke mbështetur gjetjet e tjera në këtë raport që tregojnë përfshirje më të mirë të femrave në arsim.

Faktorët e tjerë duken se kanë ndikim më të vogël në rrezikun për të mos ndjekur arsimin. Megjithatë, mungesa e një ose të dy prindërve në NjEF e rrit vazhdimisht këtë rrezik, krahasuar me fëmijët që jetojnë me të dy prindërit. Këto gjetje nënvizojnë, nga njëra anë, pozitën më të ndjeshme të fëmijëve pa prindër dhe, nga ana tjetër rolin vendimtar që nënat luajnë në vijimësinë e arsimit të fëmijëve.

²⁵ Përshkrimet teknike të regresioneve logjistik janë të dhëna në seksionin 1.4.2. Referojuni gjithashtu tekstit para Figurës 4.5 për shpjegime dhe interpretim më të detajuar të këtij lloji grafiku.

²⁶ Pothuajse të gjithë janë aktualisht të martuar (seksioni 3.1.5)

Figura 4.17: Rreziku për të mos ndjekur arsimin për fëmijët dhe të rinjtë të moshës 6-22 vjeç në raport me kategoritë e referencës, bazuar në regresion logjistik (në %)



Pjesëmarrja në arsimin parashkollor

Efektet e variablave të sfondit mbi arsimin parashkollor – që përfshin kopshte dhe çerdhe – janë kryesisht të ngjashme me ato të arsimit në nivele më të larta, por shfaqen disa ndryshime. Tabela 4.6 paraqet detaje mbi shkallën e pjesëmarrjes së fëmijëve të moshës 0-6 vjeç

në çerdhe dhe kopshte, si dhe shkallën e mos-pjesëmarrjes. Sa i përket mos-pjesëmarrjes, ndikimi i statusit ekonomik të NjEF-së është pak më i dobët, por shkalla e mos-pjesëmarrjes është ndjeshëm më e lartë për tre kuintilet më të ulëta të mirëqënies (mbi 53 përqind) krahasuar me kuintilet e dyta: e lartë dhe më e larta (45,1 dhe 40,3 përqind, përkatësisht). Efekti i arsimimit të nënës mbi mos-pjesëmarrjen në arsimin parashkollor është i dukshëm, megjithëse diferenca midis nënave pa arsimin e përfunduar dhe atyre me arsimin fillor është praktikisht e papërfillshme. Mungesa e prindërve ka një efekt të vogël në pjesëmarrje, krahasuar me ndikimin e saj në ndjekjen e shkollës. Nuk ka asnjë ndryshim midis mungesës së nënës dhe babait. Fëmijët Egjiptianë dhe veçanërisht Romë kanë shkallë shumë më të lartë të mos-pjesëmarrjes në arsimin parashkollor krahasuar me grupet e tjera etnike: përkatësisht 61,7 dhe 73,5 përqind, në krahasim me 48,8 përqind në përgjithësi. Për dallim nga arsimi formal, ndryshimet midis djemve dhe vajzave në mos-pjesëmarrjen në arsimin parashkollor janë minimale.

Pjesëmarrja në çerdhe është dukshëm më e ulët se ajo në kopsht, me shkallë pjesëmarrjeje për të gjithë grupmoshën 0-6 vjeç prej 20,4 dhe 30,8 përqind, përkatësisht. Është interesante që shkallët më të ulëta të mos-pjesëmarrjes tek dy kuintilet më të larta i atribuohen kryesisht shkallëve më të larta të pjesëmarrjes në çerdhe. Pjesëmarrja në kopshte për të gjitha kuintilet e mirëqënies ndryshon pak nga niveli i përgjithshëm, ndërsa në çerdhe, kuintilet e dyta më e lartë dhe atë më të lartën kanë shkallë pjesëmarrjeje ndjeshëm më të lartë se niveli mesatar, përkatësisht 23,8 dhe 28,5 përqind (shih edhe Figurën 4.18).

Një efekt i fortë mbi pjesëmarrjen në çerdhe shihet gjithashtu nga niveli i arsimit të nënës. Fëmijët e nënave me arsim të mesëm ose më pak kanë nivele pjesëmarrjeje në çerdhe nën mesatare (shih edhe Figurën 4.19). Vetëm fëmijët e nënave me ndonjë nivel të arsimit të lartë kanë shkallë të lartë pjesëmarrjeje në çerdhe (28,5 përqind). Megjithatë, niveli i arsimit të nënës nën atë të arsimit të lartë ka efekt mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në kopshte, duke u rritur nga 24,0 përqind për nënat pa asnjë nivel arsimor të përfunduar në 32,5 përqind për ato me arsim të mesëm.

Mungesa e prindërve në NjEF nuk tregon ndonjë ndryshim të dukshëm në nivelet e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor, as në pjesëmarrjen në çerdhe, as në atë në kopshte. Gjithashtu, pak dallime vërehen midis vajzave dhe djemve në nivelet e pjesëmarrjes.

Tabela 4.6: Statusi i pjesëmarrjes në arsimin parashkollor të fëmijëve të moshës 0-6 vjeç dhe lloji i arsimit parashkollor të ndjekur, sipas disa variablave të faktorëve dhe sipas gjinisë (në %)

	Gjithsej			Meshkuj			Femra		
	Ndjekin		Nuk Ndjekin	Ndjekin		Nuk Ndjekin	Ndjekin		Nuk Ndjekin
	Çerdhe	Kopësht		Çerdhe	Kopësht		Çerdhe	Kopësht	
a. Statusi i mirëqënies së NjEF									
Gjithsej	20.4	30.8	48.8	20.3	30.9	48.8	20.6	30.6	48.8
Më e ulët	15.0	30.8	54.2	14.7	30.9	54.4	15.4	30.7	53.9
E dyta më e ulët	15.0	31.1	53.9	14.8	31.8	53.5	15.3	30.4	54.3
E mesme	17.1	29.6	53.3	17.3	29.5	53.2	16.9	29.7	53.4
E dyta e lartë	23.8	31.1	45.1	24.0	30.4	45.6	23.7	31.8	44.6
E lartë	28.5	31.1	40.3	28.2	31.8	40.0	28.9	30.4	40.7
b. Arsimimi i nënës									
Gjithsej	20.5	30.8	48.8	20.3	30.9	48.8	20.6	30.6	48.8
Asnjë nivel arsimimor i përfunduar	14.1	24.0	61.9	14.0	23.9	62.2	14.3	24.1	61.5
Arsimi fillor	11.4	27.1	61.4	12.4	27.0	60.6	10.5	27.2	62.3
Arsimi 9 vjeçar/arsim teknik	13.4	32.5	54.1	13.4	32.6	54.0	13.4	32.3	54.3
Arsimi i mesëm	18.4	30.2	51.4	18.3	30.5	51.3	18.5	29.9	51.6
Çdo nivel i arsimit të lartë	28.2	30.3	41.4	27.9	30.4	41.7	28.6	30.2	41.2
c. Prezenca e prindërve në NjEF									
Gjithsej	20.4	30.8	48.8	20.3	30.9	48.8	20.6	30.6	48.8
Të dy prindërit prezent në NjEF	20.6	30.6	48.7	20.5	30.7	48.8	20.8	30.6	48.6
Babai jo prezent	18.1	32.3	49.5	18.0	33.6	48.4	18.2	31.0	50.7
Mamaja jo prezente	17.2	33.5	49.3	18.0	33.5	48.5	16.3	33.5	50.2
Të dy prindërit jo prezent në NjEF	18.2	29.9	51.9	17.3	31.1	51.6	19.1	28.7	52.2
d. Përkatësia Etnike									
Gjithsej	20.4	30.8	48.8	20.3	30.9	48.8	20.6	30.6	48.8
Shqiptare	20.5	31.0	48.5	20.4	31.2	48.4	20.6	30.9	48.5
Rome	9.2	17.3	73.5	9.3	18.7	72.1	9.1	15.9	75.1
Egyptiane	12.4	25.9	61.7	11.6	25.9	62.5	13.1	25.9	60.9
Përkatësi etno-kulturore tjetër	20.9	30.1	49.0	21.4	30.2	48.4	20.3	30.1	49.6
Preferoj të mos përgjigjem/Nuk disponohet	21.6	29.3	49.2	20.6	29.3	50.0	22.5	29.2	48.3

Figura 4.18: Përqindja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç që ndjekin çerdhe ose kopsht, sipas statusit të mirëqënies së NjEF-së dhe sipas gjinisë së fëmijës





Figura 4.19: Përqindja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç që ndjekin çerdhe ose kopsht, sipas nivelit arsimor të nënës dhe sipas gjinisë së fëmijës




4.4 Arsimi i përfunduar

4.4.1 Individët pa asnjë nivel arsimor të përfunduar

Pjesa më e madhe e individëve mbi 15 vjeç që jetojnë në Shqipëri kanë përfunduar të paktën një nivel arsimor. Sipas Censit 2023, vetëm 0,6 përqind e të gjithë individëve mbi 15 vjeç nuk kishin përfunduar asnjë nivel arsimor (Figura 4.20). Vërehet vetëm një dallim i vogël midis burrave dhe grave: 0,5 përqind për burrat dhe 0,8 përqind për gratë. Përqindja e individëve që nuk kishin përfunduar asnjë nivel arsimor ishte më e lartë tek fëmijët 10-17 vjeç: 13,0 përqind. Kjo nuk duhet të habisë, pasi pyetja në cens për arsimin kërkon nivelin më të lartë të përfun-


duar arsimor. Natyrisht, shumë nga popullsia në moshë të re në këto grupmosha ende ndjekin shkollën, veçanërisht tek fëmijë të moshës 10-17 vjeç nuk kishin përfunduar asnjë nivel, pasi ishin ende tepër të rinj për të përfunduar arsimin bazë. Është interesante që për të rinjtë dhe rininë përqindja e atyre që nuk kishin përfunduar asnjë nivel arsimor është pak më e lartë sesa për të gjithë individët mbi 15 vjeç. Nuk është e qartë se çfarë e ka shkaktuar këtë rritje.

Figura 4.20: Përqindja e popullsisë mbi 15 vjeç, fëmijëve 10-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë pa asnjë nivel arsimor të përfunduar, sipas gjinisë



Krahasuar me Censin 2011, përqindja e popullatës në moshë të re që nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor është shumë më e ulët (Figura 4.21). Në vitin 2011, përqindja e të rinjve të moshës 15-24 vjeç që nuk kishin përfunduar asnjë nivel ishte 7,8 përqind, krahasuar me vetëm 1,6 përqind në vitin 2023. Dallimi midis viteve 2011 dhe 2023 ishte pak më i vogël për rininë (5,8 përqind kundrejt 1,8 përqind). Këto shifra tregojnë se është bërë një përparim i rëndësishëm në lidhje me arsimin e përfunduar të të rinjve shqiptarë.

Figura 4.21: Përqindja e fëmijëve të moshës 10-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë pa asnjë nivel arsimor të përfunduar, sipas vitit të censit




Ekzistojnë disa ndryshime në përqindjen e të rinjve 15-29 vjeç, që nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor, sipas statusit ekonomik të NjEF-së ku ata banojnë. Figura 4.22 tregon këto përqindje, sipas statusit ekonomik dhe gjinisë. Për të gjitha kuintilet, përqindja e atyre që nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollë është pak më e lartë tek meshkujt sesa tek femrat. Do të pritej që përqindja më e lartë të ishte tek të rinjtë që i përkasin kuintilit me mirëqënie më të ulët. Megjithatë, kjo nuk ndodh. Përqindja më e lartë është tek kuintili i mesëm ekono-

mik. Për të dy gjinitë, 2,7 përqind e individëve 15-29 vjeç nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor, që është rreth një pikë përqindjeje më shumë se tek ata që i përkasin kuintilit më të ulët. Nga ana tjetër, tek të rinjtë që i përkasin kuintilit me mirëqënie më të lartë, vetëm 0,7 përqind nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor.

Sipas Anketës Demografike dhe Shëndetësore 2008-2009 (DHS), përqindja e femrave në grupmoshën 15-24 vjeç pa arsim ishte 0,4 përqind, e njëjta si tek meshkujt. Në të njëjtën grupmoshë, 3,7 përqind e femrave dhe 2,8 përqind e meshkujve kishin përfunduar vetëm pjesërisht arsimin fillor (INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF Macro, 2010). Duhet theksuar se ndryshimi midis niveleve të vëzhguara në DHS-në 2008-2009 dhe Censit 2011 është i konsiderueshëm. Kjo lidhet me mënyrën se si janë formuluar pyetjet për arsimin e përfunduar. Ndërsa në Censin 2023 pyetja ka qenë për nivelin e përfunduar të arsimit, në DHS-të e viteve 2008-2009 dhe 2017-2018 pyetja ishte për nivelin më të lartë të arsimit të ndjekur ose të përfunduar. Kjo pyetje natyrisht çoi në nivele më të ulëta të 'të pa arsimuarve'.

Figura 4.22: Përqindja e të rinjve pa asnjë nivel arsimor të përfunduar, sipas statusit të mirëqënies së NJEF-së dhe sipas gjinisë



4.4.2 Niveli arsimor i përfunduar


Figura 4.23 tregon përqindjen e popullsisë në moshë të re mbi 10 vjeç që ka përfunduar ndonjë nivel arsimor, sipas gjinisë dhe nivelit të arsimit të përfunduar. Grafiku paraqet nivelin e arsimit të përfunduar për fëmijët 10-17 vjeç, të rinjtë (15-24 vjeç) dhe rininë (15-29 vjeç). INSTAT konsideron katër nivele të përgjithshme të arsimit: i) arsimin fillor (klasat 1-5), ii) arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9), iii) arsimin e mesëm të lartë, që përfshin gjimnazin dhe arsimin profesional/zyrtar, dhe iv) çdo nivel të arsimit të lartë (terciar).

Natyrisht, shumë në këto grupmosha janë ende në shkollë, sidomos fëmijët 10-17 vjeç. Në këtë grupmoshë, shumica e fëmijëve kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (58,0 përqind), ndërkohë më pak kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët (40,3 përqind). Në këtë grupmoshë, dallimet midis djemve dhe vajzave janë minimale. Ka një diferencë të qartë në nivelin e arsimit midis meshkujve dhe femrave në grupmoshat 15-24 dhe 15-29 vjeç. Në grupmoshën 15-29, 35,2 përqind e femrave kanë përfunduar arsimin e lartë, kundrejt vetëm 20,2 përqind të meshkujve.

Nga ana tjetër, përqindjet për arsimin e mesëm të lartë dhe të ulët janë dukshëm më të larta tek meshkujt sesa tek femrat. Sipas Eurostat-it (Eurostat, 2023), në vitin 2022, 48 përqind e grave të moshës 25-34 vjeç në BE kishin përfunduar arsimin e lartë, krahasuar me 37 përqind të burrave. Përqindjet për Shqipërinë nuk mund të krahasohen drejtpërdrejt me ato

të Eurostat-it, pasi kategoritë e moshës janë të ndryshme dhe të dhënat trajtojnë vetëm individët që kanë patur të paktën një nivel arsimor. Interesant është fakti se kuadri strategjik i Zonës Evropiane të Arsimit ka vendosur si objektiv që deri në vitin 2030, 45 përqind e individëve të moshës 25-34 vjeç të kenë përfunduar arsimin e lartë (Komisioni, p. d.). Megjithatë një krahasim i drejtpërdrejtë midis Shqipërisë dhe të dhënave të Eurostat-it nuk është plotësisht i mundur për shkak të grupmoshave të ndryshme, të dhënat tregojnë se prirja e përfundimit të arsimit të lartë tek femrat e reja është në përputhje me prirjen e përgjithshme arsimore në Evropë.

Figura 4.23: Përqindja e fëmijëve 10-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë që kanë përfunduar ndonjë nivel arsimor, sipas gjinisë dhe sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar




Një pamje më e detajuar paraqitet në Figurën 4.24. Në këtë grafik, arsimi i përfunduar ndahet sipas grupmoshave 20-24, 25-29 dhe mbi 30 vjeç, si dhe sipas gjinisë. Grupmosha 15-19 nuk u konsiderua, pasi shumë të rinj në këtë grupmoshë janë ende në shkollë. Grupmosha mbi 30 vjeç u shtua për të krahasuar pozicionin e individëve më të rinj me atë të bashkëmoshatarëve të tyre më të vjetër.

Siç pritej, niveli i arsimit tek popullsia në moshë të re, si meshkuj ashtu edhe femra, është shumë më i lartë se tek grupmosha mbi 30 vjeç. Për shembull, ndërsa 56,5 përqind e femrave në grupmoshën 25-29 vjeç kanë arsim të lartë, kjo shifër është vetëm 17,9 përqind tek femrat mbi 30 vjeç. Tek meshkujt, këto përqindje janë përkatësisht 33,8 dhe 17,0 përqind.


Figura 4.24 tregon gjithashtu se feminizimi i arsimit është një tendencë e re. Tek grupmosha mbi 30 vjeç, diferenca midis meshkujve dhe femrave me arsim të lartë është minimale: 17,9 përqind për femrat dhe 17,0 përqind për meshkujt. Megjithatë, grupmosha 25-29 paraqet një pamje krejt tjetër. Në këtë grup, 56,5 përqind e femrave kanë përfunduar ndonjë nivel të arsimit të lartë, kundrejt 33,8 përqind të meshkujve. Rreth 117 mijë persona në grupmoshën 25-29 kanë përfunduar një formë të nivelit të arsimit të lartë, prej të cilëve afërsisht 75 mijë janë femra dhe 42 mijë meshkuj.

Figura 4.24: Përqindja e individëve të moshës 20 vjeç e lart, sipas gjinisë dhe grupmoshës, sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar



Përqindja e të rinjve (20-24 vjeç) që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë, sipas gjinisë, është një nga treguesit llogaritet nga Anketat e Forcës së Punës në Shqipëri. Censi 2023 lejon shtimin e treguesve të bazuar në të gjithë popullsinë. Me kalimin e viteve, përqindja e grupmoshës 20-24 vjeç që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë është rritur si për meshkujt ashtu edhe për femrat (Figura 4.25). Në vitin 2017, përqindjet për meshkujt dhe femrat ishin përkatësisht 75 dhe 81 përqind. Gjatë periudhës 2017-2021 u vu re një rritje graduale, disi më e shpejtë për meshkujt sesa për femrat. Deri në vitin 2022, përqindja arriti në 82 përqind për meshkujt dhe 84 përqind për femrat. Sipas Censit 2023, kjo përqindje është rritur më tej, duke arritur në 89 përqind për femrat dhe 85 përqind për meshkujt.

Figura 4.25: Përqindja e personave të moshës 20-24 vjeç që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, sipas gjinisë dhe sipas vitit kalendarik a




a Burimi: Raporti mbi treguesit e mirëqenies së të rinjve në Shqipëri (INSTAT & UNICEF, 2022.)

Në kuadrin e OZHQ, normat e përfundimit të arsimit fillor dhe të mesëm janë tregues kyç për monitorimin e OZHQ 4.1, i cili synon që të gjithë vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, me cilësi dhe në mënyrë të barabartë. Ky tregues pasqyron përparimin drejt mundësive gjithëpërfshirëse dhe të mësimit gjatë gjithë jetës, dhe thekson boshllëqet në qasjen, mbajtjen dhe barazinë në arsim. Norma e përfundimit llogaritet si numri i individëve në grupmoshën përkatëse që kanë përfunduar nivelin arsimor, në krahasim me numrin total të individëve në atë grupmoshë, shprehur në përqindje. Grupi përkatës i moshës zakonisht është disa vjet më vonë se mosha zyrtare e diplomimit, për të kompensuar vonesat në përfundimin e arsimit, të cilat janë të zakonshme në shumë vende.

Figura 4.26 tregon normat e përfundimit për popullsinë e moshës 20-24 vjeç. Sipas censit të vitit 2023, norma e përfundimit të arsimit fillor për të dyja gjinitë së bashku ishte 98,2 përqind.²⁷ Normat e përfundimit për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë ishin përkatësisht 97,5 dhe 86,9 përqind. Për të tre nivelet e arsimit, normat e përfundimit ishin pak më të larta tek femrat se tek meshkujt. Diferenca ishte më e madhe për arsimin e mesëm të lartë, me një normë përfundimi prej 89,1 përqind për femrat dhe 84,6 përqind për meshkujt.

Figura 4.26: Normat e përfundimit për individët e moshës 20-24 vjeç, sipas nivelit të arsimit dhe sipas gjinisë (në %)




Në botimin e saj mbi treguesit e OZHQ 4, UNESCO paraqet normat e përfundimit për të dyja gjinitë për periudhën 2013–2024 (UNESCO, Instituti i Statistikave, 2025)²⁸. Figura 4.27 paraqet normat e përfundimit të arsimit, bazuar si në vlerësimet e UNESCO-s, ashtu edhe në statistikën e ofruara nga Censi 2023. Grafiku tregon se normat e përfundimit të marra nga të dy burimet janë shumë të ngjashme, duke sugjeruar se cilësia e të dhënave është e mirë në të dy rastet. Ndërsa norma e përfundimit të arsimit fillor në vitin 2023, sipas të dhënave të modeluara nga UNESCO është 97,4 përqind, sipas të dhënave të Censit 2023 është 98,2 përqind. Për arsimin e mesëm të ulët, diferenca është po aq e vogël (96,9 përqind sipas UNESCO-s dhe 97,5 përqind sipas censit). Për arsimin e mesëm të lartë, mospërputhja është pak më e madhe: 87,4 përqind sipas të dhënave të UNESCO-s dhe 86,9 përqind sipas Censit 2023, por përsëri bëhet fjalë për një ndryshim prej pak më shumë se një pikë përqindje. Trendi në kohë nga viti 2013 deri në vitin 2024 tregon se nivelet e përfundimit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët janë shumë të larta dhe kanë mbetur thuajse të pandryshuara. Megjithatë, është bërë përparim i rëndësishëm vitet e fundit në përqindjen e të rinjve që kanë për-

²⁷ Norma e përfundimit të arsimit fillor u llogarit duke pjesëtuar numrin e personave në grupmoshën 20-24 vjeç që përfunduan arsimin fillor me totalin e popullsisë në grupmoshën 20-24 vjeç, shprehur në përqindje.

²⁸ Për të llogaritur normat e përfundimit, UNESCO përdor vlerësime të modeluara për të gjithë periudhën. Për këtë qëllim, ata kanë përdorur shifra për një kohortë fëmijësh ose të rinjsh të moshës 3 deri në 5 vjet më shumë se mosha e synuar për klasën e fundit të secilit nivel arsimor, të cilët e kanë përfunduar atë klasë. Normat e përfundimit nga censi analizohen duke përdorur një metodë paksa të ndryshme llogaritjeje. Niveli i përfundimit për të tre nivelet e arsimit (fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë) llogaritet për popullsinë në moshën 20-24 vjeç. Kjo është bërë për shkak të disponueshmërisë së të dhënave.


funduar arsimin e mesëm të lartë. Në vitin 2013, vetëm 69,7 përqind e të rinjve kishin përfunduar arsimin e mesëm të lartë. Në vetëm 12 vite, kjo përqindje është rritur në 88,2 përqind.

Figura 4.27: Normat e përfundimit të arsimit për popullsinë e moshës 20-24 vjeç, sipas nivelit arsimor dhe sipas vitit kalendarik (në %)



Në nivel qarku, ekziston një larmi në arritjet arsimore të popullsisë në moshë të re në Shqipëri. Për të studiuar këtë ndryshueshmëri, hulumtimi është përqendruar te individët e moshës 25–29 vjeç, të cilët kanë përfunduar të paktën një nivel arsimor. Fëmijët dhe të rinjtë nuk janë përfshirë, pasi shumë prej tyre janë ende në shkollë, çka do të shtrembëronte rezultatet. Tirana dallohet si qarku me përqindjen më të lartë të individëve 25–29 vjeç që kanë përfunduar një formë të arsimit të lartë (shih Figurën 4.29). Nga të gjithë ata që kanë të paktën një nivel të përfunduar arsimor, 60,3 përqind kanë arsim të lartë. Vetëm 9,5 përqind kanë arsimin e mesëm të ulët si nivelin më të lartë të përfunduar. Nga ana tjetër, përqindja e individëve me arsim fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Tiranë është më e ulët krahasuar me të gjitha qarqet e tjera. Dibër ka rezultatet më të ulëta për arsimin e lartë, me vetëm rreth 30 përqind të individëve 25–29 vjeç që kanë përfunduar këtë nivel. Ky qark gjithashtu ka përqindjen më të lartë të individëve me arsim të mesëm të ulët (27,4 përqind).

Figura 4.28: Përqindja e individëve të moshës 25–29 vjeç që kanë përfunduar të paktën një nivel arsimor, sipas nivelit të arsimit të përfunduar dhe sipas qarkut



5. Aftësia e Kufizuar

5.1 Hyrje

Pyetësi i Censit 2023 përfshiu një modul të standardizuar mbi aftësinë e kufizuar, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, dhe Setin e Shkurtër të Pyetjeve të Grupit të Washingtonit (Washington Group - WG) për personat e moshës 5 vjeç e lart. Të anketuarit u vlerësuan në gjashtë fusha funksionale: shikimi, dëgjimi, ecja, njohja (kognicioni), kujdesi ndaj vetes dhe komunikimi. Këto fusha ndihmojnë në identifikimin e individëve që përjetojnë vështirësi, të cilat mund të kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e përditshme (Grupi i Washingtonit për Statistikat mbi Aftësinë e Kufizuar, 2020).

Gjashtë pyetjet e WG të bëra janë si më poshtë:

- A ka <Emri> ndonjë vështirësi në shikim, edhe kur mban syze?
- A ka <Emri> ndonjë vështirësi në dëgjim, edhe kur përdor aparat dëgjimi?
- A ka <Emri> ndonjë vështirësi në ecje ose në ngjitje shkallësh?
- A ka <Emri> ndonjë vështirësi në të mbajtur mend, përqendruar apo në marrjen e vendimeve?
- A ka <Emri> ndonjë vështirësi në kujdesin e përditshëm ndaj vetes, si veshja, ngrënia apo larja?
- A ka <Emri> ndonjë vështirësi në komunikim, pra në kuptimin e të tjerëve apo në dhënien dhe marrjen e informacionit?

Në këtë kapitull, do të përdoren disa koncepte që lidhen me kuadrin e WG për aftësinë e kufizuar. Më poshtë, këto koncepte shpjegohen për të ndihmuar në kuptimin më të mirë të gjetjeve në këtë raport:

- Kufizim funksional: Në kuadrin e WG, kufizimi funksional i referohet vështirësive që një individ mund të ketë në kryerjen e aktiviteteve bazë për shkak të një problemi shëndetësor. WG ka zhvilluar një grup pyetjesh të standardizuara – të njohura si Seti i Shkurtër – për të identifikuar personat me aftësi të kufizuara bazuar në vështirësitë në fushat funksionale bazë, dhe jo në diagnoza mjekësore.
- Fusha e funksionimit: WG përdor gjashtë fusha të aktivitetit bazë – shikimi, dëgjimi, ecja, kujtimi/përqendrimi, kujdesi ndaj vetes dhe komunikimi – për të identifikuar dhe matur aftësinë e kufizuar.
- Niveli/shkalla e vështirësisë: Çdo pyetje në Setin e Shkurtër të WG përdor katër kategori të standardizuara përgjigjeje:
 1. Jo, pa vështirësi
 2. Po, pak vështirësi
 3. Po, shumë vështirësi
 4. Nuk mundem fare

Pyetjet dhe kategoritë e përgjigjeve të WG janë krijuar për të qenë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar dhe janë të fokusuara në identifikimin e kufizimeve funksionale që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e plotë në shoqëri. Në fakt, nuk ka një standard të artë për të përcaktuar se kush jeton me një aftësi të kufizuar dhe kush jo.

Duhet theksuar se pyetjet mbi aftësinë e kufizuar në Censin 2023 u drejtuan vetëm për fëmijët e moshës 5 vjeç e lart, dhe për matjen e aftësisë së kufizuar te fëmijët u përdor Seti i Shkurtër i pyetjeve, në vend të versionit më të zgjeruar. Për këtë arsye, analiza në këtë raport është e kufizuar vetëm te fëmijët pesë vjeç e lart. Për më tepër, një cens nuk është një anketë e specializuar për aftësinë e kufizuar, dhe si rezultat, nënraportimi dhe keqraportimi kanë një ndikim më të madh.

Për të kompensuar informacionin më të kufizuar që ofron Seti i Shkurtër i WG-së dhe për të rritur lexueshmërinë e raportit për një audiencë më të gjerë, u vendos që, për pjesën më të madhe të raportit, të përdoret një klasifikim diadik për aftësinë e kufizuar (me/pa aftësi të kufizuar). Kjo ndarje bazohet në kriteret e njohura ndërkombëtarisht të WG. Më saktë, një person konsiderohet me aftësi të kufizuar nëse përjeton “shumë vështirësi” ose “nuk mund ta bëjë fare” të paktën në një nga fushat funksionale (Grupi i Washingtonit për Statistikat mbi Aftësinë e Kufizuar, 2021). Ky prag është në përputhje me praktikat globale, duke siguruar krahasueshmëri ndërmjet vendeve, përputhje me kuadrot e monitorimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe pajtueshmëri me grupe të tjera të të dhënave ndërkombëtare.

Autorët e raportit njohin rëndësinë e ofrimit gjithashtu të një klasifikimi më të detajuar, të bazuar në kufizimet funksionale të raportuara dhe jo vetëm në ndarjen me ose pa aftësi të kufizuar. Duke qenë se aftësia e kufizuar ekziston në një spektër, shumë individë që raportojnë “pak vështirësi” në funksionim mund të përballen gjithsesi me barriera për të marrë pjesë tërësisht në shoqëri, sidomos në mjedise që nuk janë gjithëpërfshirëse. Për të reflektuar këtë spektër më të gjerë të kufizimeve funksionale, raporti paraqet rezultate të ndara në Shtojcën V, duke përdorur një klasifikim në tre nivele:

- Pa vështirësi në asnjë fushë funksionimi;
- Vështirësi të lehta (të paktën “pak vështirësi” në të paktën një nga fushat, por jo më të rënda);
- Vështirësi mesatare/të rënda (të paktën “shumë vështirësi” ose “nuk mundet fare” në të paktën një fushë).

Tabelat dhe grafiket e paraqitura në Shtojcën V mund të ndihmojnë politikëbërësit në hartimin e përgjigjeve gjithëpërfshirëse që marrin parasysh një grup më të gjerë personash potencialisht në rrezik – ata me “pak vështirësi në fushat përkatëse” – dhe t’u ofrojnë palëve të interesuara një kuptim më të nuancuar të profileve funksionale popullatës në moshë të re përtej ndarjes binare.

5.2 Karakteristikat e përgjithshme të popullsisë në moshë të re me aftësi të kufizuara

Tabela 5.1 paraqet numrin e fëmijëve, të rinjve dhe rinisë, sipas statusit dhe nivelit të aftësisë së kufizuar. Janë paraqitur si shifrat absolute, ashtu edhe normat e përhapjes. Sipas censit, në të gjithë vendin, 3,4 mijë fëmijë (5–17 vjeç) kanë kufizime funksionale mesatare ose më të rënda. Këto shifra janë 3,3 mijë për të rinjtë dhe 5,4 mijë për rininë²⁹.

Është interesante të shihet se, numri i personave 5 vjeç e lart në popullatën totale me aftësi të kufizuara është më i lartë te femrat (83,4 mijë), sesa te meshkujt (66,5 mijë). Megjithatë, tek popullsia në moshë të re, shifrat janë të kundërta. Shkalla/norma e prevalencës për popullsinë e përgjithshme janë më të larta për femrat sesa për meshkujt, ndërsa për popullsinë në moshë të re, normat e prevalencës janë më të larta për meshkujt, sesa për femrat. Djemtë dhe të rinjtë meshkuj mund të përjetojnë nivele më të larta të aftësisë së kufizuar, për shkak të një kombinimi faktorësh biologjikë, të sjelljes, socio-ekonomikë dhe mjedisorë. Faktorët biologjikë përfshijnë çrregullime neurozhvillimore dhe predispozita gjenetike, ndërsa aspektet e sjelljes lidhen me sjelljet e rrezikshme dhe nivelet më të larta të lëndimeve. Të gjithë këta faktorë lidhen me mundësi më të larta për të pasur aftësi të kufizuar.

Në të gjithë botën, prevalenca e aftësisë së kufizuar është ndjeshëm më e lartë në grupmoshat më të vjetra. Efekti i përhapjes më të lartë në grupmoshat më të vjetra është i dukshëm edhe në Tabelën 5.1, pasi prevalenca në çdo nivel të aftësisë së kufizuar është shumë

²⁹ Këto shifra (kolona 4 e tabelës 5.1) i korrespondojnë klasifikimit të Grupit të Washingtonit për personat me aftësi të kufizuara, ku përcaktohet pragu i aftësisë së kufizuar në rast se një person has ‘shumë vështirësi’ ose ‘nuk mundet fare’ në të paktën një nga fushat funksionale.

më e lartë në kategorinë “pesë vjeç e lart” krahasuar me kategoritë e moshave më të reja.

Norma e prevalencës së aftësisë së kufizuar llogaritet si numri i personave që shprehin se kanë “shumë vështirësi” ose “nuk mundet fare”, pjesëtuar me numrin total të popullsisë në atë grupmoshë specifike. Sipas Censit 2023, norma e përhapjes ishte 6,5 përqind për personat pesë vjeç e lart. Prevalenca e raportuar e aftësisë së kufizuar është shumë e ulët te fëmijët, të rinjtë dhe rinia. Përhapja është rreth një përqind për secilën nga këto grupe, me meshkujt që kanë një përhapje pak më të lartë – vetëm disa të dhjeta përqind më shumë sesa femrat – Figura 5.1.

Figura 5.1: Norma të prevalencës së aftësisë së kufizuar për personat 5 vjeç e lart, fëmijët 5–17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas gjinisë (në %)




Tabela 5.1: Popullsia dhe shkalla e prevalencës së aftësive të kufizuara te popullsia mbi 5 vjeç, fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë.

a. Numër

Grupet e popullsisë	Niveli i aftësisë së kufizuar					
	Gjithsej			Pa vështirësi		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
5 vjeç e lartë	2,290,219	1,132,247	1,157,972	1,828,343	925,224	903,119
Fëmijët 5-17	346,080	179,264	166,816	334,195	172,997	161,198
Të rinjtë 15-24	286,123	141,365	144,758	276,198	136,286	139,912
Rinia 15-29	430,330	214,434	215,896	414,820	206,345	208,475

Grupet e popullsisë	Niveli i aftësisë së kufizuar								
	Disi me vështirësi			Me vështirësi			Nuk mundem fare		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
5 vjeç e lartë	461,876	207,023	254,853	149,866	66,507	83,359	23,237	11,674	11,563
Fëmijët 5-17	11,885	6,267	5,618	3,359	2,040	1,319	1,094	714	380
Të rinjtë 15-24	9,925	5,079	4,846	3,282	1,997	1,285	1,170	714	456
Rinia 15-29	15,510	8,089	7,421	5,363	3,224	2,139	1,963	1,181	782

b. Shkalla e prevalencës së aftësive të kufizuara (në %)

Grupet e popullsisë	Niveli i aftësisë së kufizuar											
	Pa vështirësi			Disi me vështirësi			Me vështirësi			Nuk mundem fare		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
5 vjeç e lartë	79.8	81.7	78.0	20.2	18.3	22.0	6.5	5.9	7.2	1.0	1.0	1.0
Fëmijët 5-17	96.6	96.5	96.6	3.4	3.5	3.4	1.0	1.1	0.8	0.3	0.4	0.2
Të rinjtë 15-24	96.5	96.4	96.7	3.5	3.6	3.3	1.1	1.4	0.9	0.4	0.5	0.3
Rinia 15-29	96.4	96.2	96.6	3.6	3.8	3.4	1.2	1.5	1.0	0.5	0.6	0.4

Normat e prevalencës, në Figurën 5.1, janë më të ulëta nga sa pritej., Kjo është një veçori e zakonshme në cense (Mitra, 2021). Ka disa arsye pse censet nuk arrijnë të evidentojnë numrin e saktë të personave me aftësi të kufizuara. Në shumë shoqëri, aftësia e kufizuar bart një stigmë, gjë që bën që NjEF-të të fshehin ose të nën raportojnë rastet, ose që madje ta ndalojnë vetë anketuesin të bëjë pyetje për aftësinë e kufizuar. Gjithashtu, individët mund të mos vetëidentifikohen si persona me aftësi të kufizuara, edhe nëse përballen me kufizime funksionale, sidomos kur stigma është e pranishme. Pavarësisht nën raportimit, censi mbetet një mjet i vlefshëm për të përshkruar kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuara, pasi të dhënat mbulojnë të gjithë popullsinë e vendit dhe mundësojnë të dhëna përfaqësuese në nivel kombëtar, qarku dhe bashkie. Megjënese censi mbulon shumë aspekte të jetës së individëve, është e lehtë të përshkruhen modelet dhe pabarazitë ndërmjet personave me dhe pa aftësi të kufizuara. Me pak fjalë, edhe pse censi mund të mos jetë burimi më i mirë për të vlerësuar përhapjen e aftësisë së kufizuar në një vend, ai ofron të dhëna të vlefshme fillestare mbi kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuara që mund të përdoren nga qeveria për hartimin e politikave, shpërndarjen e burimeve dhe strategjitë e përfshirjes.

Norma gjithsej e prevalencës së aftësisë së kufizuar ishte 6,2 përqind në censin e vitit 2011, i cili gjithashtu përdori pyetjet e WG. Megjithatë, kjo normë u llogarit për popullsinë 15 vjeç e lart. Ashtu si në raportin aktual, një person konsiderohej me aftësi të kufizuar nëse shënonte se kishte shumë vështirësi ose nuk ishte në gjendje të kryente një ose më shumë nga funksionet bazë (Ferré, 2015). Normat e prevalencës për fëmijët dhe të rinjtë nuk mundeshin të llogariten. Për të rinjtë 15–24 vjeç, u raportua se 2 përqind e meshkujve dhe 1 përqind e femrave kishin aftësi të kufizuar.

Për Censin 2023, ndër të gjithë personat 5 vjeç e lart, kufizimi funksional më i shpeshtë është ai në ecje, që prek 4,3 përqind të popullsisë (Tabela 5.2). Kufizimi i dytë më i shpeshtë është ai i të parit (2,3 përqind). Përsëri, vërehen norma shumë më të ulëta për fëmijët, të rinjtë dhe rininë, krahasuar me popullsinë 5 vjeç e lart. Megjithëse në përqindje të vogla, normat për meshkujt janë vazhdimisht më të larta sesa për femrat në popullsinë në moshë të re. Në të tre grupmoshat e popullsisë në moshë të re, problemet me kujtesën, vetëkujdesin dhe komunikimin rezultojnë më të përhapur. Por asnjë prej tyre nuk tejkalon 1 përqind. Interesante është se modeli për të gjithë popullsinë është krejtësisht ndryshe. Për personat 5 vjeç e lart, ecja është kufizimi më i përhapur (4,3 përqind), i ndjekur nga të parit (2,3 përqind). Gjithashtu, për të gjithë popullsinë, prevalenca është më e lartë për të gjashtë kategoritë funksionale të femrat sesa të meshkujt. Kjo lidhet të paktën pjesërisht me faktin se pas moshës 65 vjeç, ka më shumë femra sesa meshkuj (INSTAT, 2024), dhe kjo është një grupmoshë me përhapje të lartë të aftësisë së kufizuar.

Normat e prevalencës së aftësisë së kufizuar në qarku ndryshojnë ndjeshëm për popullsinë 5 vjeç e lart (Figura 5.2). Normat më të larta të prevalencës janë në Lezhë (8,6 përqind) dhe Berat (8,5 përqind). Norma të larta gjenden gjithashtu në Elbasan dhe Fier, që të dyja me mbi tetë përqind të popullsisë që raportojnë një aftësi të kufizuar mesatare ose të rëndë. Prevalenca më e ulët gjendet në Tiranë (4,8 përqind). Nuk është e qartë se çfarë e shkakton saktësisht


këtë prevalencë më të ulët në Tiranë. Një arsye e mundshme mund të jetë fakti që Tirana ka përjetuar një rritje të madhe të popullsisë nga migrimi i brendshëm nga qarqet dhe zonat rurale. Meqenëse migrimi i personave me aftësi të kufizuara është më i ulët, kjo mund të ketë ulur prevalencën në Tiranë dhe ta ketë rritur në qarqet dhe zonat rurale prej nga ata janë larguar.

Ka shumë pak variacion mes qarqeve për normat e prevalencës së aftësisë së kufizuar të fëmijët. Të gjitha qarqet lëvizin rreth mesatares kombëtare prej 1,0 përqind. I njëjti model është vërejtur edhe për grupin e të rinjve dhe rinisë (rezultatet nuk janë të paraqitura).

Tabela 5.2: Norma e prevalencës së aftësive të kufizuara te personat 5 vjeç e lart, fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas gjinisë dhe llojit të kufizimit funksional (në %).

Grupet e Popullsisë	Gjinia	Në shikim	Në dëgjim	Në ecje	Kujtesë	Kujdesin ndaj vetes	Në komunikim
5 vjeç e lartë	Gjithsej	2.3	1.7	4.3	1.7	1.8	1.3
	Meshkuj	2.0	1.6	3.6	1.6	1.8	1.3
	Femra	2.6	1.8	5.1	1.7	1.9	1.4
Fëmijë 5-17	Gjithsej	0.3	0.2	0.3	0.5	0.5	0.6
	Meshkuj	0.3	0.2	0.4	0.6	0.6	0.7
	Femra	0.3	0.1	0.3	0.3	0.3	0.4
Të rinjë 15-24	Gjithsej	0.4	0.3	0.5	0.6	0.6	0.7
	Meshkuj	0.4	0.3	0.6	0.8	0.8	0.9
	Femra	0.3	0.2	0.4	0.4	0.4	0.5
Rinia 15-29	Gjithsej	0.4	0.3	0.5	0.7	0.7	0.7
	Meshkuj	0.4	0.3	0.6	0.9	0.8	0.9
	Femra	0.3	0.2	0.5	0.5	0.5	0.5

Figura 5.2: Norma e prevalencës së aftësive të kufizuara te popullsia 5 vjeç e lart dhe fëmijët 5-17 vjeç, sipas qarqeve (në %)




Një indeks i barazisë gjinore (GPI), për aftësinë e kufizuar, u llogarit për çdo qark, me qëllim analizimin e dallimeve gjinore në prevalencën e aftësisë së kufizuar. GPI për aftësinë e kufizuar mat raportin midis femrave dhe meshkujve me aftësi të kufizuara, i përshtatur sipas

madhësisë përkatëse të popullsisë së tyre. Ky tregues reflekton nëse femrat dhe meshkujt përfaqësohen në mënyrë të barabartë mes personave me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh ndryshimet në strukturën e përgjithshme të popullsisë. Kjo qasje është më e saktë sesa thjesht përdorimi i raportit gjinor të personave me aftësi të kufizuara, i cili krahasohet vetëm numrin e femrave me atë të meshkujve, pa marrë në konsideratë kontekstin më të gjerë të popullsisë dhe që mund të keqinterpretojë pabarazitë gjinore për shkak të dallimeve në moshë. Një vlerë më e madhe se 100 do të thotë se prevalenca relative e aftësisë së kufizuar është më e lartë tek femrat, duke sugjeruar se gratë kanë më shumë gjasa se burrat të kenë aftësi të kufizuara kur kjo llogaritet në raport me madhësinë e popullsisë. Një vlerë më e ulët se 100 tregon se burrat kanë më shumë gjasa se gratë të kenë aftësi të kufizuara.

Figura 5.3 paraqet këta indekse të barazisë gjinore sipas qarqeve për popullsinë 5 vjeç e lart dhe për fëmijët 5–17 vjeç. Është e qartë se në të gjitha qarqet, ndër personat 5 vjeç e lart, femrat kanë një përhapje shumë më të lartë të aftësisë së kufizuar sesa meshkujt, ndërsa në fëmijëri ndodh e kundërta. Në nivel kombëtar, prevalenca e aftësisë së kufizuar te personat 5 vjeç e lart ka një GPI prej 122,6, ndërsa për fëmijët është vetëm 69,5. Mospërputhja më e madhe midis popullsisë mashkullore dhe asaj femërore vërehet në qarkun e Elbasanit, ku GPI për popullsinë 5 vjeç e lart (130,6) është më shumë se dy herë më i lartë se GPI për fëmijët (61,0). GPI-të për të rinjtë dhe rininë nuk janë paraqitur në figurë, por tregojnë rezultate të ngjashme me ato të fëmijëve.

Figura 5.3: Indeksi i barazisë gjinore për aftësitë e kufizuara te popullsia 5 vjeç e lart dhe fëmijët 5-17 vjeç, sipas qarqeve (në %)



5.3 Kushtet e banimit të personave me aftësi të kufizuar

5.3.1 Përbërja familjare e personave me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara shpesh varen nga të tjerët rreth tyre, për të siguruar plotësimin e nevojave të përditshme, prandaj është e rëndësishme të kuptohet lloji i NjEF-së ku ata jetojnë. Lloji i NjEF-së në të cilën jetojnë fëmijët me aftësi të kufizuara ndikon në mënyrë të konsiderueshme në mirëqenien e tyre, pasi ndikon në nivelin e kujdesit, mbështetjes emocionale dhe aksesit në burime që ata marrin. NjEF-të e qëndrueshme dhe mbështetëse – veçanërisht ato me kujdestarë të informuar dhe të angazhuar – mund të përmbushin më mirë nevojat e tyre, të promovojnë përfshirjen dhe të mbështesin zhvillimin e tyre. Bazuar në

marrëdhënien me kryefamiljarin, është përcaktuar lloji i NjEF-së ku jetojnë fëmijët, të rinjtë dhe rinia. Figura 5.4 tregon se pothuajse gjysma e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshën 5-17 vjeç jetojnë në NjEF bërthamë me të dy prindërit të pranishëm. Lloji i dytë më i rëndësishëm i NjEF-së (18,5 përqind) përbëhet nga familje bërthamë me fëmijë që jetojnë në NjEF të zgjeruara, dmth. pranë prindërve dhe fëmijëve janë edhe anëtarë të tjerë të NjEF-së (në të njëjtën NjEF). Një grup i pambrojtur përbëhet nga fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë vetëm me një prind. Ndër të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, 11,6 përqind jetojnë në NjEF bërthamë me një prind. Figura 5.4 tregon gjithashtu se ka pak ndryshim midis djemve dhe vajzave në lidhje me llojin e NjEF-së ku jetojnë. Diferenca më e madhe është në kategorinë e NjEF-ve bërthamë me të dy prindërit të pranishëm; 47,6 përqind e djemve me aftësi të kufizuara dhe 51,1 përqind e vajzave jetojnë në këtë lloj NjEF-je.

Sipas një studimi të Eurofound, bazuar në Anketën Evropiane për Cilësinë e Jetës 2016, një arsye për jetesën disa brezash në Evropë është kujdesi i përditshëm për një anëtar NjEF-je me aftësi të kufizuar ose sëmundje (Eurofound, 2019). Ndërsa 7 përqind e prindërve në NjEF-të bërthamë deklaruan se kujdesen për një anëtar NjEF-je me aftësi të kufizuar ose sëmundje, kjo përqindje arrinte në 26 përqind për prindërit që jetonin në NjEF të zgjeruara, disa brezash. Të dhënat e Censit 2023 lejojnë të shihet nëse Shqipëria ndjek këtë model evropian.

Figura 5.4: Numri gjithsej, djem dhe vajza 5-17 vjeç me aftësi të kufizuar, sipas llojit të NjEF-së (në %)





Figura 5.5 tregon përqindjet e fëmijëve 5-17 vjeç, sipas llojit të NjEF-së ku jetojnë dhe statusit të aftësisë së kufizuar. Në këtë grafik, një fëmijë konsiderohej me aftësi të kufizuar nëse kishte deklaruar se kishte shumë probleme ose nuk ishte në gjendje të kryente të paktën

një ose më shumë kategori funksionale. Fëmijët pa aftësi të kufizuara ishin ata që kishin deklaruar se nuk kishin vështirësi ose kishin vetëm pak vështirësi në të gjitha gjashtë pyetjet e Grupit të Washingtonit (WG). Figura 5.5 nuk tregon ndonjë dallim të qartë nëse më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara jetojnë në NjEF të zgjeruara. Përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara që jetojnë në NjEF me dy ose më shumë bërthama është madje më e ulët se te fëmijët pa aftësi të kufizuara. Përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara që jetojnë në NjEF me një prind është më e lartë. Në grupmoshën 15-29 vjeç, është vërejtur pak ndryshim në lidhje me llojin e NjEF-së midis personave me dhe pa aftësi të kufizuara.

Figura 5.5: Fëmijët 5-17 vjeç, sipas llojit të NjEF-së dhe statusit të aftësisë së kufizuara (në %)




5.3.2 Statusi i mirëqënies

Është vërtetuar se fëmijët që jetojnë në varfëri janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve shëndetësore si norma më të ulëta të vaksinimit, dietë e dobët, mungesë e sanitacionit të sigurt, mjedise të rrezikshme, akses i pamjaftueshëm në kujdes prenatal dhe postnatal dhe sëmundje të parandalueshme, të cilat të gjitha mund të kontribuojnë në nivele më të larta të aftësisë së kufizuara (UNICEF, 2013). Nga ana tjetër, aftësia e kufizuar e një fëmije forcon varfërinë ekzistuese në NjEF, pasi NjEF-të mund të përballen me shpenzime të larta për shkak të kostove mjekësore dhe kujdesit shtesë.

Ky studim shqyrton statusin e mirëqënies së NjEF-së, ku banon popullsia në moshë të re me aftësi të kufizuara. Figura 5.6 tregon përqindjen e fëmijëve në secilin nga pesë quintilet e mirëqënies - për fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara. Ndërsa fëmijët pa aftësi të kufizuara janë më shumë apo pak të shpërndarë në mënyrë të barabartë në pesë kategoritë e mirëqënies, kjo


nuk ndodh për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vetëm 11,8 përqind e këtyre fëmijëve i përkasin quintilit me mirëqënie më të lartë. Është interesante të shihet se rreth një e pesta e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara i përkasin quintilit me mirëqënie më të ulët, që është pak më pak se në grupin e fëmijëve pa aftësi të kufizuara. Megjithatë, ata janë më të përfaqësuar në quintilet e dytë dhe të tretë të mirëqënies. Këto rezultate tregojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara janë përfaqësuar në mënyrë disproporcionale në NjEF-të me mirëqëni të ulët, por jo dosmodoshmërisht në NjEF-të që i përkasin quintilit me mirëqënie më të ulët. Disa ndryshime të vogla u vunë re midis djemve dhe vajzave në lidhje me statusin e mirëqënies. Për quintilin më të ulët, përqindja të vajzat ishte pak më e lartë: 21,5 përqind kundrejt 19,5 përqind të djemtë.

Figura 5.6: Fëmijët 5-17 vjeç, sipas statusit të mirëqënies



Tek rinia e moshës 15-29 vjeç, shfaqet një model i ngjashëm (Figura 5.7). Megjithatë, dallimet midis personave me aftësi të kufizuara dhe atyre pa aftësi të kufizuara janë pak më të forta. Vetëm 10,4 përqind e personave me aftësi të kufizuara i përkasin quintilit më të lartë, ndërsa pothuajse 75 përqind i përkasin tri quintileve më të ulëta.

Figura 5.7: Rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe statusit ekonomik (në %)




5.3.3 Pajisje dhe shërbime

Një aspekt tjetër që përcakton situatën e NjEF-ve është qasja e tyre në shërbimet bazë, siç janë dush apo vaskë, furnizimi me ujë të rrjedhshëm brenda banesës dhe tualetet brenda saj. Këto shërbime janë veçanërisht të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara. Pa këto, ata mund të përballen me rreziqe më të larta infeksioni, kufizim më të madh në lëvizshmëri dhe varësi më të madhe nga kujdestarët.

Në Cens, pyetjet u përqendruan te qasja e NjEF-ve në këto shërbime bazë. Figura 5.8 paraqet përqindjen e personave të moshës 5 vjeç e lart, si dhe grupimeve brenda popullsisë me moshë të re, që nuk kanë ambiente për dush/vaskë në banesë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar. Ka pak ndryshime mes grupmoshave dhe gjinive për personat me aftësi të kufizuara. Përqindja e njerëzve që nuk kanë dush në banesë ishte rreth 5 përqind. Grafiku tregon qartë se, për të gjitha grupmoshat, përqindja e atyre që nuk kanë dush/vaskë në banesë është dukshëm më e lartë për personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, ndër fëmijët e moshës 5-17 vjeç pa aftësi të kufizuara, 5,9 përqind nuk kishin dush/vaskë në banesën ku jetonin. Ndër fëmijët me aftësi të kufizuara, kjo ishte 12,2 përqind, që është dy herë më e lartë. Tek vajzat, përqindja ishte më e lartë se tek djemtë: 14,1 përqind kundrejt 11,0 përqind. Për të rinjtë, ndryshimi mes meshkujve dhe femrave është minimal.

Figura 5.8: Përqindja e popullsisë 5 vjeç e lart, fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë pa dush/vaskë brenda banesës, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar



Rreth tre të katërtat e popullsisë në moshë të re (5-29 vjeç) jetojnë në banesa që kanë furnizim me ujë brenda banesës (Figura 5.9). Për popullsinë në moshë të re, me aftësi të kufizuara, furnizimi me ujë brenda banesës është rreth pesë pikë përqindjeje më e ulët sesa te popullsia në moshë të re, pa aftësi të kufizuara. E njëjta prirje vërehet edhe për llojin e tualetit të disponueshëm brenda banesës (Figura 5.10). Rreth 91 përqind e fëmijëve, të rinjve dhe rinisë pa aftësi të kufizuara jetojnë në banesa me tualet me ujë të rrjedhshëm brenda banesës. Për fëmijët, të rinjtë dhe rininë me aftësi të kufizuara, disponueshmëria e tualetit me ujë të rrjedhshëm brenda ndërtesës është rreth 86 përqind.

Figura 5.9: Fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe llojit të furnizimit me ujë (në %)





Figura 5.10: Fëmijët 5-17 vjeç, të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe llojit të tualetit (në %)




5.3.4 Aftësitë e shkrim-leximit dhe arsimit

Arsimi fuqizon fëmijët me aftësi të kufizuara për të arritur potencialin e tyre të plotë dhe për të marrë pjesë më plotësisht në ekonomi dhe shoqëri në tërësi. Duke ofruar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse, ndihmojmë në sigurimin e mundësive të barabarta dhe respektimit të aftësive të çdo fëmije. Aksesit në arsim cilësor është një objektivi specifik i Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 (arsim cilësor dhe promovimi i mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë). Objektivi 4.5 përqendrohet në rëndësinë e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara: Deri në vitin 2030, të eliminohen dallimet gjinore në arsim dhe të sigurohet akses i barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit profesional për grupet në nevojë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, popullsitë autoktone dhe fëmijët në situata të cenueshme. Objektivi 4.a synon të përmirësojë lehtësitë arsimore duke i bërë më të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara: *Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve arsimore që janë të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe gjinisë, dhe që ofrojnë mjedise të sigurta, pa dhunë, përfshirëse dhe efektive të mësimit për të gjithë.* Censi ofron një mundësi për të vlerësuar progresin e arritur në përmbushjen e Objektivit 4.5.

Shkrimi dhe leximi

Figura 5.11 paraqet nivelet e shkrim - leximit për tre grupmoshat e reja sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar. Grafiku tregon qartë se për të gjitha grupmoshat, popullsia në moshë të re me aftësi të kufizuara mbetet pas personave pa aftësi të kufizuara. Për shembull, ndërsa 99,4 përqind e të gjithë personave në grupmoshën 15-29 vjeç janë të aftë për të lexuar dhe shkruar, kjo vlen vetëm për 63,3 përqind të personave me aftësi të kufizuara, që është më pak se dy të tretat. Nuk mund të pritet që të arrihet barazi në aftësinë për të lexuar dhe shkruar midis personave me dhe pa aftësi të kufizuara, por dallimet tregojnë qartë pozicionin e pafavorshëm të personave me aftësi të kufizuara. Fakti që fëmijët 0-17 vjeç me aftësi të kufizuara kanë nivele të dukshme më të larta të lexueshmërisë i jep një tregues të qartë se në vitet e fundit situata është përmirësuar.

Figura 5.11: Shkalla e shkrim-leximit të fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %)




Ndjekja e shkollës

Dallimet në aftësinë për të lexuar dhe shkruar midis popullsisë në moshë të re me dhe pa aftësi të kufizuara reflektohen gjithashtu në normat e pjesëmarrjes në shkollë. Norma e pjesëmarrjes në shkollë i referohet përqindjes së fëmijëve ose nxënësve në një grupmoshë apo nivel arsimor specifik që ndjekin shkollën në kohën e kryerjes së censit. Figura 5.12 tregon se pjesëmarrja

në shkollë e fëmijëve, të rinjve dhe rinisë me aftësi të kufizuara është dukshëm më e ulët se ajo e bashkëmoshatarëve të tyre pa aftësi të kufizuara. Ndër fëmijët 5-17 vjeç, 95,4 përqind e fëmijëve pa aftësi të kufizuara ndjekin shkollën, krahasuar me 69,1 përqind të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Tek të rinjtë, këto norma të pjesëmarrjes janë përkatësisht 59,0 dhe 26,4 përqind. Ndërsa 40,9 përqind e personave 15-29 vjeç vazhdojnë të ndjekin shkollën, kjo vlen vetëm për 17,1 përqind të atyre me aftësi të kufizuara. Këto rezultate tregojnë se popullsia në moshë të re me aftësi të kufizuara vazhdon të përballlet me një disavantazhe në pjesëmarrjen në shkollë. Grafiku tregon se ekziston një diferencë midis meshkujve dhe femrave.

Figura 5.12: Normat e pjesëmarrjes në shkollë të fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %)



Dallimet midis të dy gjinive, në pjesëmarrjen në shkollë, tregohen më mirë përmes indekseve të barazisë gjinore (GPI) për kategoritë e ndryshme. Figura 5.13 tregon se midis fëmijëve 5-17 vjeç, fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara kanë indekse të barazisë gjinore thjesht identike (GPI afër 100). Për të rinjtë dhe rininë, pavarësisht nga statusi i aftësisë së kufizuar, indekset e barazisë gjinore tregojnë se një përqindje më e madhe e femrave ndjekin shkollën krahasuar me meshkujt. Është interesante të shihet se në përgjithësi, femrat me aftësi të kufizuara performojnë më mirë se femrat pa aftësi të kufizuara, krahasuar me meshkujt. Në grupmoshën 15-24 vjeç, për çdo 100 meshkuj me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën, ka 132,5 femra me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën. Ndër femrat pa aftësi të kufizuara, GPI është 119,6. Gjithashtu, në grupin 15-29 vjeç shfaqet e njëjta tendencë, megjithëse me një diferencë më të vogël.

Figura 5.13: Raportet e barazisë gjinore për pjesëmarrjen në shkollë të fëmijëve 5-17 vjeç, të rinjve dhe rinisë, sipas gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %)






Figura 5.14 paraqet një pamje të detajuar të dallimeve në ndjekjen e shkollës të popullsisë 6-29 vjeç me dhe pa aftësi të kufizuara sipas moshës dhe gjinisë. Duhet theksuar se modeli sipas moshës për personat me aftësi të kufizuara është disi më i paqëndrueshëm për shkak të numrit relativisht të vogël në këtë kategori. Megjithatë, grafiku tregon qartë se ndjekja e shkollës për fëmijët mbetet e lartë deri në moshën 17 vjeç dhe më pas fillon të ulët. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, kjo rënie fillon që në fillim të karrierës së tyre shkollë dhe vazhdon të bjerë me shpejtësi. Deri në moshën 17 vjeç, për të dyja grupet, ka pak ndryshim midis djemve dhe vajzave. Megjithatë, pas moshës 17 vjeç, të dhënat tregojnë një përparësi të qartë për vajzat krahasuar me djemtë, si në grupin e personave me aftësi të kufizuara ashtu edhe në atë të personave pa aftësi të kufizuara.

Figura 5.14: Shkalla e ndjekjes së shkollës nga popullsia e moshës 6-29 vjeç, sipas statusit të aftësisë së kufizuar, gjinisë dhe moshës (në %)



Të rinjtë, me dhe pa aftësi të kufizuara, ndryshojnë jo vetëm në pjesëmarrjen në shkollë, por edhe në nivelin e arsimit që ndjekin. Figura 5.15 tregon shpërndarjen relative të niveleve të arsimit që ndjekin të rinjtë 15-24 vjeç sipas statusit të aftësisë së kufizuar. Grafiku tregon se koha e arsimit është e ndryshme midis dy grupeve që janë aktualisht në shkollë. Ndërsa vetëm 3,7 përqind e të rinjve pa aftësi të kufizuara ndjekin arsimin e mesëm të ulët, tek të rinjtë me aftësi të kufizuara kjo përqindje është 19,8 përqind. Përqindjet në arsimin e mesëm të lartë janë më të ngjashme (49,6 përqind kundrejt 51,4 përqind), por një përqindje shumë më e ulët e të rinjve me aftësi të kufizuara ndodhet në arsimin e lartë, 26,3 përqind kundrejt 48,6 përqind. Kjo tregon se popullsia në moshë të re jo vetëm ka pjesëmarrje më të ulët në shkollë, por edhe është e përqendruar në nivele më të ulëta arsimore.


Figura 5.15: Të rinjtë 15-24 vjeç, sipas nivelit të arsimit që ndjekin dhe statusit të aftësisë së kufizuar (në %)



Ndjekja e shkollës


Figura 5.16 paraqet nivelin e arritjeve arsimore për të rinjtë dhe rininë sipas statusit të aftësisë së kufizuar. Nuk paraqiten të dhëna për fëmijët, pasi shumë prej tyre nuk kishin arritur ende moshën për të përfunduar ndonjë nivel arsimor. Grafiku tregon qartë se të rinjtë me aftësi të kufizuara vazhdojnë të mbeten pas krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara. Tek rinia e moshës 15-29 vjeç, 22,7 përqind e atyre pa aftësi të kufizuara kanë diplomë universitare ose pasuniversitare, kundrejt vetëm 11,8 përqind në mesin e atyre me aftësi të kufizuara. Ndër ata me arsim të mesëm të lartë, këto përqindje janë përkatësisht 40,3 përqind dhe 28,5 përqind. Nga ana tjetër, përqindja e atyre që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor ose të mesëm të ulët është dukshëm më e lartë ndër personat me aftësi të kufizuara.

Figura 5.16: Të rinjtë dhe rinia, sipas statusit të aftësisë së kufizuar dhe arritjeve arsimore (në %)



Siç u theksua më herët në këtë raport, rinia ka rezultate më të mira në arsim, sesa të rinjtë. Figura 5.17 tregon se kjo nuk vlen vetëm për popullsinë e përgjithshme të rinisë të moshës 15-29 vjeç, por edhe për ata me aftësi të kufizuara. Ndër ata pa aftësi të kufizuara, 35,2 përqind e grave kanë përfunduar një nivel arsimor universitar ose pasuniversitar, kundrejt 20,2 përqind të burrave të së njëjtës kategori moshe. Tek rinia me aftësi të kufizuara, këto përqindje janë 18,1 përqind për gratë dhe 7,6 përqind për burrat. Në nivelet më të ulëta arsimore, ndryshimi midis burrave dhe grave është shumë i vogël në të dy grupet.

Figura 5.17: Rinia (15-29 vjeç), sipas statusit të aftësisë së kufizuar, gjinisë dhe nivelit arsimor (në %)



6. Niveli i jetesës së popullsisë në moshë të re

Në këtë kapitull do të shqyrtohen aspekte të ndryshme të kushteve të jetesës së fëmijëve, të rinjve dhe rinisë. Numri i variablave që lidhen drejtpërdrejt me kushtet e jetesës së popullsisë në moshë të re në cens është mjaft i kufizuar.


6.1 Statusi i mirëqënies së NjEF

Sipas Censit 2023, 21,6 përqind e fëmijëve të moshës 0-17 vjeç i përkisnin kuintilit me mirëqënien më të ulët.

Regresioni logjistik lejon identifikimin e faktorëve që rrisin ose ulin gjasat që një fëmijë t'i përkasë 20 përqindëshit me mirëqënien më të ulët të popullsisë. Ky model regresioni ofron një kuptim më të mirë të varfërisë tek fëmijët. Ai ndihmon politikëbërësit të identifikojnë cilat grupe fëmijësh janë më të rrezikuara, duke mundësuar zhvillimin e programeve më të mira për mbrojtjen sociale. Gjithashtu mbështet përpjekjet për zhvillim me fokus në barazinë, duke evidentuar pabarazitë dhe duke informuar strategjitë për të reduktuar varfërinë dhe pabarazinë në fëmijëri.

Regresioni logjistik u kufizua te fëmijët 0-17 vjeç, pasi ata përbëjnë grupin më të cenueshëm brenda popullatës së moshës re. Ndryshorja që u shqyrtua në këtë regresion ishte nëse fëmija i përkiste apo jo një NjEF-je në kuintilin me mirëqënien më të ulët. Rezultatet e regresionit logjistik paraqiten në Figurën 6.1. Kategoritë e referencës për secilën ndryshore shpjeguese tregohen me një '0' të theksuar me ngjyrë gri. Një shtyllë blu e çelët me vlerë pozitive tregon se rreziku për të qenë pjesë të kuintili me mirëqënien më të ulët të NjEF-ve është më i lartë se në kategorinë e referencës. Vlera tregon sa më i madh është ky rrezik për një kategori të caktuar në krahasim me kategorinë e referencës. Për shembull, një vlerë prej 50 tregon se rreziku për të qenë të kuintili me mirëqënien më të ulët është 50 përqind më i lartë se për kategorinë e referencës. Vlerat negative në anën e majtë, pranë shtyllave blu më të errëta, tregojnë përqindjet e individëve që kanë rrezik më të ulët se kategoria e referencës.

Figura 6.1: Rreziku për qenë pjesë në kuintilin me mirëqënien më të ulët në krahasim me kategoritë e referencës, bazuar në regresionin logjistik (në %)



Regresioni logjistik tregon disa rezultate interesante. Së pari, pas kontrollimit për faktorët e tjerë ndërhyrës, vërehen dallime të mëdha në nivel qarku. Fëmijët në qarkun Dibër përballen me rrezikun më të lartë, për të qenë pjesë e 20 përqindshit të NjEF-ve me mirëqënien më të ulët. Analiza tregon se fëmijët në Dibër kanë më shumë se dyfishin e rrezikut për të qenë me mirëqënien më të ulët (110 përqind) krahasuar me ata në qarkun referencë Berat. Kukësi zë vendin e dytë, me një rrezik 54 përqind më të lartë. Në anën tjetër të spektrit, fëmijët në Tiranë kanë një rrezik 96 përqind më të ulët për të qenë me mirëqënien më të ulët krahasuar me fëmijët në Berat.

Nuk ka ndryshim të ndjeshëm midis djemve dhe vajzave, sa i përket mundësisë për të qenë në NjEF-të me mirëqënien më të ulët. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë, mesatarisht, një rrezik 15 përqind më të lartë për të qenë me mirëqënien më të ulët se fëmijët pa aftësi të kufizuara. Nga rezultatet e regresionit logjistik nuk është e qartë nëse fëmijët me aftësi të kufizuara janë me mirëqënien më të ulët për shkak të përkatësisë në NjEF me mirëqënie të ulët apo nëse NjEF-të bëhen me mirëqënie më të ulët për shkak të kostove të larta që kërkon kujdesi për një fëmijë me aftësi të kufizuara.

Fëmijët që jetojnë në NjEF të zgjeruara kanë pothuajse dyfishin e rrezikut për të qenë në kuintilin me mirëqënien më të ulët krahasuar me fëmijët që jetojnë në NjEF bërthamë. Ky rezultat është në përputhje me dëshmi globale që tregojnë se fëmijët që jetojnë në NjEF të zgjeruara përballen me norma më të larta të varfërisë. Sipas publikimit A Global View of Poverty, Gender, and Household Composition, 10,3 përqind e popullsisë botërore jeton në NjEF të zgjeruara. Në krahasim, 20,9 përqind e personave që përjetojnë mirëqënie të ulët jetojnë

në këtë lloj NjEF-je (Muñoz Boudet, Bhatt, Azcona, Yoo, & Beegle, 2021).

Fëmijët që kanë një ose të dy prindërit mungues në NjEF, kanë nivele dukshëm më të ulëta për të qenë pjesë e kuintilit më të ulët i mirëqënies krahasuar me fëmijët që kanë të dy prindërit në NjEF. Fëmijët që jetojnë vetëm me nënën në NjEF kanë një rrezik 58 përqind më të ulët për t'i përkatur kuintilit më të ulët. Nëse në NjEF është vetëm babai, ky efekt është shumë më i vogël (12 përqind). Fëmijët që kanë të dy prindërit në mungesë janë dy herë më pak të rrezikuar të jetojnë në 20 përqindshin më të ulët të NjEF-ve. Ndërsa mungesa e një prindi mund të vijë nga emigracioni, divorci, ndarja apo edhe vdekja e prindit, shumica e mungesave shkaktohen nga migrimi masiv i të rriturve për të gjetur punë në vende më të zhvilluara. Remitancat që dërgohen nga prindërit janë më së shumti arsyeja pse fëmijët e tyre kanë shanse shumë më të ulëta për të jetuar në varfëri.


Pozicioni i vështirë i minoritetit Rom/ Egjiptian duket qartë nga shanset më të larta që kanë fëmijët e tyre për t'i përkatur segmentit/kuintilit më të ulët. Fëmijët e prindërve romë dhe egjiptianë përballen me një rrezik 50 përqind më të lartë për të jetuar në NjEF të kuintilit më të ulët fëmijët me prindër të etnisë shqiptare. Fëmijët me prejardhje tjetër etnike kanë rrezeqe pak më të ulëta për t'i përkatur NjEF-ve më të varfra (13 përqind).

6.2 Furnizimi me ujë

Qasja në ujë të pastër dhe të sigurt në shtëpi është thelbësore për shëndetin e fëmijëve dhe lidhet drejtpërdrejt me arritjen e OZHQ-ve, veçanërisht Objektivit 3 (Shëndet i Mirë dhe Mirëqenie) dhe Objektivit 6 (Ujë i Pastër dhe Kushte higjienike), sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh, 2023). Fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj sëmundjeve të transmetuara përmes ujit, dhe qasja në burime të përmirësuara uji në nivel NjEFje ul ndjeshëm rrezikun e sëmundjeve dhe vdekjeve (ibid.). Një furnizim i besueshëm me ujë në banesë mbështet praktikat thelbësore të higjenës, si larja e duarve dhe përgatitja e sigurt e ushqimit, të cilat janë jetike për parandalimin e sëmundjeve.

Figura 6.2 ilustron llojet e furnizimit me ujë të disponueshëm për fëmijët e moshës 0-17 vjeç, të ndarë sipas gjinisë. Grafiku tregon se një përqindje e lartë (75,1 përqind) e kësaj popullate ka ujë të lidhur me rrjetin e banesës, që përputhet me kategorinë “menaxhuar në mënyrë të sigurt” sipas klasifikimeve të Programit të Përbashkët të Monitorimit të UNICEF dhe OBSh-së (WHO/UNICEF, p. d.).

Figura 6.2: Fëmijët e moshës 0-17 vjeç, sipas llojit të furnizimit me ujë dhe gjinisë (në %)




Afërsisht 10 përqind e popullsisë mbështetet në ujë të lidhur me rrjetin brenda ndërtesës, por jashtë banesës. Edhe pse kjo konsiderohet një burim i përmirësuar, kjo situatë klasifikohet si 'shërbim bazik'. Nga ana tjetër, uji i lidhur jashtë ndërtesës mund të rrisë rrezikun e kontaminimit dhe të vështirësojë aksesin. Një në njëzet e pesë fëmijë jeton në këtë situatë. Në censin e vitit 2023 nuk u kërkuar specifikim i mëtejshëm për lloje të tjera të furnizimit me ujë, si p.sh. puse të mbrojtura ose të pambrojtura, burime, ujë nga kamionët cisternë ose ujë sipërfaqësor. Të gjitha këto kategori u grupuan në kategorinë e përgjigjes 'Sisteme të tjera furnizimi me ujë'. Në censin 2023, afërsisht dhjetë përqind e të gjithë fëmijëve jetonin në NjEF me lloje të tjera të furnizimit me ujë. Grupi më i cenueshëm i fëmijëve janë ata që jetojnë në NjEF pa sistem furnizimi me ujë. Kjo ishte situata për 1,1 përqind të gjithë fëmijëve të moshës 0-17 vjeç. Duhet të theksohet se nuk u vunë re ndryshime midis djemve dhe vajzave. E njëjta analizë u bë edhe për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç dhe rininë e moshës 15-29 vjeç. Dallimi midis këtyre dy grupeve dhe fëmijëve ishte i papërfillshëm dhe nuk paraqitet këtu.

6.3 Tualeti

Shërbimet e tualetit në një banesë konsiderohen të menaxhuara në mënyrë të sigurt nëse pajisja e sanitarizimit të përmirësuar përdoret ekskluzivisht nga familja dhe jashtëqitjet trajtohen në mënyrë të duhur dhe të sigurt brenda pronës ose në një vend të përcaktuar jashtë saj. Një pajisje bazike është ajo ku familja përdor një pajisje të përmirësuar sanitarizimi, por që nuk ndahet me NjEF të tjera. Në Cens 2023 nuk u bë pyetje lidhur me trajtimin e jashtëqitjeve. Prandaj, nuk është e mundur të dallohen drejtpërdrejt shërbimet e tualetit të menaxhuara në mënyrë të sigurt nga ato bazike. Figura 6.3 tregon përqindjen e fëmijëve sipas llojit të shërbimeve të tualetit dhe gjinisë.

Figura 6.3: Përqindja e fëmijëve sipas llojit të tualetit të përdorur dhe sipas gjinisë.




Ndër fëmijët e moshës 0-17 vjeç, 91,2 përqind jetojnë në NjEF që kanë tualet me ujë të rrjedhshëm brenda banesës, 4,7 përqind kanë akses në tualet me ujë të rrjedhshëm jashtë banesës por brenda të njëjtës ndërtesë, dhe 1,3 përqind kanë akses në një lloj tjetër tualeti. Grupi më i cenueshëm janë 0,2 përqind e fëmijëve që nuk kanë tualet të disponueshëm. Figura 6.3 tregon pothuajse mungesë dallimi gjinor, që është një tregues pozitiv. Gjithashtu, në këtë rast, përqindjet për të rinjtë dhe rininë janë thuajse të njëjta me ato të fëmijëve dhe për këtë arsye nuk paraqiten këtu.

6.4 Pajisjet e tualetit

Në censin e vitit 2023 u përfshi një pyetje lidhur me pajisjet për larje në banesë: “A ka kjo banesë një vaskë ose dush të fiksuar?” Një pajisje e përshtatshme për larje brenda banesës ndihmon në ruajtjen e higjienës së përgjithshme për anëtarët e NjEF-së. Figura 6.4 paraqet përqindjen e fëmijëve sipas faktit nëse kanë apo jo pajisje për larje në banesën ku jetojnë. Shumica dërmuese e fëmijëve (94,3 përqind) kanë pajisje për larje në banesën e tyre.

Figura 6.4: Fëmijët e moshës 0-17 vjeç, sipas llojit të pajisjes për larje dhe gjinisë




6.5 Energjia elektrike dhe ngrohja

Sipas censit 2023, përqindja e popullatës në moshë të re (0-29 vjeç) që ka energji elektrike të instaluar në banesë është pothuajse universale në Shqipëri: 99,4 përqind e të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rejave jetojnë në NjEF me energji elektrike të instaluar.

Lloji i ngrohjes është i rëndësishëm për fëmijët në disa drejtime. Figura 6.5 tregon se pothuajse 60 përqind e fëmijëve jetojnë në NjEF ku djegia e drurit është mënyra kryesore e ngrohjes. Përdorimi i drurit për ngrohje mund të ndikojë në cilësinë e ajrit të brendshëm, pasi çliron tym dhe ndotës të dëmshëm. Veçanërisht foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë më të ndjeshëm ndaj ndotjes së ajrit të brendshëm, pasi mushkëritë e tyre janë ende në zhvillim. Ekspozimi i zgjatur mund të çojë lehtësisht në sëmundje afatshkurtra dhe afatgjata, si infeksione të rrugëve të frymëmarrjes, astmë dhe bronkit kronik, si dhe mund të rrisë rrezikun për sindromën e vdekjes së papritur tek foshnjat. Djegia e drurit gjithashtu shkakton probleme serioze mjedisore, pasi çon në ndotjen e ajrit dhe shpyllëzimin.

Pas drurit, energjia elektrike nga burime të tjera është lënda djegëse e dytë më e rëndësishme që përdoret për ngrohje. Nuk është e mundur të përcaktohet se për çfarë lloji bëhet fjalë. Rreth tre përqind e fëmijëve jetojnë në NjEF ku energjia elektrike nga burime të tjera (dmth. jo diellore) përdoret për ngrohje.

Figura 6.5: Fëmijët e moshës 0-17 vjeç, sipas llojit të ngrohjes në banesë dhe gjinisë



Referenca

- de Bruijn, B. (2024, 6 28). Census methodology. Presentation at the Conference on the Population and Housing Census in Albania 2023. Tirana.
- Eurofound. (2019). *Household composition and well-being*. Luxembourg.: Publications Office of the European Union.
- European Parliament and the Council of the EU. (2008, 7 9). *Population and demography*. Retrieved from Eurostat: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/population-demography/population-housing-censuses/legislation>
- Eurostat. (2023). *More women than men held tertiary degrees in 2022* . Retrieved May 30, 2025, from <https://ec.europa.eu/eurostat/>
- Eurostat. (2024, May 8). *Demography of Europe – 2024 edition* . Retrieved from <https://ec.europa.eu/eurostat/>: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2024>
- Eurostat. (2025, 5 20). *Goal 4 - Quality education*. Retrieved from Eurostat Database: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/sdg_04_31/default/table?lang=en&category=sdg.sdg_04
- Eurostat. (2025). *Mean age at first marriage by sex*. Retrieved May 29, 2025, from <https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tps00014/default/table?lang=en>
- Eurostat. (2025, 5 10). *Population on 1 January by age group, sex and country of birth*. Retrieved from Eurostat Data Browser: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/migr_pop3ctb/default/table?lang=en
- Eurostat. (2025, February). *Population structure and ageing*. Retrieved from Statistics explained: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Population_structure_and_ageing
- Ferré, C. (2015). *Profile of the disabled population in Albania*. Tirana: INSTAT, UNDP. Retrieved from <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Census-2011-Profile-of-PWD-final.pdf>
- Gjonca, A., Aassve, A., & Mencarini, L. (2008). Albania: Trends and patterns, proximate determinants and policies of. *Demographic Research*, 261-292.
- Government of Albania. (2022). *National Youth Strategy and Action Plan 2022-2029*.
- Hajnal, J. (1953). Age at Marriage and Proportions Marrying. *Population Studies*, 7, no.2, 111-136.
- INSTAT & UNICEF. (n.d.). *Data from 2017 - 2021. Child-, Adolescent- and Youth-Focused Well-being Indicators in Albania*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT. (2014). *Population and Population Dynamics in Albania. New Demographic Horizon?* . Tirana: Printed with the support of the Swiss Agency for Development and Cooperation.
- INSTAT. (2014). *Population and population dynamics in Albania: New demographic horizons?* Tirana: INSTAT.
- INSTAT. (2015). *Youth in Albania. Challenges in changing times*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT. (2019). *Vjetari Statistikor Rajonal, 2019 (Regional Statistical Yearbook, 2019)*. Tirana: INSTAT.

- INSTAT. (2023). *Population of Albania 1st January 2023*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT. (2024). *Abanian Population and Housing Census 2023. Main Results*. Tirana.
- INSTAT. (2024a). *Demographic indicators. Annual 2023 and quarter I - 2024*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT. (2025, 5 20). *Sustainable Development Goals*. Retrieved from INSTAT: <https://www.instat.gov.al/en/sdgs/quality-education/42-by-2030-ensure-that-all-girls-and-boys-have-access-to-quality-early-childhood-development-care-and-pre-primary-education-so-that-they-are-ready-for-primary-education/422-participation-rate-in-organize>
- INSTAT, Institute of Public Health, and ICF. (2018). *Albania Demographic and Health Survey 2017-18*. Tirana: INSTAT, Institute of Public Health, and ICF.
- International Organization for Migration. (2020). *National household migration survey in Albania*. Tirana: International Organization for Migration.
- Kalmijn, M. (2013). The educational gradient in marriage: A comparison of 25 European countries. *Demography*, 1499-1520.
- Kote, K. (2022, August 4). No. of Students Graduating in Secondary Education Decreases. *Albanian Daily News*.
- Mema, D., & Matoshi, A. (2019). *Beyond borders. Analytical Research Report on Migration in Albania*. Tirana: Mary Ward Loreto Foundation. Retrieved from https://marywardloreto.org/wp-content/uploads/2023/06/BEYOND_BORDERS_Analytical_Research_Repor.pdf
- Ministry of Health and Social Protection. (2021). *National Action Plan for Persons with Disabilities 2021-2025*. Tirana: Ministry of Health and Social Protection.
- Ministry of Health and Social Protection. (2021). *National Agenda on the Rights of the Child 2021-2026*. Tirana: Ministry of Health and Social Protection.
- Ministry of Health and Social Protection. (2021). *National Action Plan for Equality, Inclusion and Participation of Roma and Egyptians (2021-2025)*. Tirana: Ministry of Health and Social Protection.
- Mitra, s. C. (2021). *Invisible or Mainstream? Disability in Surveys and Censuses. Policy Research Working Paper 9625*. World Bank Group.
- Muñoz Boudet, A., Bhatt, A., Azcona, G., Yoo, J., & Beegle, K. (2021). *A Global View of Poverty, Gender, and Household Composition*. World Bank Group. World Bank.
- Republic of Albania. (2020, 11 26). *Legal Bases/Strategies*. Retrieved from <https://www.instat.gov.al>: <https://www.instat.gov.al/en/census-2023/legal-basesstrategies/>
- Rutstein, S. (2008). *The DHS Wealth Index: Approaches for Rural and Urban Areas*. Calverton: Macro International.
- Sari, P. E. (2023, December). Educational Attainment of People with Disabilities: A Comparison Between Public School and Private Schools. *International Journal of Public Administration Management and Economic Development*, 8(3), 1 - 17. doi:10.60026/IJPAMED.V8I2.144
- UNDESA. (2025a, 5 20). *SDG indicator database*. Retrieved from <https://unstats.un.org/sdgs/dataportal/database>
- UNDP. (n.d.). *Sustainable Development. Ensure inclusive and equitable quality education and promote lifelong learning opportunities for all*. Retrieved May 24, 2025, from https://sdgs.un.org/goals/goal4#targets_and_indicators
- UNECE. (2015). *Conference of European Statisticians Recommendations for the 2020 Censuses of Population and Housing*. New York and Geneva: United Nations Economic Commission for Europe.

- UNESCO. (2014). *Teaching and Learning: Achieving quality for All*. Paris: UNESCO. Retrieved from <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000225660>
- UNESCO. (2022). *Global education monitoring report 2022: gender report, deepening the debate on those still left behind*. Retrieved from <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000381329>
- UNESCO. (2025). *Inclusive learning*. Retrieved from [unesco.org: https://www.uil.unesco.org/en/inclusive-learning](https://www.uil.unesco.org/en/inclusive-learning)
- UNESCO, Institute for Statistics. (2025, 04 30). *SDG4- Country Profiles. Albania*. Retrieved 05 18, 2025
- UNICEF. (2013). *The State of the World's Children 2013. Children with Disabilities*. New York: United Nations Children's Fund (UNICEF).
- UNICEF. (2024). *The state of the world's children 2024. The future of childhood in a changing world*. . Florence: UNICEF Innocenti – Global Office of Research and Foresight .
- UNICEF and UNFPA. (2018). *Child marriage. Knowledge, Attitudes, and Perceptions among affected communities in Albania*. Tirana: UNICEF. Retrieved from <https://www.unicef.org/albania>, <https://albania.unfpa.org/>,
